



RAPORTI VJETOR 2021

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Vizioni

Të jemi kredibilë dhe të pranuar globalisht si rregullator dhe autoritet mbikëqyrës i aviacionit civil, i radhitur para të tjerëve në rajon dhe më gjerë sa i përket sigurisë së aviacionit.

Misioni

Të krijojmë një ambient të aviacionit civil në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, partneritetit me industrinë dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	5
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
2. BAZA LIGJORE.....	11
3. PËRSHKRIMI I AAC-së.....	12
4. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL	14
4.1 ORGANIZIMI I AAC-së	14
b) Struktura organizative e AAC-së.....	14
c) Të hyrat financiare të AAC-së	15
d) Pagat e personelit të AAC-së	16
4.2 BORDI MBIKËQYRËS I AAC-së	16
a) Mandati.....	16
b) Kompetencat	16
c) Funksionaliteti	17
4.3 EKZEKUTIVI.....	17
a) Drejtori i përgjithshëm	17
b) Zëvendës Drejtori i përgjithshëm	18
c) Menaxhmenti i mesëm	18
4.4 BURIMET NJERËZORE.....	18
a) Trajnimet	18
4.5 PASURITË	19
5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AAC-së.....	20
6. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I PUNËS	21
7. PUNA GJATË VITIT	22
7.1 PËRPPJEKJET PËR ANËTARËSIM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË TË AVIACIONIT.....	22
a) Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)	22
b) Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA)	22
7.2 NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE TË KOSOVËS	22
a) Përshkrimi i hapësirës ajrore të Kosovës	22
b) Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës	27
7.3 MARRËVESHJA PËR HAPËSIRËN E PËRBASHKËT EVROPIANE TË AVIACIONIT (MARRËVESHJA HPEA)	28
a) Vizita vlerësuese nga KE për zbatimin e Marrëveshjes HPEA në Kosovë	29
7.4 PROGRAMI SHETETËROR I SIGURISË (PSHS)	29
a) Takimet e Komitetit të Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS) në aviacionin civil.....	30
b) Veprimtaria e Këshillit të Sigurisë në AAC.....	30
c) Zhvillimet në menaxhimin e sigurisë së aviacionit	30
d) Menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion (OR)	31
7.5 ÇËSHTJET E AVIACIONIT TË NDËRLIDHURA ME INTEGRIMIN EVROPIAN.....	34
a) Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së	34
b) Raporti i Vendit për Kosovën i Komisionit Evropian.....	35
c) Takimi i Komitetit dhe Këshillit të MSA-së.....	35
7.6 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL.....	35
a) Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet AAC-së dhe AIP-së.....	36

b)	Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet AAC-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes	36
c)	Takimi me Departamentin Qendror për PPP-në në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve	36
d)	Takimi me AMMK-në lidhur me arritjen e një marrëveshjeje me AAC-në.....	37
7.7	AKTIVITETI I AAC-së NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR.....	37
a)	Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil.....	38
i.	Përdorimi i hapësirës ajrore të Kosovës për procedurën e uljes në Aeroportin e Kukësit.....	38
ii.	Bashkëpunimi ndërmjet departamenteve të aerodromeve nga Kosova dhe Shqipëria.....	39
iii.	Bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe atij të Kroacisë	40
iv.	Bashkëpunimi në fushën e mjekësisë së aviacionit	41
b)	Koordinimi i asistencës teknike në fushën e aviacionit.....	41
i.	Projekti EASA IPA 5	41
ii.	Asistenca teknike nga AAC-ja e Francës	42
7.8	AKTIVITETI RREGULLATOR/MBIKËQYRËS.....	42
a)	Siguria e fluturimeve, certifikimi dhe licencimi	43
i.	Inspektimet e mjeteve të huaja ajrore në platformë	43
ii.	Auditimet e operatorëve të aviacionit.....	44
iii.	Raportimi i ndodhive në aviacion (OR).....	45
iv.	Transporti i mallrave të rrezikshme përmes ajrit	46
v.	Mbikëqyrja e aviacionit të përgjithshëm.....	46
vi.	Mjekësia e aviacionit.....	48
vii.	Mjetet ajrore të ndaluara në Kosovë.....	49
viii.	Mjetet ajrore civile të regjistruara dhe ato të larguara nga regjistri i mjeteve ajrore civile.....	50
ix.	Licencat, certifikatat dhe lejet e aprovuara, duke përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre	50
b)	Shërbimet e navigacionit ajror	50
i.	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA)	50
ii.	Mbikëqyrja e vazhdueshme e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.....	51
iii.	Auditimi vlerësues nga EASA	53
iv.	Mbikëqyrja e ASHNA-s si Organizatë Trajnuese (OT).....	54
v.	Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s	54
vi.	Lëshimi i licencave për kontrollorët e trafikut ajror dhe vlerësimi i gradimeve	57
vii.	Publikimi i Informatave Aeronautike	59
viii.	Raportimi i obligueshëm i ndodhive	60
ix.	Aktivitetet në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19	60
c)	Aerodromet.....	60
i.	Mbikëqyrja e vazhdueshme e sigurisë së aerodromeve.....	62
ii.	Projekti për zgjatjen e pistës dhe ngritjen e kategorisë së pistës për aterrimin preciz në ILS CAT-IIIB në ANP “Adem Jashari”	63
iii.	Certifikimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës pas ndryshimeve infrastrukturore	65
iv.	Certifikimi i LKIA-së si organizatë për aftësi profesionale në fushën e aerodromeve.....	66
v.	Vlerësimi i ndikimit të turbinave të erës dhe ndërtimeve të larta në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës	67

vi. Implementimi i Rregullores 03/2019 për shënjimin e pengesave dhe Rregullores 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromeve	69
vii. Ushtrimi gjithëpërfshirës për reagim në emergjencë në ANP “Adem Jashari”	70
viii. Organizimi i trajnimit rajonal në vendin e punës “Menaxhimi i botës shtazore në aeroporte”, të organizuar përmes projektit EASA IPA	71
d) Rregullimi ekonomik i aviacionit	71
i. Mbikëqyrja e vazhdueshme ekonomike e aeroportit	72
ii. Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s	73
iii. Mbikëqyrja e vazhdueshme ekonomike e shërbyesve në tokë	74
7.9 AKTIVITETI LEGJISLATIV	76
a) Aktet nënligjore	76
b) Urdhëresat administrative	79
c) Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative	80
d) Ndëshkime/ankesa/konteste	83
7.10 PUBLIKIMET TEKNIKE PËR INDUSTRIJË	84
a) Publikimi i pasqyrës për ndodhitë e raportuara	84
7.11 INFORMIMI I PUBLIKUT DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE	85
a) Qasja në dokumente publike	85
b) Faqja zyrtare e AAC-së në internet	85
7.12 PROKURIMI	85
7.13 RAPORTI FINANCIAR	86
a) Raporti i buxhetit me shpenzime	86
b) Të hyrat	87
b) Grantet e përcaktuara të donatorëve	87
c) Shpenzimet buxhetore	88
d) Planifikimi / Realizimi i buxhetit	92
e) Investimet kapitale	94
f) Tabelë krahasuese e buxhetit për tre vitet e fundit	94
g) Buxheti i AAC-së për vitin 2021	94
7.14 AUDITIMET NDAJ AAC-së	94
a) Auditimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës	94
b) Auditimi i Brendshëm nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	94
8. STATISTIKAT E TRAFIKUT AJROR	96
SHTOJCA 1 - LISTA E TRAJNIMEVE	97
SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-SË PËR VITIN 2021 DHE REALIZIMI I TIJ	100
SHTOJCA 3 - STATISTIKAT E TRANSPORTIT AJROR 2021	110

LISTA E SHKURTESAVE

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
AMC	Qendra e Mjekësisë së Aviacionit
AME	Ekzaminues Mjekësor i Aviacionit
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
BE	Bashkimi Evropian
EASA	Agjencia Evropiane për Sigurinë e Aviacionit
ECAC	Konferenca Evropiane e Aviacionit Civil
EUROCONTROL	Organizata Evropiane për Sigurinë e Navigacionit Ajror
HPEA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit
IATA	Asociacioni Ndërkombëtar i Kompanive Ajrore
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Instrumenti i Para-anëtarësimit
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
KE	Komisioni Evropian
KFOR	Misioni i NATO-s në Kosovë
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
KTA	Kontrolli i Trafikut Ajror
LAC	Ligji për Aviacionin Civil
LKIA	Kompania private që operon ANP “Adem Jashari”
MFPT / MF	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD / MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MAP	Ministria e Administratës Publike
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
PSHS	Programi Shtetëror i Sigurisë
SAP	Sistemi i mjetit ajror pa pilot (droni)
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SMC	Sistemi për menaxhimin e cilësisë
SPR	Standardet dhe praktikat e rekomanduara të ICAO-s
SHNA	Shërbimet e Navigacionit Ajror
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Objektivat

AAC-ja ka përcjellë Objektivat Strategjike për periudhën pesëvjeçare 2019-2023, të hartuara dhe miratuara në fund të vitit 2018. Objektivat strategjike i shërbejnë AAC-së si bazë e mirë dhe e pazëvendësueshme për planifikimet vjetore që i bën organizata. Planet vjetore hartohen në nivel të menaxhmentit, pas një procesi të identifikimit të veprimeve në nivel të njësive organizative. AAC-ja vendos objektivat e punës në baza vjetore. AAC-ja do të përcjellë objektivat strategjike në vijim:

1. Zbatimi i plotë i përgjegjësive rregullatore;
2. Normalizimi i hapësirës ajrore;
3. Zbatimi i Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS);
4. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare (ky objektivi nuk varet nga AAC-ja);
5. Lidhja e marrëveshjeve teknike ndërkombëtare dhe rajonale.

Funksioni bazë i AAC-së është mbikëqyrja dhe rregullimi i aktiviteteve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës me qëllim të garantimit të operimeve të sigurt në përputhje me standardet në fuqi. Kjo arrihet përmes inspektimit, auditimit, licencimit dhe certifikimit. AAC-ja ka një personel profesional dhe kompetent për rregullimin e aviacionit civil në vend. Aktiviteti rregullator i AAC-së përfshin sigurinë e aviacionit civil në përgjithësi dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës.

Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve (DSF) gjatë vitit 2021 kanë kryer njëzet e tre (23) inspektime të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj (SAFA - Vlerësimi i Sigurisë së Mjeteve të Huaja Ajrore), të cilët operojnë në ANP "Adem Jashari". Është audituar Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës (QKMP) në Gjakovë, e autorizuar nga AAC-ja në cilësinë e Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC).

Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve kanë realizuar auditimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" (LKIA) me qëllim të aprovimit të aplikuesit për Certifikatë për mallra të rrezikshme. Është audituar organizata trajnuese për paraglajdzëm "Akademia e Aviacionit Artan Venhari". Me këtë rast organizatës trajnuese për paraglajdzëm i është vazhduar aprovimi deri më 26 korrik 2024.

Në bazë të Neneve 57 dhe 59 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe Nenit 7 të Rregullores nr. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit në Republikën e Kosovës, janë lëshuar 153 leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit.

Pas përfundimit të periudhës 5 vjeçare, ASHNA ka aplikuar formalisht për ripërtërirjen e certifikatës më 09.07.2021. Ky proces është verifikuar gjatë auditimeve të vazhdueshme. Pas lëshimit të rekomandimit nga Departamenti i SHNA-së, me të cilin

konfirmohet se ASHNA përmbush të gjitha kërkesat e përbashkëta të përshkruara në Rregulloren nr. 09/2020, që transponon Rregulloren nr. 2017/373 të BE-së, dhe të cilat janë kusht për certifikim si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, si dhe kërkesat e përshkruara në Rregulloren nr. 01/2018 mbi kërkesat për ofruesit e shërbimeve, në lidhje me trajnimin dhe vlerësimin e kompetencës për personelin e elektronikës të sigurisë të trafikut ajror (ATSEP), AAC-ja i ka dorëzuar ASHNA-s certifikatën, me çka është vazhduar certifikimi i saj. Certifikata nuk ka afat të caktuar por është e vlefshme përderisa ASHNA, si ofrues i shërbimeve, i plotëson kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2021, AAC-ja ka arritur t'i realizojë dy auditime në ASHNA sipas planifikimeve vjetore për audite, dy audite ad-hoc dhe një inspektim, duke verifikuar njëherit përmbushjen e kërkesave rregullative. Auditimi i paraparë në tremujorin e fundit, është shtyer për vitin e ardhshëm duke pasur parasysh që qëllimi i tij ka qenë Aneksi 10 i ICAO-s, me theks në Pajisjet e Radio Navigimit, pasi që në kuadër të projektit të zgjatjes së pistës, në muajin nëntor, janë aprovuar për operim ILS/DME dhe DVOR/DME.

ASHNA është certifikuar në vitin 2017 për të ofruar shërbimet që i takojnë një Organizate Trajnuese për Kontrollorët e Trafikut Ajror (KTA). Që nga koha e certifikimit, ASHNA OT është audituar disa herë përgjatë këtyre viteve nga Departamenti i SHNA-së, brenda kornizave të procesit të mbikëqyrjes së vazhdueshme, për të garantuar dhe verifikuar se OT vazhdon të plotësojë të gjitha kërkesat e rregullores. Lëshimi i Certifikatës dëshmon për sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, por që kërkon angazhim të vazhdueshëm nga ana e ASHNA-s për respektimin e kushteve të certifikimit dhe për ngritjen edhe më tej të cilësisë së shërbimeve.

AAC-ja është përgjegjëse për lëshim dhe ripërtëritjen e licencave të kontrollorëve të trafikut ajror, të cilët ofrojnë shërbimet e kontrollit ajror në Republikën e Kosovës. Për shkak të përballjes me pandeminë COVID-19, procesi i rregullt i rivalidimit të miratimeve të njësisë nuk ka mundur të zhvillohet si në vitet paraprake, pasi që situata ka pamundësuar ndjekjen e trajnimeve rifreskuese e që është kërkesë e Rregullores nr. 19/2017. AAC-ja ka lejuar zgjatjen e privilegjeve të miratimeve të njësisë sipas rekomandimit nga DSHNA. Më 09.11.2021, ASHNA ka dorëzuar dëshmitë se disa KTA kanë mundur të ndjekin trajnimin rifreskues dhe si rrjedhojë AAC-ja ka vazhduar validitetin e miratimeve të njësisë për 23 KTA.

Ndaras nga procesi i certifikimit të aerodromit, AAC-ja aprovon edhe ndryshimet e sistemeve të ASHNA-s. Shumë prej sistemeve që i nënshkrohen aprovimit janë pjesë e projektit kapital "Zgjatja e Pistës". Gjatë vitit 2021, janë lëshuar disa aprovime dhe disa janë ende në proces të aprovimit.

Inspektorët e aerodromeve në bashkëpunim të ngushtë me inspektorët e shërbimeve të navigacionit ajror në vazhdimësi kanë rishikuar dhe aprovuar vlerësime të ndryshme të sigurisë, duke filluar nga ato për punimet sipërfaqësore në rrugën e taksimit për daljen e shpejt nga pista, mandej për fillimin e punëve të dheut për pjesën e pistës prej "lokalizuesit" në drejtim të pragut të pistës 35, për zhvendosjen e pragut të pistës 35,

fillimisht duke e shkurtuar pistën nga 2500 m në 2200 m, dhe pastaj duke e kthyer gjatësinë paraprake prej 2500 m, për zgjerimin e sipërfaqes së sigurisë në fundin e pistës 17 (RESA17), është bërë analizimi dhe aprovimi i punëve për përgatitjen e kanaleve për shtrirjen e rrjetit të furnizimit me energji elektrike të pajisjeve të navigimit, si dhe janë trajtuar edhe shumë vlerësime tjera aeronautike që lidhen me këtë projekt. Në koordinim të plotë mes palëve, LKIA-ASHNA-AAC, është bërë kontrollimi dhe aprovimi i të dhënave për publikimin e informatave aeronautike, ku përfshihen të dhënat esenciale për publikim, hartat aeronautike dhe procedurat e fluturimit.

Përfundimisht, me finalizimin e projektit infrastrukturor të zgjatjes së pistës nga 2.500 në 3.040 metra, së bashku me ngritjen e kategorisë së operimit me sistemin preciz të aterimit, me 21.12.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ka lëshuar certifikatën e operimit për kodin referent të aerodromit 4E, bazuar në karakteristikat dhe performancën e aeroplanëve më të mëdhenj që janë planifikuar të operojnë në ANP “Adem Jashar”.

Sipas planit të aktiviteteve për monitorimin e rregullt dhe verifikimin e zbatimit të standardeve të aplikueshme për operatorin e ANP “Adem Jashari” dhe ofruesve të shërbimeve në tokë, inspektorët e Departamentit të Aerodromeve gjatë vitit 2021 kanë përmbushur plotësisht planin e mbikëqyrjes së sigurisë për këtë vit, duke realizuar një auditim certifikues, nëntë inspektime të planifikuara prej të cilëve një tek furnizuesi i aprovuar i aeroplanëve me karburant, kompanisë “ExFis”, katër inspektime “ad-hoc” që nuk janë planifikuar paraprakisht në planin e mbikëqyrjes por janë realizuar si përgjigje ndaj çështjeve të ndryshme të sigurisë, si dhe katër inspektime tjera së bashku me inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve, për të verifikuar zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19 sipas Planit të veprimit të operatorit.

Lidhur me projektin për ndërtimin e fermës së gjeneratorëve të kompanisë “SOWI Kosovo LLC” në Selac, Komuna e Mitrovicës, AAC-ja ka vazhduar të ushtrojë rolin e saj koordinues dhe të monitorojë nga afër zhvillimet e punimeve deri në përfundimin e plotë të këtij projekti. Pas pranimit të dokumentacionit të kërkuar, AAC-ja ka realizuar një inspektim në teren dhe është njoftuar nga përfaqësues të SOWI-it për zhvillimet e fundit në përfundimin e këtij projekti. Komunikimi ka vazhduar përmes postës elektronike deri në njoftimin për përfundimin e projektit dhe vendosjen e shenjëzimit të kërkuar.

Gjatë muajit dhjetor, AAC-ja ka angazhuar ekipin e inspektorëve nga të gjitha departamentet operative të AAC-së për të marrë pjesë në ushtrimin gjithëpërfshirës për reagim në emergjencë në ANP “Adem Jashari”, të organizuar nga LKIA, i cili rrjedhë nga kërkesa e Rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet, në bazë të së cilës është certifikuar operatori LKIA.

Gjatë vitit 2021, në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të masave për frenimin e përhapjes së virusit COVID-19 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, janë realizuar gjithsej dymbëdhjetë inspektime *ad-hoc*, me qëllim të verifikimit

të zbatimit të masave në kuadër të Planit të Veprimit të hartuar dhe të paraqitur nga ana e LKIA-së para AAC-së, duke u bazuar në dokumentet relevante të hartuara nga AAC, EASA, ECDC dhe ICAO.

AAC-ja ka dorëzuar inputin për Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) i cili është vendosur në Planin Kombëtar. Pas kërkesës nga MIE për rishikim të PKZMSA-së, më 2 korrik 2021 AAC-ja ka dorëzuar në ZKM një plan të rishikuar. Për vitin 2021, AAC-ja ka planifikuar transponimin e 6 rregulloreve të BE-së. Është arritur të transponohen 5 prej 6 masave të planifikuara. Masa e cila nuk është finalizuar është bartur në vitin 2022.

AAC-ja ka vazhduar përpjekjet për të lidhur marrëveshje teknike të quajtura “Aranzhime të punës” me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (European Aviation Safety Agency - EASA). Këto aranzhime do t’i mundësonin AAC-së qasje në bazën evropiane të të dhënave të sigurisë së aviacionit (ECCAIRS - Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve). Përmes shkresës së datës 20 dhjetor 2021 që Drejtori i Përgjithshëm e ka dërguar te EASA dhe Komisioni Evropian, është rikërkuar lidhja e Aranzhimeve të Punës, pjesëmarrja e institucioneve aeronautike Kosovare në grupet e punës së EASA-s, qasja në databazat e EASA-s dhe një auditim konfirmues nga EASA pas atij të vitit 2017. Në periudhën e mbuluar nga ky raport nuk është pranuar ndonjë përgjigje.

AAC-ja ka komunikuar me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) lidhur me aplikimin për anëtarësim në ICAO. ICAO është agjenci e specializuar e OKB-së, e cila nxjerr standarde ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, të detyrueshme për 193 shtetet e saj anëtare. Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur veprime që janë kërkuar nga AAC-ja drejt anëtarësimit në këtë organizatë ndërkombëtare.

Në kuadër të diskutimeve për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, më 18 qershor 2020 ASHNA ka nënshkruar Letër Marrëveshje me ofruesin shqiptar të shërbimeve AlbControl Tirana ACC, përmes së cilës janë hapur edhe dy pika tjera, KUKAD dhe ARBER, në kufirin me Republikën e Shqipërisë, të cilat mund të shfrytëzohen për koordinim të fluturimeve, siç është paraqitur në Figurën 2. Pikat KUKAD dhe ARBER janë pika të cilat në baza taktike mund të përdoren për koordinim të trafikut komercial ndërmjet ASHNA-s dhe AlbControl-it, mirëpo të njëjtat ende nuk janë të planifikueshme për fluturime (flight plannable).

Në vitin 2017, për herë të parë, nën udhëheqjen e NATO-s, mbledhjet e BANM-it kanë filluar të organizohen në të ashtuquajturin “nivel ekspertësh”. Pjesëmarrës në këto takime kanë qenë përfaqësues nga Republika e Kosovës, Republika e Serbisë, Mali i Zi, si dhe përfaqësues të KFOR-it. Gjatë vitit 2021 nuk kanë vazhduar bisedimet për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore dhe hapjen e korridoreve ajrore me shtetet fqinje të Kosovës, në kuadër të takimeve për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (BANM).

Në vazhden e koordinimit të aktiviteteve të nisura në dhjetor të vitit 2020, edhe gjatë viti 2021 janë zhvilluar një numër i takimeve ndërmjet palëve relevante, në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore të Kosovës për procedurën e uljes në Aeroportin e Kukësit.

Gjatë vitit 2021 janë mbajtur disa takim ndërmjet përfaqësuesve të AAC-së, ASHNA-s, këshilltarit për aviacion të deleguar nga AAC-ja tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe përfaqësuesve të KFOR-it. Në këto takime është diskutuar lidhur me procedurat e fluturimit të Aeroportit të Kukësit dhe me marrëveshjen ndërmjet AlbControl-it dhe ASHNA-s. Më 26.07.2021, është pranuar një letër me të cilën KFOR-i, miraton përkohësisht fluturimet komerciale, të planifikuara për Aeroportin e Kukësit.

ASHNA ka dorëzuar një draft LoA, por ai nuk është aprovuar nga AAC-ja dhe KFOR-i gjatë vitit 2021. I gjithë ky ndryshim afekton hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës dhe ai do të trajtohet sipas procedurës për ndryshime të manualit të SHNA-së, e cila është e shtjelluar tek nëntitulli: Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s (Ndryshimi "CH-2021-01 LAKU operations").

Të gjitha fluturimet me destinacion Aeroportin e Kukësit janë realizuar si rezultat i takimeve të përbashkëta me KFOR-in dhe pas aprovimit të tyre nga KFOR-i. Aprovimet bëhen për secilin fluturim veç e veç (Case by Case) deri në ndryshimin e NATO SPINS, kur këto fluturime do të trajtohen si fluturime të cilat nuk kërkojnë aprovime të veçanta paraprake nga KFOR-i.

AAC-ja ka dërguar disa shkresa dhe është takuar edhe me Departamentin Qendror për PPP-në në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Në këtë takim u diskutua rreth bashkëpunimit në mes të AAC-së dhe DQPPP-së, me theks të veçantë për padinë që e operatorit LKIA (Limak) kundër Vendimit të lëshuar nga AAC-ja për hapjen e tregut të shërbimeve në tokë. AAC-ja ka njoftuar përmes shkresave Komitetin e PPP-së për refuzimin e LKIA-së për të zbatuar Rregulloren nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë si dhe Vendimin nr. 01/ZDP/VE/2021 të AAC-së, të datës 19 janar 2021, lidhur me lejimin e qasjes në treg për ofruesit e tjerë të shërbimeve në tokë.

Në kuadër të planit të trajnimeve të AAC-së për vitin 2021 dhe asistencës teknike nga projekti EASA IPA 5, personeli i AAC-së ka ndjekur gjithsej 43 trajnime, prej të cilave disa janë mbajtur në mënyrën "online", ndërsa të tjerat me prezencë fizike.

Implementimi i IPA 5 ka filluar nga data 01 shkurt 2020 dhe do të zgjasë për 36 muaj, deri në janar 2023. Secili aktivitet është koordinuar ndërmjet AAC-së së Kosovës dhe EASA-s për të marrë parasysh nivelin e zhvillimit të industrisë dhe nevojat specifike që kanë inspektorët e aviacionit të AAC-së drejt zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore në fusha të ndryshme të aviacionit civil. Gjatë vitit 2021, AAC-ja ka përfutur 6 trajnime, 4 punëtori dhe 2 trajnime në vend të punës.

2. BAZA LIGJORE

Më 13 mars 2008, Parlamenti i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil. Ligji ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në pajtim me nenin 130 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili kërkon themelimin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Ligji për Aviacionin Civil është ligj bazik i funksionimit të AAC-së dhe rregullimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Me këtë ligj, AAC-së i janë dhënë kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore në formë të rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe vendimeve, me të cilat janë zbatuar më konkretisht dispozitat e Ligjit për Aviacionin Civil dhe standardeve ndërkombëtare të nxjerra nga ICAO dhe BE. Funksionimi dhe organizimi i brendshëm bëhet me rregulloren e brendshme të nxjerrë nga Drejtori i përgjithshëm, në bazë të nenit 14.2 të Ligjit për Aviacionin Civil dhe sipas legjislacionit në fuqi, duke përfshirë Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, Ligjin dhe rregulloret e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shërbimin civil.

Ligji për Aviacionin Civil është një ligj që i takon grupit të parë të ligjeve pas pavarësisë. Plotësimin/ndryshimin e ligjit, nëse është e nevojshme, duhet ta iniciojë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si ministri e linjës, ndërsa hisedarë të këtij procesi duhet të jenë AAC, MPB dhe KHAIA. Gjatë periudhës raportuese MMPHI ka iniciuar një proces në drejtim të ndryshimit/plotësimit të ligjit, për të përcaktuar edhe më mirë përgjegjësitë e institucioneve publike të aviacionit civil, përndryshe ligji për aviacionin civil ka qenë brenda kuadrit ligjor të BE-së dhe është vlerësuar si model për shtetet tjera të rajonit.

Siç u tha më lart, Ligji për Aviacionin Civil dhe aktet nënligjore që burojnë prej tij i kanë mundësuar AAC-së ushtrimin e përgjegjësiave të veta dhe zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare të vendit në fushën e sigurisë pa ndonjë vështirësi për t'u theksuar.

3. PËRSHKRIMI I AAC-së

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës është themeluar si agjenci e pavarur rregullatore në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil. Nga 1 janari 2009, AAC-ja ka marrë kompetencat e plota në përputhje me këtë ligj. AAC është njëra nga autoritetet publike me përgjegjësi dhe funksione në fushën e aviacionit civil në vendin tonë. Ligji përcakton që Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për rregullimin ekonomik të transportit ajror¹, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjëse për rregullimin e aspekteve të sigurimit të aviacionit². Ligji gjithashtu themelon Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), si institucion që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës³.

AAC-ja është e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror nënkupton miratimin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë. AAC-ja ka kapacitet të plotë juridik dhe për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas Ligjit për Aviacionin Civil, AAC-ja është përgjegjëse për:

- zbatimin e legjislacionit mbi aviacionin civil dhe zbatimin e politikave të miratuara nga MMPHI-ja ose Qeveria në fushën e aviacionit civil;
- ofrimin e këshillave dhe propozimeve për MMPHI-në, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikat dhe legjislacionin nga fusha e aviacionit civil;
- nxjerrjen e rregulloreve zbatuese dhe urdhrave të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil dhe Marrëveshjen mbi Hapësinën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, me qëllim të zbatimit të politikave të aviacionit civil të MMPHI-së dhe legjislacionit përkatës nga fusha e aviacionit civil;
- lëshimin e licencave, certifikatave dhe lejeve në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së të përcaktuara nga Ligji për Aviacionin Civil;
- rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës;
- rregullimin e ekonomisë së aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajror;
- ofrimin e këshillave për MMPHI-në në lidhje me përgatitjen nga Ministri të propozim-politikave mbi shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Kosovës, të cilat i përmbushin nevojat e shfrytëzuesve, duke pasur parasysh sigurinë kombëtare, faktorët ekonomikë dhe mjedisorë dhe nevojën për standarde të larta të sigurisë;
- mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhrave të aviacionit civil, përveç

¹ Ligji për Aviacionin Civil, Kreu 2

² Po aty, Kreu 4

³ Po aty, Neni 5

- kur, me Ligjin për Aviacionin Civil ose me një akt tjetër themelor juridik, ky funksion shprehimisht i është dhënë MMPHI-së ose një autoriteti tjetër publik;
- shpërndarjen e informatave për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC-së;
 - marrjen e masave, kryerjen e hetimeve dhe inspektimeve dhe nxjerrjen e urdhrave, rregullave, rregulloreve dhe/ose procedurave të cilat AAC me arsye i konsideron të nevojshme për (i) zbatimin e rregullt dhe të ligjshëm të dispozitave të Ligjit për Aviacionin Civil ose (ii) ushtrimin e rregullt dhe të ligjshëm të kompetencave dhe detyrave të cilat i janë dhënë AAC-së me këtë ligj; dhe
 - ushtrimin e funksioneve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me aviacionin civil në Kosovë që i janë dhënë AAC-së sipas Ligjit për Aviacionin Civil ose një akti tjetër themelor juridik.

4. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

4.1 ORGANIZIMI I AAC-së


Selia e AAC-së është në rrugën “Zeinel Salihu” nr. 22, në Prishtinë. Me kërkesë të AAC-së, Ministria e Punëve të Brendshme kishte nxjerrë Vendimin nr. 1044/2020, më 23 dhjetor 2020, për akomodimin e AAC-së në ish objektin e Gjykatës Komunale në Prishtinë. Zhvendosja e AAC-së, duke përfshirë të gjithë dokumentacionin, asetet (inventarin e zyrave, pajisjet teknologjike, etj.) në këtë objekt shtetëror nga objekti privat, ka filluar në pjesën e parë të muajit shkurt 2021 dhe është kompletuar në fillim të muajit mars 2021. Ky objekt ka hapësirë pothuajse të mjaftueshme për numrin e nëpunësve të AAC-së, duke u ofruar atyre kushte solide për punë. Në këtë objekt shpenzimet komunale i bartë MPB-ja dhe AAC-ja lirohet nga barra e qirasë.

b) Struktura organizative e AAC-së

Në bazë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm, struktura organizative e AAC-së që nga viti 2011 përbëhet nga 30 nëpunës të ndarë në njësitë administrative si në vijim:

- a) Zyra e Drejtorit të përgjithshëm:
 - i. Drejtori i përgjithshëm (1);
 - ii. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm (1);
 - iii. Zyrtare ekzekutive (1);
 - iv. Zyra për çështje ligjore të aviacionit (1); dhe
- b) Departamenti i sigurisë së fluturimeve (7);
- c) Departamenti i shërbimeve të navigacionit ajror (4);
- d) Departamenti i aerodromeve (4);
- e) Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rregullim ekonomik të Aviacionit (3);
- f) Departamenti për siguri dhe cilësi (1); dhe
- g) Departamenti i administratës dhe burimeve njerëzore (6).

Organogrami i AAC-së:



c) Të hyrat financiare të AAC-së

AAC-ja është organizatë e vetëfinancuar buxhetore, sipas Nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, por në praktikë kjo nuk është zbatuar, edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme nga AAC-ja. Tani dhe viteve të mëparshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e ndanë buxhetin AAC-së si grant qeveritar dhe jo si të hyra të dedikuara sipas kodit përkatës buxhetor, rrjedhimisht vetëm 47% e të hyrave vetanake i lejohen AAC-së për buxhetin e saj vjetor. Pjesa tjetër derdhet në arkën e shtetit si edhe të hyrat e tjera nga taksat dhe tatimet.

Sipas Nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ardhurat e dedikuara të AAC-së përbëhen nga:

- taksat të cilat ndërlidhen me aviacionin, detyrimet dhe tarifat;
- një përqindje nga shërbimet e navigacionit ajror që ofrohen brenda hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës;
- tarifat për sigurinë e pasagjerëve dhe tarifat e certifikimit dhe licencimit; dhe
- donacionet, grantet dhe përkrahjet (mbështetjet) tjera financiare ose teknike të caktuara për AAC-në.

Që nga 1 janari 2009, zbatohet Rregullorja nr. 2008/7 e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për përcaktimin e tarifës së sigurisë së udhëtarëve që udhëtojnë me fluturime komerciale nga Kosova. Kjo Rregullore

përcakton një tarifë sigurie prej 2 euro për çdo udhëtar që niset nga Kosova me fluturime komerciale. Sipas Ligjit për Aviacionin Civil dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje, fondet e mbledhura nga kjo tarifë sigurie janë të ardhura të dedikuara për AAC-në me qëllim të mbulimit të shpenzimeve operative.

Duke filluar nga gjysma e vitit 2011, AAC-ja përmes Rregullores nr. 7/2011, e cila më pas është shfuqizuar me Rregulloren nr. 2/2015, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 5/2018, ka siguruar bazën ligjore për mbledhjen e tarifave për shërbimet të cilat ajo i ofron, që përfshijnë dhënien e licencave, lejeve, certifikatave të ndryshme dhe kryerjen e inspektimeve dhe auditimeve, në përputhje me kompetencat e AAC-së për rregullimin e aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

d) Pagat e personelit të AAC-së

Sipas Nenit 24.2 të Ligjit për Aviacionin Civil, pagat e personelit të AAC-së caktohen nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, me propozim të Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së. Në caktimin e nivelit të pagave, ligji përcakton që, përveç kriterëve profesionale për personelin, duhet të merren parasysh edhe pagat e personelit të industrisë së aviacionit (aeroportit, kontrollit të trafikut ajror, kompanive ajrore), parim ky i kërkuar edhe nga ICAO-ja. Niveli i pagave të personelit të AAC-së është miratuar më 20 mars 2009 nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, pas propozimit të Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së. Pagat e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të AAC-së janë caktuar nga Qeveria në përputhje me Nenin 20.2 të Ligjit për Aviacionin Civil.

4.2 BORDI MBIKËQYRËS i AAC-së

Në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil, veprimtaria e AAC-së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës i AAC-së, i cili përbëhet nga pesë anëtarë. Bordi vepron me orar jo të plotë dhe duhet të takohet së paku një herë për çdo tremujor kalendarik. Kryesuesi përfaqëson Bordin në publik dhe menaxhon e organizon punën e Bordit. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe ka kuorumin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nëse së paku tre anëtarë të Bordit janë të pranishëm.

Drejtori i përgjithshëm i AAC-së i dorëzon Bordit Mbikëqyrës raport gjithëpërfshirës të punës çdo tre muaj dhe raportin vjetor në fund të çdo viti kalendarik.

a) Mandati

Anëtarët e ri të Bordit Mbikëqyrës të AAC-së janë emëruar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/34, të datës 07.10.2020, me përjashtim të z. Gaxherri i cili e ka përsëritur edhe një mandat.

b) Kompetencat

Bordi Mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e (i) aktiviteteve dhe vendimeve të AAC-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore dhe të licencimit, dhe (ii) të gjitha aspektet e menaxhimit financiar, të ardhurave dhe shpenzimeve të AAC-së. Sipas nenit 16.1 të Ligjit për Aviacionin Civil, nëse shumica e anëtarëve të Bordit konstatojnë se ka arsye për të besuar se AAC nuk është përpunur ose nuk është duke u përpunur me një ose më shumë dispozita të këtij ligji ose një akti tjetër ligjor të zbatueshëm në Kosovë, Bordi duhet ta identifikojë (përcaktojë) fushën në të cilën dyshohet kjo mospërpunshmëri në një raport me shkrim, i cili më pas i dorëzohet Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit. Bordi nuk ka kompetenca ekzekutive, kompetenca të zbatimit ose kompetenca rregullatore.

c) Funksionaliteti

Gjatë kësaj periudhe Bordi Mbikëqyrës i AAC-së ka mbajtur disa takime dhe ka miratuar raportet tremujore tetor-dhjetor 2020 dhe janar-mars 2021.

4.3 EKZEKUTIVI

AAC udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm, si organi më i lartë i drejtimit ekzekutiv dhe administrativ. Në punën e tij të përditshme ai mbështetet nga strukturat udhëheqëse të definuara më poshtë: Zëvendës drejtori i përgjithshëm dhe Drejtorët e departamenteve.

a) Drejtori i përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në nenin 21 të Ligjit për Aviacionin Civil dhe në përpunje me ligjet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike, përfshirë këtu menaxhimin dhe raportimin e rregullt financiar. Ai punon me orar të plotë. Drejtori i përgjithshëm është zyrtar i AAC-së, i cili është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe vendimmarrjen në AAC. Sipas nenit 26 të Ligjit për Aviacionin Civil, Drejtori i përgjithshëm përgjigjet para Kuvendit lidhur me përpunshmërinë e AAC-së me politikat e aviacionit civil si dhe të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, z. Bujar Ejupi është emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 qershor 2020, përmes Vendimit nr. 05/07 në pajtim me nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil. Mandati i Drejtorit të përgjithshëm zgjat pesë (5) vjet dhe mund të riemërohet nga Qeveria edhe për mandate të tjera pasuese me kohëzgjatje të njëjtë.

Ish drejtori i përgjithshëm z. Eset Berisha është shkarkuar me Vendimin nr. 01/30 të Qeverisë, më 12 maj 2020, përmes të cilit edhe është emëruar ushtruesi i detyrës së Drejtorit të përgjithshëm, z. Arianit Islami, i cili ishte në detyrë deri në emërimin e drejtorit të tanishëm, z. Ejupi.

b) Zëvendës Drejtori i përgjithshëm

Zëvendës Drejtori i përgjithshëm punon me orar të plotë. Zëvendës Drejtori ndihmon Drejtorin e përgjithshëm në udhëheqjen ekzekutive dhe administrative të AAC-së dhe, në mungesë të Drejtorit të përgjithshëm, kryen funksionet e tij.

Z. Xhelil Bekteshi është emëruar Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i AAC-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 27 janar 2017 përmes Vendimit nr. 03/129. Mandati i Zëvendës Drejtorit të përgjithshëm zgjat pesë (5) vjet dhe mund të riemërohet nga Qeveria edhe për mandate të tjera pasuese me kohëzgjatje të njëjtë.

c) Menaxhmenti i mesëm

Në bazë të Rregullores së brendshme, struktura udhëheqëse apo menaxhmenti i mesëm i AAC-së përbëhet nga drejtorët e departamenteve, të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara në përshkrimet e punës. Përfundimisht, Drejtori i përgjithshëm mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e AAC-së një strukture apo nëpunësi, jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture apo nëpunësi, nëse ai e sheh të nevojshme. Drejtori i përgjithshëm gjatë mungesës së përkohshme, në pajtim me nenin 23.1 të Ligjit për Aviacionin Civil, mund të delegoj plotësisht apo pjesërisht kompetencat e tij dhe të AAC-së tek një nëpunës me nivel përgjegjësie udhëheqëse.

4.4 BURIMET NJERËZORE

AAC-ja aktualisht ka 30 pozita të aprovuara, nga të cilat 28 janë pozita të karrierës me akt emërimi, ndërsa 2 pozita janë funksionarë publikë.

Gjatë tremujorit të katërt, pozita e Zyrtarit për Shërbime të Navigacionit Ajror është liruar pas dorëheqjes së një zyrtareje. Gjatë vitit 2021 AAC-ja ka pasur një avancim sipas Vendimit të KPMShCK-së.

Gjatë këtij viti nuk ka pasur komisione disiplinore.

a) Trajnimet

AAC-ja investon në vazhdimësi në ngritjen profesionale dhe përditësimin e njohurive të specializuara të nëpunësve, në përputhje me standardet dhe praktikën e rekomanduara ndërkombëtare dhe bazuar në Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Në kuadër të planit të trajnimeve të AAC-së për vitin 2021 dhe asistencës teknike nga projekti EASA IPA 5, personeli i AAC-së ka ndjekur gjithsej dyzet e tri (43) trajnime, prej të cilave disa janë mbajtur në mënyrën ONLINE, ndërsa të tjerat me prezencë fizike.

Trajnimet e realizuara në vitin 2021 janë të paraqitura në Shtojcën 1 të këtij raporti.

4.5 PASURITË

AAC-ja posedon 982 asete me vlerë në blerje prej 297,248.28 €, ku hyjnë pasuritë mbi dhe nën 1,000 €. Këto pasuri janë kryesisht orendi zyrash, pajisje teknologjike, automjete, etj.

Pasuritë mbi 1,000.00 € janë blerë në vlerë monetare prej 127,896.44 €, ndërsa vlera e mbetur nga zhvlerësimi sipas normave të zhvlerësimit në vite është 12,331.02 €. Disave prej pasurive të kësaj kategorie që kanë vlerë zero por janë ende në përdorim, komisioni ju ka dhënë vlerë prej 5,751.89 € dhe vlera totale e pasurive është 18,082.91€.

Pasuritë nën 1,000.00 € janë blerë në vlerë monetare prej 169,351.84 €, ndërsa vlera e mbetur nga zhvlerësimi sipas normave të zhvlerësimit në vite është 13,696.18 €. Disave prej pasurive të kësaj kategorie që kanë vlerë zero por janë ende në përdorim, komisioni ju ka dhënë vlerë prej 2,737.78 € dhe vlera totale e pasurive është 16,433.96 €. Llogaritjet janë bërë sipas Rregullores së MF-së nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore.

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AAC-së

AAC-ja përcjell Objektivat Strategjike për periudhën pesëvjeçare 2019-2023, të hartuara dhe miratuara në fund të vitit 2018. Objektivat strategjike i shërbejnë AAC-së si bazë e mirë dhe e pazëvendësueshme për planifikimet vjetore që i bën organizata. Planet vjetore hartohen në nivel të menaxhmentit, pas një procesi të identifikimit të veprimeve në nivel të njësive organizative. AAC vendos objektiva pune në baza vjetore. Këto objektiva planifikohen sipas konceptit S.M.A.R.T. (të thjeshta, të matshme, të arritshme, të arsyeshme, me afate kohore).

Për pesë vitet e ardhshme AAC-ja do të përcjellë objektivat strategjike në vijim:

1. Zbatimi i plotë i përgjegjësive rregullatore;
2. Normalizimi i hapësirës ajrore;
3. Zbatimi i Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS);
4. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare (ky objektivi nuk varet nga AAC-ja);
5. Lidhja e marrëveshjeve teknike ndërkombëtare dhe rajonale.

6. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I PUNËS

Gjatë muajit janar 2021, nga menaxhmenti i AAC-së është konsoliduar plani i punës për vitin 2021 dhe pastaj është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Plani i punës në përmbajtje përfshin: planin e veprimit, planin e aktiviteteve mbikëqyrëse, planin për menaxhimin e rreziqeve në AAC, planin e rekrutimit, planin e trajnimeve të personelit dhe planin e legjislacionit sipas HPEA.

Matjet e realizimit të punës së AAC-së kanë treguar se nga Plani i Veprimit për vitin 2021, nga gjithsej 119 (100%) veprime, 66% e veprimeve janë realizuar plotësisht, rreth 18% e veprimeve janë në përfundim e sipër, 5% e veprimeve nuk kanë qenë në përgjegjësinë e AAC-së ose janë ndikuar nga veprimet e jashtme dhe 11% e veprimeve nuk janë realizuar.

Disa nga veprimet që nuk janë realizuar gjatë vitit 2021, dhe gjatë viteve paraprake, si për shembull anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të aviacionit dhe hyrja në aranzhime kontraktuale ndërkombëtare, kanë qenë të ndërlidhura me faktorë të jashtëm, kryesisht rrethana politike dhe ligjore jashtë kompetencave vendimmarrëse të AAC-së.

Plani i veprimit për vitin 2021 dhe realizimi i tij është i përfshirë në këtë raport në Shtojcën 2.

7. PUNA GJATË VITIT

7.1 PËRPPJEKJET PËR ANËTARËSIM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË TË AVIACIONIT

a) Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)

ICAO është agjenci e specializuar e OKB-së, e cila nxjerr standarde ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, të detyrueshme për 193 shtetet e saj anëtare. AAC-ja luan rol mbështetës ndaj Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) kur të merret vendimi politik për të aplikuar për anëtarësim në këtë organizatë. Përpos një komunikimi me MPJD-në lidhur me këtë çështje, gjatë vitit 2021 nuk ka pasur veprime që janë kërkuar nga AAC-ja drejt anëtarësimit në këtë organizatë ndërkombëtare.

b) Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA)

AAC-ja ka vazhduar përpjekjet për të lidhur marrëveshje teknike të quajtura “Aranzhime të punës” me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (ang. European Aviation Safety Agency - EASA). EASA është agjenci e specializuar e BE-së, me përgjegjësi në fushën e sigurisë së aviacionit civil. Këto aranzhime do t'i mundësonin AAC-së qasje në bazën evropiane të të dhënave të sigurisë së aviacionit (ECCAIRS - Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve), do të krijonin kornizën e nevojshme për inspektim të performancës së AAC-së nga EASA si dhe për asistencë nga EASA në zbatimin e plotë të dispozitave përkatëse të Marrëveshjes HPEA. Deri më tani, EASA nuk ka hyrë në aranzhime kontraktuale me AAC-në për arsye të natyrës politike, jashtë fushëveprimit dhe mundësive të AAC-së apo institucioneve tjera të Republikës së Kosovës. Përmes shkresës së datës 20 dhjetor 2021 që Drejtori i Përgjithshëm e ka dërguar te EASA dhe Komisioni Evropian, është rikërkuar lidhja e Aranzhimeve të Punës, pjesëmarrja e institucioneve aeronautike Kosovare në grupet e punës së EASA-s, qasja në databazat e EASA-s dhe një auditim konfirmues nga EASA pas atij të vitit 2017. Në periudhën e mbuluar nga ky raport nuk është pranuar ndonjë përgjigje.

7.2 NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE TË KOSOVËS

a) Përshkrimi i hapësirës ajrore të Kosovës

Hapësira ajrore e Kosovës që nga shtatori i vitit 1999 është pjesë e “Hapësirës së Përbashkët Operacionale të Ballkanit – JOA” të NATO-s, nën kontrollin operacional të Qendrës së Kontrollit të Operimeve të Kombinuara Ajrore 5 (Combined Air Operations Control 5 - CAOC5), e cila në vitin 2014 është transferuar te Qendra Torrejon e Operimeve të Kombinuara Ajrore (Combined Air Operation Centre Torrejon CAOC TJ). Kjo hapësirë ajrore është hapësirë e kontrolluar, në të cilën ofrohen shërbime të trafikut ajror.

Në bazë të marrëveshjes në mes të NATO/KFOR-it dhe Hungarisë, hapësira e lartë ajrore e Kosovës (mbi 6205 m) që nga prilli i vitit 2014 menaxhohet nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë, HungaroControl, i cili u ofron shërbime mjeteve ajrore që e mbikalojnë këtë hapësirë. Vazhdimi i ofrimit të këtyre shërbimeve nga HungaroControl është bërë në vitin 2019, pas përfundimit të periudhës pesëvjeçare të filluar në vitin 2014.

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës (nën 6205 m) menaxhohet/kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), e cila ofron shërbime të navigacionit ajror për aeroplanët civilë gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës me qëllim të aterimit dhe ngritjes nga Aeroporti i Prishtinës. Gjithashtu, shërbime ofrohen edhe për fluturimet e KFOR-it, EULEX-it dhe fluturimet e aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të vendit. Hapësira e ulët ajrore është e klasifikuar si hapësirë e klasit D dhe G, në përputhje me dispozitat mbi klasifikimin e hapësirës ajrore nga Aneksi 11 i ICAO-s.

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur strukturat aktuale të hapësirës ajrore të Kosovës (hapësira e ulët dhe e lartë).

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës

Në hapësirën e ulët ajrore aktualisht janë vetëm 2 korridore (shih Figurën 1) që përdoren për trafik komercial për vajtje-ardhje nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Korridori për ardhje fillon në pikën hyrëse XAXAN dhe përfundon në ANP “Adem Jashari”, ndërsa korridori për vajtje fillon në ANP “Adem Jashari” dhe përfundon në pikën dalëse SARAX. Pikat XAXAN dhe SARAX ndodhen në pjesën jugore të Kosovës, në kufi me Maqedoninë e Veriut.

Në kuadër të diskutimeve për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, më 18 qershor 2020 ASHNA ka nënshkruar Letër Marrëveshje me ofruesin shqiptar të shërbimeve AlbControl Tirana ACC, përmes së cilës janë hapur edhe dy pika tjera, KUKAD dhe ARBER, në kufirin me Republikën e Shqipërisë, të cilat mund të shfrytëzohen për koordinim të fluturimeve, siç është paraqitur në Figurën 2.

Pikat KUKAD dhe ARBER janë pika të cilat në baza taktike mund të përdoren për koordinim të trafikut komercial ndërmjet ASHNA-s dhe AlbControl-it, mirëpo të njëjtat ende nuk janë të planifikueshme për fluturime (flight plannable).




Figura 1. Struktura e hapësirës së ulët ajrore në Republikën e Kosovës




Figura 2. Pikat e reja, KUKAD dhe ARBER për koordinimin e fluturimeve me Tirana ACC

Hapësira e lartë ajrore e Kosovës

Struktura e hapësirës së lartë ajrore përbëhet nga 2 sektorë (shih figurat 3 dhe 4) nga niveli i fluturimit FL205 (6 km) deri në FL285 (9 km) dhe nga niveli i fluturimit FL285 (9 km) deri në nivelin e fluturimit FL660 (20 km).

Sektori 1 (FL205 deri në FL285) përbëhet nga 4 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon në pikën hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon në pikën hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon në pikën hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon në pikën hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR.




Figura 3. Struktura e hapësirës së lartë ajrore në Republikën e Kosovës: Sektori 1 (FL205 deri në FL285)

Sektori 2 (FL285 deri në FL660) përbëhet nga 5 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon në pikën hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon në pikën hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon në pikën hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon në pikën hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR;
5. Korridori UL603, i cili fillon në pikën hyrëse VABEK dhe përfundon në pikën dalëse LONTA.




Figura 4. Struktura e hapësirës së lartë ajrore në Republikën e Kosovës: Sektori 2 (FL285 deri në FL660)

b) Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës

Pas përfundimit të luftës, hapësira e lartë ajrore e Kosovës ka qenë e mbyllur për mbikalime të mjeteve ajrore civile, dhe nën autoritetin e NATO-s. Kjo hapësirë u hap për fluturime komerciale në vitin 2014, nën menaxhimin e HungaroControl-it. Kontrollorët tanë të trafikut ajror ofrojnë shërbime në hapësirën e ulët ajrore dhe menaxhojnë ngritjet dhe aterrimet në/nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, si dhe fluturimet tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës (të kryera në shumicën e rasteve nga helikopterët e KFOR-it).

Kontrolli i trafikut ajror në hapësirën e ulët ajrore të Kosovës është nën mbikëqyrjen rregullore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë, autoritetet e Republikës së Kosovës kanë punuar ngushtë me NATO-n, KFOR-in, BE-në, ICAO-n dhe hisedarët tjerë në rajon për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit. Ky aktivitet është zhvilluar në kuadër të nismës së NATO-s: Mbledhja për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (*ang. Balkans Airspace Normalization Meeting - BANM*). Interesim të madh kanë pasur edhe kompanitë ajrore, sepse mbi Kosovë kalojnë disa rrugë që historikisht janë shfrytëzuar shumë në trafikun

ajror ndërkombëtar. Meqë hapësira e lartë ajrore me rihapjen për fluturime komerciale në vitin 2014 konsiderohet tanimë e normalizuar, aktivitetet në kuadër të BANM-it janë të fokusuara në normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, që nënkupton para së gjithash hapjen e korridoreve të reja ajrore me të gjitha shtetet fqinje.

Në vitin 2017, për herë të parë, nën udhëheqjen e NATO-s, mbledhjet e BANM-it kanë filluar të organizohen në të ashtuquajturin “nivel ekspertësh”. Pjesëmarrës në këto takime kanë qenë përfaqësues nga Republika e Kosovës, Republika e Serbisë, Mali i Zi, si dhe përfaqësues të KFOR-it.

Gjatë vitit 2021 nuk kanë vazhduar bisedimet për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore dhe hapjen e korridoreve ajrore me shtetet fqinje të Kosovës, në kuadër të takimeve për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (BANM).

7.3 MARRËVESHJA PËR HAPËSIRËN E PËRBASHKËT EVROPIANE TË AVIACIONIT (MARRËVESHJA HPEA)

Marrëveshja HPEA (ang. *European Common Aviation Area*; shq. *Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit*) është një marrëveshje multilaterale e cila krijon treg unik dhe rregulla të përbashkëta në fushën e aviacionit, e nënshkruar në mes të qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian, Islandës, Norvegjisë dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor. UNMIK-u e ka nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të Kosovës dhe e ka deklaruar atë përkohësisht të aplikueshme më 10 tetor 2006. Republika e Kosovës, përmes Deklaratës së Pavarësisë, përveç tjerash, ka marrë përsipër të gjitha detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë edhe ato të nënshkruara në emrin e saj nga UNMIK-u. Këto detyrime përfshijnë edhe zbatimin e Marrëveshjes HPEA. Zbatimi i Marrëveshjes HPEA në Republikën e Kosovës është bërë i detyrueshëm përmes Ligjit për Aviacionin Civil dhe që nga viti 2015 përmes Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Marrëveshja HPEA ka hyrë në fuqi formalisht më 1 dhjetor 2017. AAC-ja, si pikë kontakti për Marrëveshjen, përcjell zbatimin e saj nga institucionet e Kosovës. AAC-ja monitoron rregullisht legjislacionin e ndërlidhur me aviacion që nxjerr BE-ja, i informon sipas nevojës autoritetet tjera aeronautike të vendit rreth akteve të reja normative të BE-së dhe përfshin në planin e vet të veprimit, përveç akteve të detyrueshme, edhe secilin akt tjetër që e konsideron të nevojshëm dhe të aplikueshëm. Legjislacioni i BE-së, i planifikuar për zbatim në vitin 2021, është përfshirë në Programin Kombëtar për Zbatim të MSA-së.

Zbatimi i kësaj Marrëveshje është i paraparë nëpër dy faza tranzitore. Sipas vlerësimit të KE-së, janë dy çështje të mbetura për kalimin e Kosovës në Fazën II të HPEA-së: zbatimi i Direktivës për kohën e punës dhe heqja e një dispozite në Ligjin e Aviacionit për të drejtat e pasagjerëve. Deri në përfundim të periudhës raportuese, Qeveria kishte draftuar Projekt-ligjin e ri të punës i cili përmban direktivën në fjalë dhe i cili pritet të adresohet në Kuvend gjatë vitit 2022.

Për të ndihmuar publikun të përcaktojë legjislacionin kombëtar që transponon legjislacionin që rrjedh nga Marrëveshja HPEA në rendin e brendshëm juridik, AAC-ja mban të freskuar në faqen e saj zyrtare në internet “Tabelë Ekuivalence Acquis Communautaire – legjislacion i Republikës së Kosovës në fushën e aviacionit”.

a) Vizita vlerësuese nga KE për zbatimin e Marrëveshjes HPEA në Kosovë

Më 10 mars 2021, Drejtoria për transport dhe mobilitet e KE-së ka dërguar në AAC draft raportin nga vizita vlerësuese e Komisionit Evropian për nivelin e zbatimit të Marrëveshjes HPEA në Kosovë, të realizuar në shkurt të vitit 2020.

Autoritetet e Republikës së Kosovës (AAC, MMPHI, MPB, KHAIA, KNSH, MPMS dhe AKK) si dhe operatori i ANP “Adem Jashari” që i janë nënshtruar këtij vlerësimi kanë dhënë komentet e veta në draft raportin e KE-së.

Draft raporti me komente dhe freskime është përcjellë prapa në KE më dt. 4 prill 2021. Në ndërkohë AAC-ja ka dhënë edhe shpjegime tjera. Raporti përfundimtar i vizitës vlerësuese nuk është dërguar nga Komisioni Evropian deri në fund të vitit 2021.

Procesi i vlerësimit nga ekspertët e dërguar nga Komisioni Evropian i institucioneve të RKS me përgjegjësi në zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja HPEA, në të cilin ishin përfshiheshin edhe ekspertë nga EASA, ishte zhvilluar me ftesë të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së nga 10-14 shkurt 2020. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë verifikimi i nivelit të përmbushjes së obligimeve të Republikës së Kosovës karshi Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) në fushën e aviacionit civil dhe rregullimit ekonomik.

7.4 PROGRAMI SHTETËROR I SIGURISË (PSHS)

Sipas Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (LAC), AAC-ja, si autoritet me përgjegjësi në sigurinë e aviacionit civil, duhet të iniciojë dhe koordinojë hartimin dhe zbatimin e Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS) së aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Hartimi dhe zbatimi i PSHS-së është edhe njëra nga objektivat strategjike të AAC-së për periudhën 2019-2023.

Ky është një sistem i përbashkët i të gjitha institucioneve me rol në sigurinë dhe politikat e aviacionit civil, siç janë përcaktuar në LAC, në të cilin përshkruhet veprimtaria e secilit entitet shtetëror me rol në sigurinë e aviacionit, për rregullimin dhe menaxhimin e sigurisë në aviacionin civil.

Standardet për hartimin e këtij programi janë të caktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), përmes Aneksit 19 “Menaxhimi i Sigurisë” të Konventës së Çikagos. Ky Aneks ka hy në fuqi në nëntor të vitit 2013 dhe shtetet ratifikuese të Konventës janë të detyruara ta zbatojnë plotësisht atë në planet afatmesme të punës. Republika e Kosovës ende nuk ka pasur mundësi të aderojë në

këtë Konventë, mirëpo përmes Ligjit për Aviacionin Civil ka marrë obligim për zbatimin e të gjitha standardeve të ICAO-s. Zbatimi i Aneksit 19 të ICAO-s është kryer përmes Rregullores nr. 04/2018 të AAC-së për “Menaxhimin e Sigurisë” dt. 17 gusht 2018. Për të përmbushur kërkesat e PSHS-së, gjatë vitit 2021 janë ndërmarrë veprimet e përshkruara më poshtë:

a) Takimet e Komitetit të Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS) në aviacionin civil

Gjatë vitit 2021 janë mbajtur dy takime të rregullta të Komitetit për Programin Shtetëror të Sigurisë (PSHS). Më 2 korrik 2021 është mbajtur takimi i VIII-të i Komitetit për PSHS dhe më 14 dhjetor 2021 është mbajtur takimi i IX-të i këtij Komiteti. Të dyja takimet janë thirrur nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, z. Bujar Ejupi, njëherit edhe zyrtar përgjegjës për PSHS në Republikën e Kosovës. Në takime është diskutuar për situatën me COVID-19 dhe ndikimin e saj në operime, si dhe për zhvillimet e përgjithshme në aviacionin civil, sipas fushave të përgjegjësive të institucioneve të përfaqësura në Komitet. Takimet e Komitetit mbahen në përmbushje të përgjegjësive që ka ky Komitet dhe zyrtari përgjegjës për PSHS, siç janë përshkruar në dokumentin “Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komitetit”.

Komiteti i PSHS-së në Republikën e Kosovës është themeluar përmes Vendimit nr. 05/96 të Qeverisë, më 26 qershor 2016. Anëtarë të këtij Komiteti përveç AAC-së janë edhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencia për Shërbime të Navigacionit Ajror, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

b) Veprimtaria e Këshillit të Sigurisë në AAC

Këshilli i Sigurisë në AAC ka mbajtur një seri takimesh gjatë vitit 2021. Këshilli është takuar për shqyrtimin dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme të sigurisë. Me përbërjen e re të Këshillit, gjatë vitit 2021 janë hartuar dhe miratuar edhe Termat e reja të Referencës për punën e Këshillit.

Gjatë vitit 2021 Këshilli ka arritur:

- Të shqyrtojë ndodhitë e raportuara me status të hapur për t’u mbyllur pas rekomandimeve;
- Të shqyrtojë raportin e inspektimit në ASHNA të realizuar në muajin shkurt, i cili rezulton me një gjetje të nivelit 1;
- Të shqyrtojë raportin nga KHAIA për sulmet e shpezëve dhe rekomandimet për AAC-në; dhe
- Të përcjellë zhvillimet kyçe në projektin e zgjatjes së pistës në aeroport.

c) Zhvillimet në menaxhimin e sigurisë së aviacionit

Mbështetje në zbatimin e Rregullores për kërkim dhe shpëtim në aviacionin civil (Aneksi 12 i ICAO/ONAC)

Gjatë vitit 2021, AAC-ja, përmes Drejtorit për Siguri dhe Cilësi, ka vepruar në kuadër të ekipit koordinues, me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) për t'u dakorduar dhe koordinuar për veprimet për zbatimin e Rregullores nr. 01/2018 të MPB-së për kërkim dhe shpëtim në aviacionin civil, e cila e transponon Aneksin 12 të ICAO-s për kërkim dhe shpëtim.

AME ka hartuar një plan pune, i cili identifikon veprimet e nevojshme në Republikën e Kosovës, në nivel të grupit punues dhe atij koordinues, deri në zhvillim të Planit për kërkim dhe shpëtim në territorin jashtë radiusit prej 8 km nga aeroporti, si dhe mbështetjen në zbatim të këtij plani.

Janë identifikuar ekspertë ndërkombëtar për të mbështetur Kosovën në hartimin e Planit për kërkim dhe shpëtim në Republikën e Kosovës. Pas identifikimit, është bërë kërkesa zyrtare përmes dorëzimit të formularit në TAIEX (Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacioneve) të Komisionit Evropian, për të siguruar mbështetje nga ekspertë të kësaj fushe. Kërkesa është miratuar nga TAIEX-i.

Plani i veprimit, i hartuar për zbatimin e Rregullores për kërkim dhe shpëtim është përcjellur dhe është mbajtur i përditësuar. Bartëse e këtij procesi është AME në kuadër të MPB-së.

Përfaqësimi i AAC-së në Komisionin për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve në nivel vendi

AAC-ja, përmes Drejtorit për Siguri dhe Cilësi ka mbështetur grupin formal, i cili do të merret me rishikimin e dokumentacionit në fuqi për rrezikshmërinë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Grupi punues është emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME). Gjatë vitit 2021, grupi punues ka mbajtur disa takime për të filluar dhënjen e kontributit nga institucionet relevante të përfaqësuara në këtë grup. Ky projekt, sipas planit dinamik, duhet të përfundojë në pjesën e dytë të vitit 2022 dhe puna e tij mbështetet në Rregulloren nr. 25/2020 të MPB-së për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

d) Menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhjeve në aviacion (OR)


Me qëllim të ngritjes së sigurisë së aviacionit, duke parandaluar aksidentet dhe incidentet, AAC-ja mbledh dhe analizon informacione të nevojshme të sigurisë së aviacionit civil përmes sistemit të saj të raportimit të ndodhjeve. Këto informacione i mundësojnë AAC-së dhe industrisë që të informohen për rreziqet e sigurisë me të cilat ballafaqohen, me qëllim të mbështetjes së spektrit të plotë të aktiviteteve në menaxhimin e sigurisë, duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e veprimeve lehtësuese aty ku është e përshtatshme. Informacionet relevante të sigurisë raportohen, mbledhen, ruhen, mbrohen, shkëmbehen, shpërndahen dhe analizohen në përputhje me kërkesat e

Rregullores së AAC-së nr. 09/2017 për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil.

Gjatë vitit 2021 AAC-ja ka pranuar raportime për gjithësejt 225 ndodhi në aviacionin civil, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me numrin e ndodhive të raportuara gjatë viteve të fundit. Kjo natyrisht përkon edhe me rritjen e numrit të operimeve krahasuar me vitin 2020, i cili kishte pësuar nga kufizimet në fluturime për shkak të pandemisë.

Numri i përgjithshëm i ndodhive të raportuara në AAC, që nga viti 2006 deri në fund të vitit 2021 ka arritur në gjithsejtë 1844 ndodhi. Besohet se nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në numrin e raportimeve të ndodhive krahasuar me numrin e fluturimeve dhe kjo tregon nivelin e vetëdijesimit të pjesëmarrësve në industrinë e aviacionit dhe përkushtimin e tyre për të raportuar, si dhe mund të tregojë nivelin e kënaqshëm të sigurisë në aviacionin civil.

Ndodhitë e raportuara janë koduar në kategori të ndryshme sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi dhe bashkë me kategoritë e ndodhive të dy viteve të mëparshme janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm, i cili është bazuar në të dhënat e nxjerra nga baza e të dhënave e AAC-së në platformën softuerike ECCAIRS 5 (Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve).



Kategorizimi i ndodhive të raportuara gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 (kodimi i ndodhive sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi)


Nga grafiku i mësipërm mund të vërehet se në krahasim me kategoritë e ndodhive të viteve 2019 dhe 2020, kategoritë e vitit 2021 të cilat kanë pasur ngritje dhe kanë ndikuar në rritjen e numrit të përgjithshëm të ndodhive janë: RAMP (trajtimi në tokë, vetëm krahasuar me vitin 2020), ATM (menaxhimi i trafikut ajror/komunikimi, navigimi dhe vrojtimi), BIRD (goditja e shpendit), SEC (e lidhur me sigurimin, e cila përmban nënkategorinë e ndodhive të lidhura me sulmet me laser), WILD (përplasia me kafshët e egra, vetëm krahasuar me vitin 2020), dhe OTHR (tjetër).

Nënkategoria e ndodhive të sulmeve me laser ka pësuar rritje në krahasim me vitin 2020, gjë që nuk është e mirëpritur pasi që shndritja e rrezeve laserike drejt mjeteve ajrore në fluturim paraqet pengesë të madhe për pilotët dhe mund t'i verbojë ata gjatë fazave kritike të fluturimit, siç janë ngritja dhe aterrimi, e që si rrjedhojë kjo paraqet rrezik serioz për sigurinë e udhëtarëve dhe ekuipazheve, si dhe të njerëzve që jetojnë në afërsi të aeroporteve. Këto sulme përbëjnë vepra penale dhe kryhen qëllimisht nga persona të papërgjegjshëm.

Ndërsa kategoritë të cilat kanë pësuar rritje të dukshme, me numra të dyfishuar dhe më të mëdhenj janë dy kategoritë në vijim: RAMP (trajtimi në tokë) dhe ATM (menaxhimi i trafikut ajror/komunikimi, navigimi dhe vrojtimi).

Duhet të theksohet që në realitet janë raportuar dhe proceduar 225 ndodhi, numër ky i dyfishuar nga numri i ndodhive të procesuara në vitin 2020.

Po ashtu, ndodhitë e raportuara janë klasifikuar në klasa të ndryshme bazuar në ashpërsinë e ndikimit të tyre në operimet e sigurta të mjeteve ajrore dhe në njerëzit në bordin e tyre.



Numri i ndodhive të raportuara sipas muajve gjatë vitit 2021

Siç mund të shihet në grafikun e mësipërm, nga 225 ndodhitë e pranuar nga AAC-ja gjatë vitit 2021, muaji me numrin më të madh të ndodhive është edhe muaji që pothuajse çdo vit ka numrin më të madh të fluturimeve dhe udhëtarëve, muaji korrik. Gjatë muajve korrik dhe gusht shënohet edhe piku i fluturimeve, si dhe sezona kur pranojmë shumë udhëtarë nga diaspora jonë.

7.5 ÇËSHTJET E AVIACIONIT TË NDËRLIDHURA ME INTEGRIMIN EVROPIAN

a) Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

AAC-ja ka dorëzuar inputin për Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) i cili është vendosur në Planin Kombëtar. Pas kërkesës nga MIE për rishikim të PKZMSA-së, më 2 korrik 2021 AAC-ja ka dorëzuar në ZKM një plan të rishikuar. Për vitin 2021, AAC-ja ka planifikuar transponimin e 6 rregulloreve të BE-së. Është arritur të transponohen 5 prej 6 masave të planifikuara. Masa e cila nuk është finalizuar është bartur në vitin 2022.

Realizimi i PKMZSA 2021 nga ana e AAC-së është prezantuar në tabelën e mëposhtme:

	Masa e planifikuar	Planifikimi	Përditësimi i progresit
1	Rregullore për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 1/2019 në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit dhe shtyrjen e datave të zbatimit të masave të caktuara në kontekstin e pandemisë COVID-19	K2 2021	Rregullorja (AAC) nr. 07/2021 e nxjerrë më 11.08.2021
2	Rregullorja për përcaktimin e kërkesave për performancën dhe interoperabilitetin e mbikëqyrjes (survejimit) për qiellin e vetëm evropian (plotësim-ndryshim), e miratuar	K3 2021	Rregullorja (AAC) nr. 08/2021 e nxjerrë më 10.09.2021
3	Rregullore për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 5/2015 në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit, dhe në lidhje me raportimin, analizën dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil	K3 2021	Transpozuar përmes Rregullores (AAC) nr. 09/2021 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 01/2019 e nxjerrë më 13.12.2021
4	Rregullore për ndryshimin e Rregullores 1/2020 dhe 17/2017 sa i përket lëvizjes së automjeteve në aerodrome, formatit global të raportimit dhe aktiviteteve tjera në aerodrom, e miratuar	K3 2021	Rregullorja (AAC) nr. 06/2021 e nxjerrë më 23.07.2021
5	Rregullore për ndryshimin e Rregulloreve 01/2020 dhe 17/2017 sa u përket kërkesave për menaxhimin e trafikut ajror/shërbimet e navigacionit ajror,	K4 2021	Projekt rregullorja ka kaluar konsultimin publik dhe është

	dizajnimit të strukturës së hapësirës ajrore, cilësisë së të dhënave, sigurisë në pistë dhe shfuqizimin e Rregullores 08/2015, e miratuar		dërguar për opinion ligjor në ZKM. Kalon në 2022
6	Rregullore për ndryshimin e Rregullores 17/2017 në lidhje me kushtet dhe procedurat për deklarim nga organizatat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të platformës (akt nënligjor i ri), e miratuar	K4 2021	Rregullorja (AAC) nr. 10/2021 e nxjerrë më 29.12.2021

b) Raporti i Vendit për Kosovën i Komisionit Evropian

Më 19 tetor 2021, KE ka publikuar Raporti për Kosovën për vitin 2021. Sipas përkthimit zyrtar, Raporti në pjesën e Transportit Ajror thotë:

Sa i përket transportit ajror, Kosova është pjesë e zonës së përbashkët evropiane të aviacionit dhe mbulohet nga marrëveshjet për qiellin e vetëm evropian. Ky sektor vazhdon të përballët me një numër sfidash për shkak të mos-anëtarësimit të Kosovës në disa organizata ndërkombëtare të aviacionit civil. Mungesa e të hyrave nga menaxhimi hapësirës së sipërme ajrore dhe dobësitë institucionale të Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror dhe Autoritetit të Aviacionit Civil mbetet sfida. Këto institucione duhet të forcohen, ndërsa menaxherët duhet të emërohen duke respektuar parimin e rekrutimit meritior. Riorganizimi i Autoritetit të Aviacionit Civil dhe reformat administrative duhet të bëhen duke marrë parasysh si zotimet e marra përsipër për parimet e reformës së administratës publike ashtu edhe rrethanat dhe kërkesat specifike të sektorit të aviacionit. Përveç kësaj, Kosova ka vazhduar përafrimin e saj progresiv me legjislacionin e BE-së për Marrëveshjen e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe duhet ta vazhdojë këtë punë për të përmbushur të gjitha kërkesat.

c) Takimi i Komitetit dhe Këshillit të MSA-së

Më 16 qershor 2021, AAC-ja ka pranuar Konkluzionet e takimit të IV të Komitetit për MSA të mbajtur më 15 tetor 2020 virtualisht. Sa i përket aviacionit, thuhet: “Sa u përket politikave të transportit, autoritetet kosovare njoftuan se ishin miratuar katër akte nënligjore dhe një ishte në pritje për miratim. Një vlerësim për politikën zhvillimore strategjike në sektorin e aviacionit civil ishte duke u kryer.”

AAC-ja ka raportuar me shkrim në ZKM lidhur me progresin e arritur në mes të dy takimeve të Komitetit të Stabilizim-Asocimit. Raporti ka përfshirë aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me MSA gjegjësisht PKZMSA-në në përgatitje për Takimin e V të Komitetit të Stabilizim-Asocimit BE-Kosovë i cili u mbajt më 28 tetor 2021.

7.6 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

AAC-ja ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse për aviacionin civil në Republikën e Kosovës në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikën më të

mira ndërkombëtare. Poashtu, sipas nevojës, është ofruar përkrahje profesionale në fushën e aviacionit civil për institucionet tjera të shtetit.

a) Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet AAC-së dhe AIP-së

Më datën 19 mars 2021, është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi dhe përkrahja administrative e profesionale në mes të këtyre dy agjencive në fushën e rregullave financiare, përkatësisht shpenzimit të parasë publike dhe fushave tjera për të cilat Zyrtarët Kryesorë Administrativ të këtyre dy institucioneve kanë të drejtë të lidhin marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të zyrtarëve, sipas dispozitave të LMFP-së dhe Marrëveshjes për shërbime të dyanshme ndërmjet institucioneve, në përputhje me Nenin 37 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

b) Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet AAC-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes

Me datën 1 prill 2021, në ambientet e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe Autoritetit të Aviacionit Civil. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi reciprok me interes të të dyja palëve në fushën e shkëmbimit të informacioneve, trajnimeve, operacioneve të përbashkëta dhe mbështetjes reciproke në fushën e sigurisë dhe aviacionit, si dhe në përdorimin e aseteve dhe infrastrukturës.

Të dyja palët janë dakorduar për intensifikimin e takimeve me synim të avancimit dhe adresimit të çështjeve që lidhen me aviacionin në Republikën e Kosovës.

c) Takimi me Departamentin Qendror për PPP-në në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

Më datën 11 mars 2021, Drejtori i përgjithshëm, së bashku me bashkëpunëtorët priti në takim Drejtorin e Departamentit Qendror për PPP-në në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, z. Arton Ahmeti së bashku me bashkëpunëtorët e tij. Në këtë takim u diskutua rreth bashkëpunimit në mes të AAC-së dhe DQPPP-së, me theks të veçantë për padinë e operatorit LKIA (Limak) kundër Vendimit të lëshuar nga AAC-ja për hapjen e tregut të shërbimeve në tokë.

AAC-ja ka njoftuar përmes shkresave Komitetin e PPP-së për refuzimin e LKIA-së për të zbatuar Rregulloren nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë si dhe Vendimin nr. 01/ZDP/VE/2021 të AAC-së, të datës 19 janar 2021, lidhur me lejimin e qasjes në treg për ofruesit e tjerë të shërbimeve në tokë.

Aprovimi i ofrueseve të shërbimeve në tokë është i lidhur ngushtë me sigurimin e qasjes në treg (qasjes në infrastrukturën e centralizuar të aeroportit), si dhe me tarifën të cilën LKIA e aplikon ndaj shfrytëzuesve të kësaj infrastrukture, të rregulluar sipas

Rregullores nr. 04/2011, me ndryshime, dhe Vendimit Ekzekutiv të AAC-së nr. 01/ZDP/VE/2021, të datës 19.01.2021, i cili kërkon që infrastruktura e centralizuar të menaxhohet në mënyrë transparente, objektive dhe jo-diskriminuese dhe në veçanti, të mos pengohet qasja e furnizuesve të shërbimeve në tokë, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

AAC-ja ka kërkuar nga Komiteti i PPP-së që të përkrahë AAC-në në zbatimin e legjislacionit në fuqi (Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Rregullores nr. 04/2011) dhe avancimin e aviacionin civil në Republikës e Kosovës. AAC-ja poashtu ka informuar dhe njoftuar Komitetin e PPP-së lidhur me aplikuesit e dytë si ofrues të shërbimeve në tokë dhe se si LKIA deri më tani ka refuzuar që të zbatojë Rregulloren nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë si dhe Vendimin e AAC-së 01/ZDP/VE/2021, të datës 19.01.2021, lidhur me lejimin e qasjes në treg për ofruesit tjerë të shërbimeve në tokë.

Përmes shkresave dërguar Komitetit të PPP-së, AAC-ja ka kërkuar shpjegim për tarifën e aplikuar nga LKIA ndaj “Ex-Fis” e cila është 0.12 euro, për të cilën tarifë AAC-ja nuk ka qenë e informuar paraprakisht dhe nuk është aprovuar nga AAC-ja. Deri më tani, AAC-ja nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga Komiteti PPP për këtë çështje. AAC-ja është në dijeni se në bazë të Marrëveshjes për PPP-në në ANP, Aneksi 11, pjesa B, LKIA ka të drejtë të aplikojë tarifën prej 0.02 euro ndaj operatorit që ofron shërbime për furnizim me karburante. AAC-ja respekton plotësisht Marrëveshjen për PPP-në, mirëpo konsideron që nuk mund të caktohet asnjë tarifë shtesë jashtë kontratës së PPP-së e cila në të njëjtën kohë nuk është e aprovuar nga AAC-ja, në cilësinë e rregullatorit ekonomik.

d) Takimi me AMMK-në lidhur me arritjen e një marrëveshjeje me AAC-në

Gjatë muajit dhjetor 2021, është realizuar një takim me Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), ku janë diskutuar mënyrat për arritjen dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje MOU ndërmjet dy palëve, lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe impaktit që mjedisi mund të ketë në sigurinë e aviacionit civil, me theks të veçantë në fushën e menaxhimit të botës shtazore në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” dhe në rrethinën e tij.

Ky bashkëpunim do të shtrihej kryesisht në dy fusha, në atë të monitorimit dhe studimit të habitatit dhe gjendjes në aeroport dhe në rrethinën e tij (Ligatina e Hencit, kodra e Goleshit, etj.), si dhe në monitorimin e aktiviteteve të ndërtimit, të cilat mund të jenë atraktive për shpezët (p.sh. ndërtimi i deponive të mbeturinave, i baseneve për kultivimin e peshqve, et j.) në një perimetër prej 13 km nga aeroporti.

7.7 AKTIVITETI I AAC-së NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR

AAC-ja ka shfrytëzuar çdo mundësi për thellimin e bashkëpunimit me AAC-të e shteteve tjera. Sidoqoftë, për shkak se vendi ynë ende nuk ka pasur mundësi të hyjë në

marrëdhënie kontraktuale me BE-në në fushën e aviacionit civil, ende ka pengesa serioze në trajtimin tonë si partner plotësisht i barabartë me AAC-të tjera të rajonit.

a) Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil

AAC-ja i kushton rëndësi të madhe bashkëpunimit me autoritetet homologe të rajonit, duke marrë parasysh se të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë duke kaluar nëpër të njëjtën sfidë - atë të harmonizimit të legjislacionit, rregullave dhe standardeve në aviacionin civil me ato të BE-së. Për të formalizuar këtë bashkëpunim, janë nënshkruar një sërë marrëveshesh për bashkëpunimin teknik që nga themelimi i AAC-së në vitin 2009.

i. Përdorimi i hapësirës ajrore të Kosovës për procedurën e uljes në Aeroportin e Kukësit

Në vazhden e koordinimit të aktiviteteve të nisura në dhjetor të vitit 2020, edhe gjatë viti 2021 janë zhvilluar një numër i takimeve ndërmjet palëve relevante, në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore të Kosovës për procedurën e uljes në Aeroportin e Kukësit.

Fillimisht, janë organizuar disa takime me autoritetet vendase në Kosovë me qëllim të bashkërendimit të veprimeve dhe harmonizimit të qëndrimeve. Më 05.01.2021, është mbajtur një takim me përfaqësuesit e ASHNA-s, më 11.01.2021 është mbajtur një takim me përfaqësuesit e FSK-së, më 15.01.2021 me përfaqësuesit e KFOR-it dhe ASHNA-s, ndërsa më 19.01.2021, në zyret e AAC-së, është organizuar një takim bilateral ndërmjet autoriteteve të Shqipërisë dhe të Kosovës për të diskutuar hapjen e Aeroportit të Kukës, në të cilin ishin ftuar të gjitha palët relevante.

Gjatë këtij takimi është propozuar projekti nga ana e AlbControlit, si dhe është dakorduar që AlbControl të dërgojë një kërkesë zyrtare me dy propozime, njëri propozim i shpejtuar, për të mundësuar procedim të menjëhershëm të kërkesës, dhe propozimi tjetër për zgjidhje afatgjate, i cili do të procedohej sipas të gjitha procedurave.

Po ashtu, më datë 15.06.2021 është mbajtur një takim ndërmjet përfaqësuesve të palës shqipëtare, përfshirë AlbControl-in, dhe palës kosovare, përfshirë AAC-në, ASHNA-në, këshilltarin për aviacion të deleguar nga AAC-ja tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përfaqësuesit e KFOR-it dhe FSK-së.

Në takim është diskutuar lidhur me nisjen e bisedimeve për procedurat e fluturimit të Aeroportit të Kukësit.

Më 05.07.2021, Departamenti i SHNA-së ka dorëzuar tek Drejtori i Përgjithshëm draft njoftimin për ICETRA-n, në lidhje me fillimin e operimeve në Aeroportin e Kukësit dhe për takimet e mbajtura në janar dhe qershor të vitit 2021 me palët e involvuara.

Më 08.07.2021, në ambientet e ASHNA-s, është mbajtur takim ndërmjet përfaqësuesve të AAC-së, ASHNA-s, këshilltarit për aviacion të deleguar nga AAC-ja tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe përfaqësuesve të KFOR-it. Në takim është diskutuar lidhur me procedurat e fluturimit të Aeroportit të Kukësit dhe me marrëveshjen ndërmjet AlbControl-it dhe ASHNA-s.

Më 26.07.2021, është pranuar një letër me të cilën KFOR-i, miraton përkohësisht fluturimet komerciale, të planifikuara për Aeroportin e Kukësit.

ASHNA ka dorëzuar draft LoA-në, mirëpo e njëjta është kthyer me komente, pasi që LoA duhet t'i plotësojë të gjitha kërkesat ligjore, si dhe të jetë sipas modelit të EUROCONTROL-it për marrëveshje të tilla. SHNA-ja është ende në pritje të draftit final të saj.

I gjithë ky ndryshim afekton hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës dhe ai do të trajtohet sipas procedurës për ndryshime të manualit të SHNA-së, e cila është e shtjelluar tek nëntitulli: Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s (Ndryshimi "CH-2021-01 LAKU operations").

Ndërsa, gjatë tremujorit të fundit ka pasur shkëmbime të disa e-mailave me ASHNA-në në lidhje me këtë temë, dhe SHNA-ja është duke pritur nga ASHNA dokumentacionin dhe informatat e kompletuara, në mënyrë që të procedojë me miratimin e ndryshimit.

Gjatë vitit 2021, të gjitha fluturimet me destinacion Aeroportin e Kukësit janë realizuar si rezultat i takimeve të përbashkëta me KFOR-in dhe pas aprovimit të tyre nga KFOR-i. Aprovimet bëhen për secilin fluturim veç e veç (Case by Case) deri në një vendim tjetër nga KFOR-i, kur këto fluturime do të trajtohen si fluturime të cilat nuk kërkojnë aprovime të veçanta paraprake nga KFOR-i.

ii. Bashkëpunimi ndërmjet departamenteve të aerodromeve nga Kosova dhe Shqipëria

Departamenti i Aerodromeve ka vazhduar edhe më tutje bashkëpunimin ndërshtetëror ndërmjet AAC-së së Republikës së Kosovës dhe AAC-ve të rajonit. Gjatë vitit 2021, autoritetet e aviacionit civil të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë kanë bashkëpunuar ngushtë në realizimin e synimit të përbashkët: shkëmbimi i përvojave për një aviacion më të sigurt.

Në kuadër të marrëveshjes dypalëshe, inspektorët e aerodromeve kanë pranuar ftesë zyrtare për ofrimin e përkrahjes profesionale kolegëve të AACSH-së gjatë auditimit gjithëpërfshirës, si pjesë e procesit të certifikimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Kukësit, bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Pas përfundimit të rishikimit të dokumentacionit të prezantuar nga aeroporti dhe përgaditjes së listave kontrolluese nga AACSH-ja, nga data 29 deri më 31 mars 2021 është realizuar auditimi i përbashkët certifikues, ku përveç Departamentit të Aerodromeve, kanë marrë pjesë të gjitha njësitë relevante të rregullatorit të aviacionit civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë

Departamentin e Sigurimit, Departamentin e Shërbimeve të Navigimit Ajror, etj. Sa i përket Departamentit të Aerodromeve, në auditimin gjithëpërfshirës ishte planifikuar të verifikoheshin karakteristikat fizike dhe infrastruktura e aerodromit, ndriçimi aeronautik dhe ndihmesat vizuale, procedurat, pajisjet dhe stafi esencial për funksionalizimin e sigurt të aerodromit (përfshirë shërbimin për zjarrfikje dhe shpëtim), sistemi i menaxhimit të sigurisë, plani emergjent, shërbimi i operimeve në platformë, shërbimi i transportit të mallrave të rrezikshme, siguria e lëvizjes së automjeteve në fushën ajrore, mirëmbajtja e fushës ajrore dhe menaxhimi i rrezikut nga bota shtazore, si dhe kontrolli i pengesave në zonat mbrojtëse të aeroportit. Raporti është përpiluar bashkërisht, kurse përcjellja e gjetjeve ka vazhduar nga AACSH-ja.



Foto nga auditimi në Aeroportin e Kukësit

Në kuadër të shkëmbit të përvojave profesionale, gjatë tetorit 2021, inspektorët e aerodromeve të AACK-së kanë organizuar një inspektim të përbashkët me inspektorët e AACSH-së në ANP “Adem Jashari” LKIA me temë “Plani emergjent i aeroportit, shërbimi zjarrfikës dhe largimi i aeroplanëve jofunksional nga pista”.

iii. Bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe atij të Kroacisë

Më datë 30 shtator 2021, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar më 8 dhjetor 2010 ne mes të Agjencisë Kroate të Aviacionit Civil (HACZ) dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AACK), u mbajt një takim pune i drejtuesve të dy organizatave në ambientet e HACZ-it.

Në takim u diskutua për bashkëpunimin aktual ndërmjet dy autoriteteve të aviacionit civil, si dhe për format e ardhshme konkrete të bashkëpunimit në fushën e inspektimeve SAFA dhe në zbatimin e Trajnimit të Bazuar në Performancë (PBT) kur bëhet fjalë për transportin e mallrave të rrezikshëm.

Në takim morën pjesë Drejtori i HACZ-it z. Marin Puh dhe Zëvendës drejtori i HACZ-it z. Zlatko Širac, Drejtori i AACK-së z. Bujar Ejupi, së bashku me Drejtorin e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve z. Kushtrim Musa dhe Inspektorin e Vlefshmërisë Ajrore z. Matej Krasniqi.

iv. Bashkëpunimi në fushën e mjekësisë së aviacionit

Më datë 4 shkurt 2021, me ftesë të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë (AACSH), Vlerësuesi i Autorizuar Mjekësor (AMA) i AACK-së Dr. Avdiu ka marrë pjesë në zhvillimin e aktivitetit të auditimit, në kuadër të ekipit të auditimit të AACSH-së, të kryer në Spitalin "Salus" sh.a., në Tiranë. Ky institucion ka aplikuar pranë AACSH-së, me qëllim të aprovimit në cilësinë e Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) në Republikën e Shqipërisë.

b) Koordinimi i asistencës teknike në fushën e aviacionit

AAC është pikë kontakti për një numër projektsh të asistencës teknike në aviacion që i ofrohen vendit tonë nga BE-ja në kuadër të instrumenteve të disponueshme për shtetet që synojnë anëtarësim në BE. Gjatë vitit 2021, vëllim më i madh i asistencës teknike ka qenë nga fondet e BE-së përmes Projektit EASA IPA 5, ndërsa ka pasur asistencë teknike falas edhe nga AAC e Francës, siç është përshkruar më poshtë.

i. Projekti EASA IPA 5

EASA IPA 5 është një projekt i asistencës teknike i financuar nga KE-ja dhe i implementuar nga EASA (Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit). Ky projekt është vazhdim i projekteve të mëparshme IPA. Implementimi i IPA 5 ka filluar nga data 01 shkurt 2020 dhe do të zgjasë për 36 muaj, deri në janar 2023. Secili aktivitet është koordinuar ndërmjet AAC-së së Kosovës dhe EASA-s për të marrë parasysh nivelin e zhvillimit të industrisë dhe nevojat specifike që kanë inspektorët e aviacionit të AAC-së drejt zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore në fusha të ndryshme të aviacionit civil. Gjatë vitit 2021, AAC-ja ka përfituar 6 trajnime, 4 punëtori dhe 2 trajnime në vend të punës.

Në kuadër të projektit aktual, EASA IPA 5, AAC-ja e Kosovës ka përfituar nga aktivitetet si vijon:

1. Punëtori mbi përdorimin fleksibil të hapësirës ajrore, janar 2021;
2. Punëtori mbi certifikimin dhe mbikëqyrjen e Shërbimit të Informativ të Fluturimeve të Aerodromit (AFIS), shkurt 2021;
3. Trajnim mbi vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore, prill 2021;
4. Punëtori mbi praktikën më të mira për sistemin e menaxhimit në AAC (pjesa e parë), prill 2021;
5. Punëtori mbi praktikën më të mira për sistemin e menaxhimit në AAC (pjesa e dytë), maj 2021;

6. Punëtori mbi transpozimin e Rregullores bazë të EASA, maj 2021;
7. Trajnim mbi Rregulloren e dronëve, qershor 2021;
8. Punëtori mbi praktikat më të mira të zbatimit të kërkesave në fushën e aeromjekësisë, korrik 2021;
9. Trajnim në vend pune mbi menaxhimin e botës shtazore në aeroport, tetor 2021;
10. Trajnim mbi operimet e bazuara në performancë, tetor 2021;
11. Trajnim mbi mbikëqyrjen e operatorëve sa i përket dizajnit të procedurave të fluturimit, nëntor 2021; dhe
12. Trajnim në vend pune mbi aprovimin e ndryshimeve në fushën e menaxhimit të trafikut ajror, nëntor-dhjetor 2021.

Nga këto aktivitete kanë përfituar inspektorët e AAC-së dhe zyrtarë të operatorit të aeroportit si dhe të ASHNA-s. Trajnimet dhe punëtoritë janë ndjekur kryesisht në mënyrë virtuale dhe do të vazhdojnë kështu edhe gjatë vitit 2022 deri në përmirësimin e situatës epidemiologjike.

ii. Asistenca teknike nga AAC-ja e Francës

AAC-ja e Francës ka vazhduar ta mbështesë AAC-në e Kosovës përmes ofrimit falas të trajnimeve profesionale në aviacion si më poshtë:

1. Trajnim mbi transportin ajror të qëndrueshëm, prill 2021;
2. Trajnim mbi rregulloren e re bazë të EASA, prill 2021;
3. Punëtori mbi mbikëqyrjen në aviacionin civil të bazuar në risk dhe performancë, maj 2021;
4. Konferencë mbi digjitalizimin e MTA (Menaxhimit të trafikut ajror), qershor 2021;
5. Trajnim mbi teknikat e auditimit, tetor 2021; dhe
6. Menaxhimi i komunikimit në kohë krizash, tetor 2021.

7.8 AKTIVITETI RREGULLATOR/MBIKËQYRËS

Funksioni bazë i AAC-së është mbikëqyrja dhe rregullimi i aktiviteteve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës me qëllim të garantimit të operimeve të sigurta në përputhje me standardet në fuqi. Kjo arrihet përmes inspektimit, auditimit, licencimit dhe certifikimit. AAC-ja ka një personel profesional dhe kompetent për rregullimin e aviacionit civil në vend. Aktiviteti rregullator i AAC-së përfshin sigurinë e aviacionit civil në përgjithësi dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Në vazhdim do të jepet një pasqyrë e përmbledhur e aktiviteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të AAC-së në fushën e sigurisë së aviacionit, të ndara në këto kategori: siguria e fluturimeve, certifikimi e licencimi, shërbimet e navigacionit ajror dhe aerodromet. Gjithashtu, do të jepet një pasqyrë e përmbledhur edhe për aktivitetet e rregullimit ekonomik në aeroport, në ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror dhe në ofruesit e shërbimeve për aeroplanë në tokë.

a) Siguria e fluturimeve, certifikimi dhe licencimi

i. Inspektimet e mjeteve të huaja ajrore në platformë

Në pajtim me nenin 50 të Ligjit për Aviacionin Civil, inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve (DSF) gjatë vitit 2021 kanë kryer njëzet e tre (23) inspektime të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj (SAFA - Vlerësimi i Sigurisë së Mjeteve të Huaja Ajrore), të cilët operojnë në ANP “Adem Jashari”.



Ky numër i inspektimeve të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj paraqet një ngritje afërsisht 60% nga viti paraprak (2020), i cili kishte rënie madhore të numrit të inspektimeve si pasojë e situatës së krijuar me pandeminë globale të koronavirusit (COVID-19) dhe shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik nga Qeveria e Republikës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

Janë inspektuar aeroplanët e këtyre kompanive ajrore: Chair Airlines (GSW), Trade Air (TDR), Air Mediterranean (MAR), Tui Airlines Germany (TUI), Helvetic (OAW), Wizz Air (WZZ), Swiss Air Ambulance (SAZ), Edelweiss Air (EDW), EasyJet Switzerland (EJS), Eurowings (EWG), Bul Air (BVL), Austrian Airlines (AUA),

Enter Air (ENT), GP Aviation (GPX), Pegasus Airlines (PGT), British Airways (BAW), ETF Airways (ETF), Air Bohemia (BOH), Pan Jet (PAN), Quick Air Jet (QAJ) dhe Get Jet Airlines (GJT).

Gjatë këtyre inspektimeve është konstatuar një gjetje e kategorisë 3B (veprime korrigjuese para fluturimit), e cila ka të bëjë me elementin B12 që ndërlidhet me kabinën e udhëtarëve. Për këtë gjetje është njoftuar operatori ajror si dhe autoriteti i aviacionit civil i shtetit i cili e ka certifikuar operatorin ajror në fjalë.

Për më tepër bazuar në marrëveshjen në mes të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë për bashkëpunim dhe shkëmbim të ekspertizës, inspektorët SAFA të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve të AACK-së në bashkëpunim me inspektorët SAFA të AACSH-së kanë realizuar inspekte të përbashkëta të aeroplanëve të operatorëve të huaj të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”.

Gjatë inspektimeve të përbashkëta janë realizuar shtatë (7) inspekte të operatorëve ajror, prej të cilave 3 inspekte SAFA janë kryer në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe 4 inspekte në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Operatorët ajror të inspektuara në Tiranë janë:

- FlyNas (KNE);
- Privilege (PVG);
- British Airways (BAW); dhe
- Swiss Airlines (SWR).

ii. Auditimet e operatorëve të aviacionit

Gjatë vitit 2021, në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të masave për frenimin e përhapjes së virusit COVID-19 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, janë realizuar gjithsej dymbëdhjetë (12) inspekte *ad-hoc*, me qëllim të verifikimit të zbatimit të masave në kuadër të Planit të Veprimit të hartuar dhe të paraqitur nga ana e LKIA-së para AAC-së, duke u bazuar në dokumentet relevante të hartuara nga AAC, EASA, ECDC dhe ICAO. Qëllimi i këtyre inspektimeve ishte rikthimi gradual i operimeve në transportin ajror pas shpalljes së gjendjes së emergjencës publike shëndetësore për shkak të pandemisë së COVID-19, me theks të veçantë duke u bazuar në Listën Kontrolluese (*check-list*) të hartuar nga EASA, me qëllim të zbatimit sa më uniform të masave për frenimin e përhapjes së COVID-19 në kontinentin evropian. Si rezultat, janë mbikëqyrur masat e ndërmarra nga operatori gjatë hyrjes në terminalin e pasagjerëve, gjatë procedurave në nisje/mbërritje brenda terminalit, duke hartuar raportet përkatëse për AAC-në.

Siç është cekur më lart në nëntitullin: Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil (Bashkëpunimi në fushën e mjekësisë së aviacionit), më 4 shkurt 2021, vlerësuesi i autorizuar mjekësor Dr. Avdiu ka marrë pjesë në auditimin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë të kryer në Spitalin “Salus” sh.a., në Tiranë, i cili kishte aplikuar për t’u aprovuar si Qendër e Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) në Republikën e Shqipërisë.

Nga 10-15 korrik 2021, Inspektori i Vlefshmërisë Ajrore ka marrë pjesë në inspektimin fizik dhe vlerësimin e dokumentacionit përkatës të aeroplanit të operatorit nën mbikëqyrje të Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë (AACSH), me qëllim të regjistrimit të këtij aeroplani në regjistrin e mjeteve ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Më datë 27 korrik 2021 është audituar organizata trajnuese për paraglajdzëm “Akademia e Aviacionit Artan Venhari”. Me këtë rast organizatës trajnuese për paraglajdzëm i është vazhduar aprovimi deri më datë 26 korrik 2024.

Më datë 22 shtator 2021 është audituar Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës (QKMP) në Gjakovë, e autorizuar nga AAC-ja në cilësinë e Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC). Si rezultat, është konstatuar një gjetje e nivelit të dytë, e cila duhet të adresohet në nivel ndërinstitucional, në relacionin AAC - Ministria e Shëndetësisë - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK).

Më datë 28 shtator 2021, Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve kanë realizuar auditimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” (LKIA) me qëllim të aprovimit të aplikuesit për Certifikatë për mallra të rrezikshme (*Cargo Service Provider*), pra si ofrues i shërbimeve për pranim dhe përcjellje të mallrave. Certifikata për mallra të rrezikshme si ofrues i shërbimit të trajtimit të mallrave të rrezikshme është lëshuar më datë 8 tetor 2021.

Më datë 26 tetor 2021, Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve kanë kryer auditimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” (LKIA) me qëllim të aprovimit të vazhimit të certifikatës si ofrues i shërbimeve të trajnimit për mallra të rrezikshme. Pas përmbushjes në tërësi të kërkesave ligjore, më datë 09 nëntor 2021 organizatës LKIA i është vazhduar certifikata e ofruesit të shërbimeve të trajnimit për mallra të rrezikshme për transport përmes ajrit.

Më datë 20 dhjetor 2021, me ftesë të Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë (AACSH) dhe në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet AACK-së dhe AACSH-së, është realizuar në Tiranë auditimi i mjekut AME të certifikuar nga AACSH-ja, i cili ka aplikuar para organit certifikues për aprovimin e ndryshimit të lokacionit dhe pajisjeve ku planifikon të ushtrojë veprimtarinë e tij për ekzaminimet mjekësore dhe certifikimin aero-mjekësor të personelit të aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë.

iii. Raportimi i ndodhive në aviacion (OR)

Deri më datë 18 qershor 2021, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve (DSF) ka menaxhuar sistemin e raportimit të ndodhive në aviacion, që përfshin kontrollimin dhe korrigjimin e të dhënave, procesimin dhe kontrollin e raporteve të ndodhive, futjen dhe arkivimin e ndodhive në softuerin ECCAIRS, mbylljen e ndodhive dhe menaxhimin e bazës së të dhënave në ECCAIRS, nxjerrjen e të dhënave nga baza e të dhënave për nevoja të ndryshme dhe paraqitjen e tyre në formë grafike, si dhe përgatitjen e listave përmbledhëse të ndodhive të raportuara. Pas kësaj date menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion ka kaluar nga Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve në Departamentin për Siguri dhe Cilësi (DSC).

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka ndihmuar Departamentin për Siguri dhe Cilësi në lidhje me menaxhimin e sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion. DSC-së i janë ofruar modelet e grafikëve të përdorur në listat përmbledhëse të ndodhive të raportuara të përgatitura nga DSF-ja dhe dokumentet e përgatitura për publikim në platformën digjitale Nextcloud, si dhe janë ofruar këshilla për trajtimin e raporteve për mallrat e rrezikshme dhe artikujt e ndaluar të zbuluar nga Sigurimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Gjatë vitit 2021, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka pranuar raportime për gjithsejtë dyzet e shtate (47) ndodhi në aviacionin civil. Nga këto ndodhi tashmë janë mbyllur tetëmbëdhjete (18), ndërsa të tjerat janë ende duke u hetuar.

Tetë (8) prej ndodhive të raportuara janë koduar në nënkategorinë e ndodhive të sulmeve me laser. Ky numër konsiderohet të jetë relativisht i ulët në krahasim me vitet e mëparshme, gjë që mirëpritet pasi që shndritja e rrezeve laserike drejt mjeteve ajrore në fluturim paraqet pengesë të madhe për pilotët dhe mund t'i verbojë ata gjatë fazave kritike të fluturimit, siç janë ngritja dhe aterrimi. Këto ndodhi i janë përcjellë institucioneve të sigurisë (Policisë) për hetime të mëtejshme.

iv. Transporti i mallrave të rrezikshme përmes ajrit

Në bazë të Neneve 57 dhe 59 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe Nenit 7 të Rregullores nr. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2021 janë lëshuar gjithsej njëqind e pesëdhjetë e tri (153) leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit, kompanive ajrore që operojnë në ANP “Adem Jashari”, të cilat paraprakisht janë të licencuara dhe posedojnë leje për import të armëve dhe municionit, të lëshuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), respektivisht materialeve radioaktive të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB).

Këto leje për transport të mallrave të rrezikshme përmes ajrit në Republikën e Kosovës u janë lëshuar tri kompanive ajrore, si në vijim:

- Nëntëdhjetë e gjashtë (96) leje kompanisë ajrore “Turkish Airlines”;
- Dyzet e një (41) leje kompanisë ajrore “Pegasus Hava Tasimaciligi”; dhe
- Dymbëdhjetë (12) leje kompanisë ajrore “Austrian Airlines”.


v. Mbikëqyrja e aviacionit të përgjithshëm

Gjatë vitit 2021 ka pasur një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve të aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të Republikës së Kosovës, ku përfshihen fluturimet sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR) me aeroplanë dhe helikopterë, pastaj operime me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dron) dhe operime me balonë me ajër të nxehtë, të cilat sipas bazës ligjore dhe procedurave përkatëse, kanë kaluar nëpër

procesin e miratimit nga AAC-ja në koordinim me Policinë e Republikës së Kosovës si dhe njësitin ajror (J3-Air) të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR).

Fluturimet sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR)

Gjatë vitit 2021 Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka lëshuar gjithsejtë pesëdhjetë (50) aprovime për fluturim sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR). Të gjitha këto aprovime janë lëshuar në koordinim të ngushtë me njësitin ajror (J3-Air) të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR).



Fluturimet diplomatike

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2021 ka proceduar kërkesat e dërguara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës tek njësi ajror (J3-Air) i Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR). Janë proceduar gjithsej nëntëdhjetë e një (91) kërkesa për aprovimin e fluturimeve diplomatike dhe të gjitha këto kërkesa janë aprovuar dhe proceduar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës.

Aktivitetet me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dron)

Sipas Rregullores (AAC) nr. 01/2021 për Sistemet e mjeteve ajrore pa pilot, të gjithë operatorët e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot apo siç njihen ndryshe me emërtimin “dron” janë të obliguar të regjistrojnë dronët e tyre në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës varësisht peshës së tyre.

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2021 ka regjistruar tridhjetë e dy (32) aplikues të rinjë për operime me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (SAP). Numri total i

operatorëve të dronëve të regjistruar në Republikën e Kosovës për vitet 2017-2021 ka arritur në njëqind e nëntëdhjetë e nëntë (199).

Po ashtu, janë aprovuar edhe njëzë e tri (23) operime të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot të regjistruara në vende të tjera. Aprovimi i operatorëve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot, është bërë në koordinim të ngushtë me Policinë e Republikës së Kosovës si dhe njësitin ajror (J3-Air) të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR).

Në vazhden e aktiviteteve rregullatore të parapara me legjislacionin në fuqi Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka organizuar testin e njohurive për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (dronëve) të Kategorisë 3. Këtij testi i është nënshtruar një (1) kandidat, i cili e ka kaluar me sukses këtë test. Me këtë rast kandidati i është ndarë certifikata për këtë kategori të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot, duke i uruar suksese dhe operime të sigurta në të ardhmen.

Për më tepër, më datë 12 qershor 2021, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka organizuar testimin praktik për licencë të paragjajdit dhe gradime të instruktorit dhe pilotëve tandem. Pjesëmarrës në testimin praktik ishin gjithsejtë katërbëdhjetë (14) kandidatë. Njëmbëdhjetë (11) kandidatë e kanë kaluar me sukses testin praktik për pilot të paragjajdit, dy (2) kandidatë e kanë kaluar me sukses testin praktik për gradim të instruktorit, si dhe një (1) kandidat e ka kaluar me sukses testin praktik për gradim të pilotit tandem.

Gjobat administrative

Në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 01/2017 për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (SAP), gjatë vitit 2021, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka nxjerrë shtatëmbëdhjetë (17) vendime për shqiptimin e gjobave për shkeljet në lidhje me operimet e paautorizuara me SAP (dronë). Po ashtu, janë lëshuar edhe faturat përkatëse dhe pas kryerjes së pagesave nga palët e gjobitura, është udhëzuar Policia e Kosovës për lirimin e dronëve të konfiskuar.

vi. Mjekësia e aviacionit

Gjatë vitit 2021 janë lëshuar gjithsejtë tridhjet e një (31) certifikata mjekësore për kontrollorët e trafikut ajror të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA).

Më datë 11 janar 2021, pas shqyrtimit të kërkesës për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës së AME-së, është konstatuar se kjo kërkesë i plotëson kriteret ligjore për vazhdimin e certifikatës së AME-së, dhe rrjedhimisht Dr. Luan Përçukut, i është aprovuar vazhdimi i certifikatës së lartpërmendur edhe për tre (3) vite të tjera, siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Më datë 25 mars 2021, me Vendimin Ekzekutiv nr. 04/ZDP/VE/2021 është vazhduar për një periudhë kohore prej 6 (gjashtë) muajsh autorizimi i përkohshëm i Qendrës

Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, në cilësinë e Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC).

Më datë 13 prill 2021, me ftesë të udhëheqëses së Divizionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, Vlerësuesi i Autorizuar Mjekësor (AMA - Authorised Medical Assessor) i Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve ka marrë pjesë si anëtar i nëngrupit punues për hartimin e Udhëzuesit të përkohshëm për parandalimin dhe frenimin e COVID-19 në fushën e aviacionit civil, në cilësinë e përfaqësuesit të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në këtë nëngrup.

Më datë 18 qershor 2021, Vlerësuesi i Autorizuar Mjekësor (AMA) i Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve së bashku me Drejtorin e Departamentit dhe Drejtorin e Përgjithshëm, me kërkesë të Federatës Aeronautike dhe Organizatës trajnuese, kanë zhvilluar një takim për trajtimin e kërkesës së Federatës për rregullimin e fushës së certifikimit aero-mjekësor të pilotëve të paraglajdit. Si rezultat i këtij takimi, më datë 30 korrik 2021, ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ (AAC) nr. 01/2021 për përcaktimin e certifikatës mjekësore të përcaktuar në Rregulloren (AAC) nr. 06/2020 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të paraglajdëve dhe deltaplanëve, përmes të cilit vërtetimi i aftësisë psiko-fizike të drejtuesve të paraglajdit kalon nga fusha e përgjegjësisë së sektorit të Aero Mjekësisë të DSF-së, në përgjegjësinë individuale të çdo anëtarit të Federatës Aeronautike që merret me aktivitete sportive-rekreative me paraglajd.

Me Vendimin Ekzekutiv të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 09/ZDP/VE/2021, të datës 07 tetor 2021, si rezultat i Raportit të Auditimit të Qendrës të kryer më 22 shtator 2021, është vazhduar autorizimi i përkohshëm i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës (QKMP) në Gjakovë, në cilësinë e Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) edhe për 6 (gjashhtë) muaj, përkatësisht deri më datë 07 prill 2022.

vii. Mjetet ajrore të ndaluara në Kosovë

Bazuar në legjislacionin Evropian, të transponuar në vendin tonë konform marrëveshjes për HPEA, ekzistojnë kompani ajrore të cilat janë të ndaluara të operojnë në hapësirën ajrore evropiane, duke përfshirë edhe hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, pasi që këto kompani ajrore janë të pasigurta dhe/ose u mungon mbikëqyrja e mjaftueshme nga autoritetet e tyre përkatëse të licencimit. Lista e kompanive ajrore të ndaluara hartohet nga Komisioni Evropian në konsultim të ngushtë me autoritetet e sigurisë së aviacionit të të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tyre.



Sipas Nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, mjeteve ajrore të kompanive ajrore të cilave u është ndaluar nga Bashkimi Evropian (BE) të operojnë në hapësirën ajrore të shteteve anëtare të BE-së, nuk u lejohej të fluturojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Për më tepër, lista e përditësuar e BE-së e kompanive ajrore të ndaluara është e postuar në faqen zyrtare të internetit të AAC-së.

Gjatë vitit 2021 nuk është realizuar asnjë fluturim i ndonjë kompanie nga kjo listë e BE-së në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

viii. Mjetet ajrore civile të regjistruara dhe ato të larguara nga regjistri i mjeteve ajrore civile

Në vitin 2021, AAC-ja nuk ka regjistruar apo larguar nga regjistri i mjeteve ajrore civile asnjë mjet ajror.

ix. Licencat, certifikatat dhe lejet e aprovuara, duke përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre

Licencë/certifikatë/leje	Referenca në aktet ligjore	Numri
Leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit	Neni 57 i LAC dhe Rregullore 04/2020	153
Leje për operime të aviacionit të përgjithshëm	LAC, Neni 2 dhe 75	50
Leje për regjistrimin e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot	Rregullore 01/2021	32
Leje për operim të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot me regjistrim të huaj	Rregullore 01/2021	23
Gjopa për operim të pa-autorizuar të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot	Rregullore 01/2017	17
Licenca për pilot të paraglajdit	Rregullore 06/2020	14
Licenca për pilot të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot	Rregullore 01/2021	1
Certifikatë mjekësore, klasa 3	LAC, Neni 37	31
Certifikatë mjekësore, klasa 2	LAC, Neni 37	-
Certifikatë mjekësore, klasa 1	LAC, Neni 37	-

b) Shërbimet e navigacionit ajror

i. Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA)

Më 1 janar 2016, në bazë të Ligjit nr. 04/L-250, është themeluar Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si entitet pasardhës i Kontrollit Ajror - ANP "Adem Jashari" sh.a.

Më 19 gusht 2016, AAC-ja e ka certifikuar ASHNA-n për një periudhë 5 vjeçare për ofrimin e këtyre shërbimeve: shërbimet e trafikut ajror (KTA), shërbimet e komunikimit, navigimit dhe survejimit (KNS), shërbimet e informatave aeronautike (SHIA) dhe shërbimet meteorologjike (MET). Certifikata është lëshuar në bazë të nenit 78 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe kriterëve të sigurisë, qëndrueshmërisë ekonomike dhe sigurimit që dalin nga Rregulloret nr. 9/2009 dhe nr. 7/2012, që

transponojnë në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës Rregulloren (KE) nr. 550/2004 dhe Rregulloren (KE) nr. 1035/2011 përkatësisht.

Pas përfundimit të periudhës 5 vjeçare, ASHNA ka aplikuar formalisht për ripërtëritje të certifikatës më 09.07.2021. Ky proces është verifikuar gjatë auditimeve të vazhdueshme. Nga ajo kohë, Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror (DSHNA) ka përcjellur të gjitha hapat që parashihen në procesin e certifikimit, të dokumentuar në AACK/SHNA/PC 04.

Po ashtu, Departamenti i SHNA-së ka lëshuar rekomandimin me të cilin konfirmon se ASHNA përmbush të gjitha kërkesat e përbashkëta të përshkruara në Rregulloren nr. 09/2020, që transponon Rregulloren nr. 2017/373 të BE-së, dhe të cilat janë kusht për certifikim si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, si dhe kërkesat e përshkruara në Rregulloren nr. 01/2018 mbi kërkesat për ofruesit e shërbimeve, në lidhje me trajnimin dhe vlerësimin e kompetencës për personelin e elektronikës të sigurisë të trafikut ajror (ATSEP).

SHNA-ja ka verifikuar të gjitha kërkesat përveç atyre që kanë të bëjnë me stabilitetin financiar (që i përketin fushëveprimit të Departamentit BNRREA) dhe me sigurimin (që i përketin fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme). Kërkesën për marrje të rekomandimeve nga këto departamente SHNA-ja e ka dërguar me 12 korrik dhe nga ato ka pranuar rekomandime pozitive nga fushëveprimet respektive.

Certifikata është dorëzuar nga Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm tek ASHNA, me ç'rast është vazhduar certifikimi i ASHNA-s. Certifikata nuk ka afat të caktuar por është e vlefshme përderisa ASHNA, si ofrues i shërbimeve, i plotëson kërkesat e legjislacionit në fuqi.

ASHNA i ka 27 kontrollorë aktiv të trafikut ajror, të cilët aktualisht ofrojnë shërbimet e kontrollit të trafikut ajror në Kosovë. Të gjithë këta kontrollorë janë të licencuar nga AAC-ja në bazë të Rregullores nr. 19/2017 të AAC-së.

ii. Mbikëqyrja e vazhdueshme e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) është certifikuar si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror për herë të parë më 19 gusht 2016 dhe është ricertifikuar me 19 gusht 2021. Departamenti i SHNA-së është përgjegjës për të mbikëqyrur mirëmbajtjen dhe respektimin e kushteve të certifikatës nga ana e ASHNA-s, përmes auditimeve të rregullta, vizitave dhe inspektimeve ad-hoc.

Gjatë vitit 2021, AAC-ja ka arritur t'i realizojë dy auditime sipas planifikimeve vjetore për audite, dy audite ad-hoc dhe një inspektim, duke verifikuar njëherit përmbushjen e kërkesave rregullative. Audit i paraparë në tremujorin e fundit të vitit 2021, është shtyer për vitin e ardhshëm duke pasur parasysh që qëllimi i tij ka qenë Aneksi 10 i

ICAO-s, me theks në Pajisjet e Radio Navigimit, pasi që në kuadër të projektit të zgjatjes së pistës, në muajin nëntor, janë aprovuar për operim ILS/DME dhe DVOR/DME.

Auditimet

- Nga 15-19 mars 2021 në ASHNA është realizuar audit i parë për vitin 2021. Qëllimi i auditit ka qenë verifikimi i përmbushjes së kërkesave të Rregullores nr. 09/2020 mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, përkatësisht Aneksit III - Kërkesat e Përbashkëta për Ofruesit e Shërbimeve (PJESA-ATM/ANS.OR), Nën-Pjesa A - Kërkesat e Përgjithshme (ATM/ANS.OR.A), Nën-Pjesa B - Menaxhimi (ATM/ANS.OR.B) dhe Nën-Pjesa D - Kërkesat Specifike Organizative për Ofruesit e ANS dhe ATFM dhe Menaxheri i Rrjetit (ATM/ANS.OR.D) dhe Aneksit IV - Kërkesat specifike për Ofruesit e Shërbimeve të Trafikut Ajror (PART-ATS) respektivisht Seksionin 3 - Kërkesat specifike për faktorin njeri për Ofruesit e Shërbimeve të Trafikut Ajror.

Gjatë kësaj periudhe audituese, ekipi i auditorëve të SHNA-së, ka identifikuar gjithsej 13 observime.

Siç kërkohet edhe me procedurë, nga ASHNA do të kërkohet të përgatisë planin me hapat korrektues i cili duhet t'i adresojë gjetjet dhe observimet e identifikuara.

Po ashtu, SHNA në vazhdimësi ka bërë përcjelljen e gjetjeve të cilat kanë mbetur të hapura nga auditimet e kaluara.

- Audit i dytë është realizuar nga 28 qershor - 2 korrik 2021. Qëllimi i auditit ka qenë verifikimi i përmbushjes së kërkesave të Rregullores së AAC-së nr. 09/2020 mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, përkatësisht Aneksit III mbi kërkesat e organizatës ATM/ANS, Aneksit V për meteorologji, Aneksit VI që ka të bëjë me pjesën e shërbimeve të informatave aeronautike, Aneksit VIII mbi pjesën e komunikimit, navigimit dhe survejimit dhe të Rregullores nr. 03/2011 mbi kalibrimin e instalimeve aeronautike nga ajri. Vlenë të theksohet që ky audit kishte të bënte me çështjet e ngritura në lidhje me fillimin e procesit për zgjatje të certifikatës për shërbimet të cilat ASHNA i ofron.

Siç kërkohet edhe me procedurë, DSHNA e ka dorëzuar raportin e auditimit më 23.07.2021. Ky raport përmban 3 gjetje dhe 3 observime. ASHNA ka përgatitur planin me hapat korrektues i cili i adreson gjetjet dhe observimet e identifikuara dhe të cilin e ka dorëzuar më 05.08.2021.

Po ashtu, SHNA në vazhdimësi ka bërë përcjelljen e gjetjeve të cilat kanë mbetur të hapura nga auditimet e kaluara.

- Më 29.07.2021, është realizuar auditimi ad-hoc në ASHNA, i cili ka pasur për qëllim verifikimin e pikës ATS.OR.315 - Lodhja dhe ATS.OR.320 - Sistemi(et) e orarit të kontrollorëve të trafikut ajror, të Rregullores nr. 09/2020.

Gjatë këtij auditimi janë ngritur dy observime, të cilat janë dorëzuar në ASHNA me rastin e dorëzimit të raportit të auditimit më 03.08.2021.

Më 11.08.2021, SHNA e ka pranuar përgjigjen në këtë raport për adresim të observimeve të ngritura.

- Më 09.09.2021, Departamenti i SHNA-së ka realizuar auditimin në lidhje me ndryshimin CH/2018/08 "Zgjatja e pistës". Në lidhje me këtë audit, SHNA ka dorëzuar raportin e auditit tek ASHNA më 15.09.2021. Ky audit nuk ka evidentuar ndonjë gjetje apo observime, mirëpo paraqet një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes aktuale të realizimit të ndryshimit.

Inspektimet

- Më 04 shkurt 2021, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm është realizuar një inspektim i paparalajmëruar në ASHNA për verifikimin e kërkesës mbi kapacitetet teknike dhe operacionale (Rregullorja 09/2021 ATM/ANS.OR.B001). Inspektorëve të AAC-së nuk i është lejuar qasja në objekt për verifikimin e stafit minimal në operime. Si rrjedhojë është ngritur gjetje e nivelit 1 (AI 01/01-21) për shkelje të rëndë të kërkesës që buron nga Rregullorja 09/2020, pika ATM/ANS.OR.A.050 që obligon ofruesit e shërbimeve të navigacionit ajror të ofrojnë qasje dhe lehtësime gjatë realizimit të inspektimeve dhe auditeve. ASHNA e ka refuzuar gjetjen, edhe pas shkëmbimit të letrave që kanë sqaruar qëllimin e inspektimit dhe bazën ligjore. Gjetja është trajtuar më pas nga Këshilli i Sigurisë së AAC-së. Pas realizimit të auditit të planifikuar në mars, me kërkesë të DP-së, gjetja është riklasifikuar si gjetje e nivelit 2. AAC-ja ka pranuar planin e hapave korrektues në lidhje me këtë gjetje. Kjo gjetje është mbyllur nga Drejtori i Përgjithshëm.

iii. Auditimi vlerësues nga EASA

Më 26 tetor 2017, AAC-ja ka pranuar raportin final të auditimit vlerësues të EASA-s, të mbajtur në periudhën 21-25 nëntor 2016 në AAC. Edhe pse ky raport është pranuar me pothuajse një vit vonesë, Departamenti i SHNA-së ka vazhduar adresimin e gjetjeve të identifikuara gjatë këtij auditimi në përputhje me planin e përpiluar të hapave korrektues. Më 20 dhjetor 2017 plani i hapave korrektues i është dorëzuar ekipit auditues të EASA-s, ndërsa plani u pranua zyrtarisht nga EASA më 23 shkurt 2018.

Plani fillestar (Versioni 8.0) i dorëzuar tek EASA ka përmbajtur 49 hapa korrektues të cilët adresojnë 23 gjetjet e ngritura nga ekipi auditues. Të gjithë 49 hapat e propozuar nga AAC-ja kanë qenë të pranueshëm nga EASA, por është kërkuar edhe shtimi/propozimi i disa hapave të tjerë duke rezultuar me gjithsej 58 hapa në planin e fundit (Versioni 10.0), i cili është pranuar zyrtarisht më 23 shkurt 2018. Në ndërkohë, pas komunikimeve me EASA-n është kaluar edhe në Versionin 11 dhe 12 të planit korrektues me 57 veprime korrektuese.

Më 17 maj 2019, Departamenti i SHNA-së ka dorëzuar Versionin 13.0 të Planit Korrigjues të Veprimeve (Corrective Action Plan - CAP). Më 18 korrik 2019, DSHNA ka pranuar njoftimin nga z. Klus (udhëheqës i ekipit vlerësues të EASA-s) se dëshmitë e dorëzuara në maj të këtij viti, si dhe Versionin 13.0 i Planit Korrigjues të Veprimeve

janë të pranueshme për ta. Momentalisht, nga 57 hapa sa janë gjithsej, 55 janë të mbyllur.

Gjatë vitit 2021 janë përmbushur edhe 2 hapat e mbetur me Versionin 14.0 të Planit Korrigjues të Veprimeve dhe i njëjti do të dorëzohet tek EASA, duke ndjekur procedurën e mëhershme të shkëmbimit të dokumenteve/evidencave.

iv. Mbikëqyrja e ASHNA-s si Organizatë Trajnuese (OT)

ASHNA është certifikuar më 19 dhjetor 2017 nga AAC-ja për një periudhë 3 vjeçare për të ofruar shërbimet që i takojnë një Organizatë Trajnuese për Kontrollorët e Trafikut Ajror (KTA) siç janë: trajnimet për njësi për KTA dhe trajnimet e vazhdueshme për KTA.

Procesi i certifikimit ka filluar në vitin 2016 kur ASHNA ka aplikuar për certifikim. Me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 19/2017 të AAC-së, e cila e zëvendësoi Rregulloren nr. 05/2012, në bazë të së cilës në atë kohë ASHNA ishte certifikuar si OT, AAC ishte obliguar që të bëjë zëvendësimin e certifikatës së atëhershme në formatin e ri të përcaktuar në Rregulloren nr. 19/2017. Në përputhje me këtë kërkesë, më 04.01.2019 AAC-ja ka zëvendësuar certifikatën e lëshuar në vitin 2017 me certifikatën CAAK/ANS/1-2019, sipas formatit të ri të paraparë me rregulloren e lartpërmendur.

Që nga koha e certifikimit, ASHNA OT është audituar disa herë përgjatë këtyre viteve nga Departamenti i SHNA-së, brenda kornizave të procesit të mbikëqyrjes së vazhdueshme, për të garantuar dhe verifikuar se OT vazhdon të plotësojë të gjitha kërkesat e rregullores.

Lëshimi i Certifikatës dëshmon për sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, por që kërkon angazhim të vazhdueshëm nga ana e ASHNA-s për respektimin e kushteve të certifikimit dhe për ngritjen edhe më tej të cilësisë së shërbimeve.

Gjatë vitit 2021, specifikisht nuk ka pasur auditim mbi kërkesat e Rregullores 19/2017.

v. Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s

Gjatë vitit 2021, AAC-ja ka pranuar nga ASHNA njoftimin për dy ndryshime të reja.

Gjatë tremujorit të parë të vitit Departamenti i SHNA-së ka marrë pjesë në takimet shumëpalëshe të organizuara nga AAC-ja për implementimin e Global Reporting Format (GRF).

Gjatë periudhës prill-qershor ASHNA ka njoftuar se për shkak të përfundimit të mandatit të drejtorit të kaluar, me vendim të Qeverisë, si ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm i ASHNA-s është emëruar z. Valmir Hylenaj nga data 28.06.2021. Më 02.07.2021, DSHNA ka përgatitur një draft letër informuese me rastin e marrjes së

pozitës së zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHNA-s të z. Hylenajt. Draft letra është dërguar tek DP i AAC-së.

1. Ndryshimi “CH-2021-01 LAKU operations”

Më 02 shtator, DSHNA ka pranuar nga ASHNA, njoftimin “PSF21-002 LAKU Kukës Approach”.

Ndryshim i koduar sipas AAC-së “CH-2021-01 LAKU operations” ndërlidhet me fillimin e operimeve komerciale në Aeroportin e Kukësit në Republikën e Shqipërisë. Implementimi i trajektores IFR të procedurës LAKU RNP APPROACH RWY 19, prekë edhe hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë afekton hapësirën ajrore të Kosovës në atë pjesë.

Dokumentet e dorëzuara për këtë ndryshim janë:

- PSF21-002-CHN (Njoftimi për ndryshim)
- Koncept Dokumenti (LAKU Kukës Approach)
- PSF21-002-SAA (Raporti i vlerësimit të Sigurisë),

Pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara, ky ndryshim është klasifikuar si madhor. Kodi i ndryshimit i vendosur nga SHNA është CH/2021/01 dhe për të njëjtin janë kërkuar të dorëzohen edhe dokumentet:

- Propozimi për ndryshim të hapësirës ajrore (Airspace Change Proposal); dhe
- Evidencat për implementimin e masave mitiguese për eliminim të rreziqeve.

Pas pranimit të dokumentacionit të lartëcekur, SHNA do ta pranojë ose jo ndryshimin, sipas procedurës në fuqi.

2. Ndryshimi “CH-2021-02 New head of TO”

Më 01.10.2021, është njoftuar ndryshimi përmes formës (AACK/SHNA/NSA-FRM 02) në lidhje me ndryshimin e planifikuar “Emërimi i zëvendësuesit të Menaxherit të DTZH”, bashkë me dokumentacionin përcjellës. Pas vlerësimit të dokumentacionit, dhe klasifikimit të ndryshimit sipas procedurave relevante, rezulton se ndonëse ky ndryshim nuk klasifikohet si madhor për nga efekti në siguri, i njëjti kërkon aprovim formal nga AAC-ja, në përputhje me dispozitat ATCO.AR.E.010 dhe ATCO.OR.B.015 të Rregullores së AAC-së nr. 19/2017.

Rrjedhimisht, AAC-ja, ka rishikuar dokumentacionin e dorëzuar për të vlerësuar nëse ndryshimi i njoftuar afekton përmbushjen e vazhdueshme nga ASHNA të kërkesave të Shtojcës III (PART ATCO.OR) të Rregullores 19/2017. Nga rishikimi ka rezultuar se ky ndryshim nuk e cenon përmbushjen e kërkesave të lartpërmendura dhe si rrjedhojë është pranuar nga AAC-ja. Në përputhje me dispozitën ATCO.AR.E.010, ky ndryshim u aprovua më 12 tetor 2021.

Po ashtu, SHNA ka bërë rishikimin e ndryshimit Ch-2018-08 “zgjatja dhe ngritja e kapaciteteve të pistës” dhe ka bërë miratimin e tri ndryshimeve që janë pjesë e këtijë ndryshimi.

Kështu, më 03 nëntor 2021, Departamenti i SHNA-së ka miratuar pjesërisht këtë ndryshim, pasi që ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA, përfshirë edhe dokumentin “Airspace change” dhe “flight check”, dhe ka vërejtur se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar dhe konform rregulloreve në fuqi për:

➤ **Sistemet e navigimit:**

1. Instalimi i sistemit të ri ILS Cat IIIb për Pistën 17.
2. Instalimi i sistemit të ri ILS Cat I për Pistën 35.
3. Rilokimi i DVOR-it në lokacionin e ri.

dhe

➤ **Procedurat e fluturimit:**

Procedurat e reja konvencionale SID, STAR dhe APP si në vijim:

- SID CONV: UDVAR 1E&1F and SARAX 1E&1F
- STAR CONV: REDVA 1F, ARBER 1F & XAXAN 1F
- STAR CONV: REDVA 1B & 1C ARBER 1C&XAXAN 1C
- VOR DME APP 17&35
- ILS Z APP 17
- SID CONV: UDVAR 1B & 1C, SARAX 1B & 1C

Si rrjedhojë, Departamenti i SHNA-së e ka njoftuar ASHNA-në se ka pranuar pjesshëm ndryshimin “zgjatja dhe ngritja e kapaciteteve të pistës”, konkretisht miratimin për Sistemet e Navigimit siç janë të përshkruara më lartë, dhe Procedurat e reja konvencionale SID, STAR dhe APP, përjashtimisht procedurat e fluturimit që lidhin Kosovën me Malin e Zi (MEDUX Pista 17/35 dhe DOLEV 17/35) si dhe procedurat (SID CONV: KUKAD), pasi që janë marrë të gjitha masat për të evituar ndonjë problem në sigurinë e operimeve dhe se përmbushen të gjitha kërkesat që dalin nga rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

Më tej, më 26 nëntor 2021, Departamenti i SHNA-së ka miratuar ndryshimin për procedurat e reja konvencionale SID KUKAD, pasi që ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA, përfshirë dokumentin “Airspace change” dhe “flight check”, dhe ka vërejtur se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar dhe konform rregulloreve në fuqi për Procedurat e Fluturimit si në vijim:

➤ **Procedurat e fluturimit:**

Procedurat e reja konvencionale SID KUKAD si në vijim:

- SID_CONV_RWY17_KUKAD 1B, (Highe Performance Aircraft Departure)
- SID_CONV_RWY17_KUKAD 1C, (Low Performance Aircraft Departure)
- SID_CONV_RWY35_KUKAD 1E, (Highe Performance Aircraft Departure)
- SID_CONV_RWY35_KUKAD 1F, (Low Performance Aircraft Departure)

Si rrjedhojë, Departamenti i SHNA-së e ka njoftuar ASHNA-në se ka pranuar ndryshimin “procedurat e reja konvencionale SID KUKAD” si pjesë e projektit “zgjatja dhe ngritja e kapaciteteve të pistës”, pasi që janë marrë të gjitha masat për të evituar ndonjë problem në sigurinë e operimeve dhe se përmbushen të gjitha kërkesat që dalin nga rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

Më 24 dhjetor 2021, Departamenti i SHNA-së ka miratuar ndryshimin “Sistemi i Parashikimit për METEO”, pasi që ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA, dhe ka vërejtur se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar dhe konform rregulloreve në fuqi.

Si rrjedhojë, Departamenti i SHNA-së e ka njoftuar ASHNA-në se ka pranuar ndryshimin “Sistemi i Parashikimit për Meteo” si pjesë e projektit “zgjatja dhe ngritja e kapaciteteve të pistës”, pasi që janë marrë të gjitha masat për të evituar ndonjë problem në sigurinë e operimeve dhe se përmbushen të gjitha kërkesat që dalin nga rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

vi. Lëshimi i licencave për kontrollorët e trafikut ajror dhe vlerësimi i gradimeve

AAC-ja është përgjegjëse për lëshim dhe ripërtëritjen e licencave të kontrollorëve të trafikut ajror, të cilët ofrojnë shërbimet e kontrollit ajror në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror në sigurinë e fluturimeve, kontrollorët duhet të përmbushin një varg të kërkesave dhe kushteve për të mirëmbajtur licencat dhe miratimet e tyre, të cilat dalin nga Rregullorja nr. 19/2017 e AAC-së që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

Kërkesat kryesisht ndërlidhen me nivelin e kompetencës profesionale, që përfshijnë ndjekjen e trajnimeve profesionale përditësuese dhe ushtrimin e detyrave të kontrollorit të trafikut ajror për një numër të caktuar të orëve brenda vitit. Kontrollorët gjithashtu, në baza vjetore, i nënshtrohen vlerësimit profesional për të verifikuar nivelin e aftësive.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe zotërimit të gjuhës angleze, pasi që komunikimi në aviacionin ndërkombëtar bëhet në këtë gjuhë. Niveli i zotërimit të gjuhës angleze vlerësohet në mënyrë periodike dhe merret parasysh gjatë lëshimit apo ripërtëritjes së licencës. Kontrollorët gjithashtu duhet të kenë shëndet të mirë, në përputhje me kërkesat ligjore, dhe kjo verifikohet në mënyrë të rregullt nga AAC-ja si pjesë e procesit të licencimit.

Për shkak të përballjes me pandeminë COVID-19, procesi i rregullt i rivalidimit të miratimeve të njesisë nuk ka mundur të zhvillohet si në vitet paraprake, pasi që situata ka pamundësuar ndjekjen e trajnimeve rifreskuese e që është kërkesë e Rregullores nr. 19/2017.

Për ta adresuar këtë çështje dhe për të vazhduar zgjatjen e afatit të miratimeve të njësive për KTA, fillimisht ASHNA ka parashtruar kërkesën për zgjatje të afatit të miratimeve, ndërsa SHNA, pas shqyrtimit të bazës ligjore të Rregullores nr. 05/2020 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit, përkatësisht nenit 71 të saj, Rregullores nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, pranimi dhe analizimi të vlerësimit të sigursisë, si dhe dokumentacionit përcjellës në lidhje me vlerësimet e kompetencës së KTA-ve, ka dhënë rekomandimin për zgjatje të afatit të validitetit të miratimeve të njësive për një periudhë 4 muajore nga data e skadimit, me mundësi vazhdimi edhe për 4 muaj të tjerë. Si rrjedhojë, më 31.12.2020 AAC-ja ka lëshuar shkresën me të cilën lejon zgjatjen e privilegjeve të miratimeve të njësive sipas rekomandimit nga DSHNA deri më 30.04.2021. Gjatë muajit prill, AAC-ja ka pranuar edhe një kërkesë tjetër nga ASHNA që validiteti i miratimeve të njësive të bëhet edhe për 4 muaj të tjerë. Kërkesa është aprovuar dhe afati i validitetit të miratimeve të njësive për 24 KTA është zgjatur deri në fund të muajit gusht 2021.

Pastaj, AAC-ja ka pranuar edhe një kërkesë tjetër nga ASHNA për zgjatje të validitetit të këtyre miratimeve të njësive, pasi që situata me COVID-19 pamundësonte realizimin e trajnimit rifreskues. Bashkangjitur në këtë kërkesë ASHNA ka dorëzuar edhe kontratën e vendosur me kompaninë e cila do t'i ofronte këto trajnime dhe se të njëjtat do të fillonin të realizoheshin më 20 shtator të këtij viti. Pas shqyrtimit të bazës rregullative dhe kushteve të paraqitura për fillim të trajnimeve, ky validitet i miratimeve të njësive është zgjatur për 24 KTA deri më 09.11.2021.

Po ashtu, më 09.11.2021, ASHNA ka dorëzuar dëshmitë se disa KTA kanë mundur të ndjekin trajnimin rifreskues dhe si rrjedhojë AAC-ja ka vazhduar validitetin e miratimeve të njësive për 23 KTA.

Po ashtu, më 13.09.2021, DSHNA ka pranuar një e-mailin nga ASHNA, përmes së cilit kërkohet shtyrja e afati të miratimeve të gjuhës (ELPAC) për Kontrollorët e Trafikut Ajror (KTA), si pasojë e shtyerjes së projekteve kapitale për shkak të situatës me pandeminë COVID-19.

Pas shqyrtimit të bazës ligjore të Rregullores nr. 05/2020 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit, përkatësisht nenit 71 të saj, Rregullores nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, AAC-ja ka zgjatur afatin e validitetit të miratimeve të gjuhës për 12 KTA deri më datën 25 shkurt 2022.

Detajet me licencat e ripërtërira dhe rivalidim të gradimeve, për vitin 2021, është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Licencimi i Kontrollorëve të Trafikut Ajror (KTA)	Numri i të licencuarve
---	------------------------

Ripërtëritja e licencave për KTA-të (miratimeve të njësishë)	24
Rivalidimi i miratimeve të gjuhës	12
Rivalidimi/ripërtëritja e gradimeve për instruktorë/asesorë	0
Licencimi i studentëve KTA	0
Licencimi i KTA-ve	3

vii. Publikimi i Informatave Aeronautike

Gjatë tremujorit të parë janë publikuar dy AIRAC Amandamente (AIRAC AMDT), të cilët përmbajnë informata të cilat është dashur të publikohen në dokumentin e Publikimit të Informatave Aeronautike (AIP), sipas afateve kohore të parapara.

AIRAC AMDT 01/2021 është bërë efektiv më 28.01.2021, ndërsa AIRAC AMDT 02/2021 është publikuar më 25.02.2021 dhe është bërë efektiv më 25.03.2021.

Më 12.02.2021 është kërkuar që të zëvendësohet NOTAM-i A0641/20 që të reflektohen masat e reja të Qeverisë sipas vendimit 01/63 të datës 11.02.2021. Si rrjedhojë është anuluar NOTAM-i A0641/20 dhe është lëshuar NOTAM-i A0034/21.

Më 19.03.2021 është kërkuar zgjatja e NOTAM-it A0636/20 për perzullimin e fluturimeve nga Mbretëria e Bashkuar (sipas vendimit 05/8715 të datës 23.12.2020 të Ministrit të Shëndetësisë), i cili ka qenë valid deri më 21 mars.

Më 02.02.2021 sipas Vendimit 03-VE-2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së është kërkuar lëshimi i NOTAM-it A0026/21 për lejin e operimeve me fluturake të llojit Boeing 737-8 MAX dhe Boeing 737-9 MAX në hapësirën ajrore të Kosovës.

Në periudhën prill-qershor është dhënë konfirmim për vazhdim të NOTAM-it A0034/21 dhe janë publikuar dy NOTAM si A0185/21 dhe A0237/21, të cilët reflektojnë vendimet e Qverisë së Kosovës në lidhje me situatën me COVID-19 në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, janë publikuar AIRAC AMDT 03/2021 dhe AIRAC AMDT 04/2021 dhe AIP SUP 01/2021.

Në periudhën korrik-shtator janë publikuar NOTAM-ët A0403/21, A0409/21, A0423/21 dhe A0437/21, të cilët reflektojnë vendimet e Qverisë së Kosovës në lidhje me situatën me COVID-19 në Republikën e Kosovës. Po ashtu, është publikuar AIP AIRAC AMDT 05/2021 më datë efektive 30 dhjetor 2021 dhe janë miratur për publikim AIP AIRAC AMDT 01/2022 dhe AIRAC AMDT 01/2022 me data efektive 27 janar 2022, respektivisht 28 janar 2022.

Në periudhën tetor-dhjetor janë publikuar NOTAM-ët A0646/21 dhe A0551/21 të cilët reflektojnë vendimet e Qverisë së Kosovës në lidhje me situatën me COVID-19 në Republikën e Kosovës.

viii. Raportimi i obligueshëm i ndodhive

Gjatë vitit 2021, ASHNA ka vazhduar traditën e saj të raportimit të ndodhive tek AAC-ja sipas Manualit të brendshëm të Menaxhimit të Sigurisë dhe në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 09/2017. Janë raportuar gjithsej 110 ndodhi në fushëveprimin e shërbimeve të navigacionit ajror. Për të gjitha ndodhitë për të cilat DSHNA ka dyshuar se mund të ndikojnë në siguri ka kërkuar hetim nga ana e ASHNA-s, ku të gjitha ndodhitë janë trajtuar me seriozitet nga të dyja palët. Shumica e ndodhive janë mbyllur.

AAC-ja vazhdon të inkurajojë të gjithë akterët të cilët përballen me ndodhi të tilla, që të raportojnë dhe së bashku ta mbajmë nivelin e lartë të sigurisë. Kjo arrihet duke mos lënë asnjë ndodhi të pa raportuar nga ASHNA dhe rrjedhimish të patrajtuar nga ana e AAC-së.

ix. Aktivitetet në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19

Që nga paraqitja e pandemisë COVID-19, DSHNA ka bashkëpunuar ngushtë me ASHNA-n për të koordinuar aktivitetet e publikimit të NOTAM-ve për të reflektuar vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me kufizimet dhe masat e ndërmarra për parandalimin dhe përhapjen e sëmundjes.

Përshkrimi i të gjitha rasteve kur janë lëshuar NOTAM-ë, mund të shihet tek pjesa e raportit “Publikimi i Informatave Aeronautike”.

Po ashtu, SHNA-ja ka pasur komunikim me IATA TEMATIC, në lidhje me publikimin e NOTAM-ve për situatën COVID-19 në Kosovë.

c) Aerodromet

Sipas Ligjit nr. 03/L-51 për Aviacionin Civil, AAC-ja është përgjegjëse për rregullimin dhe zhvillimin e politikave të aerodromeve dhe ofruesve të shërbimeve në tokë, duke verifikuar zbatimin e standardeve të aplikueshme të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe duke siguruar një ambient të sigurt të aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Varësisht nga natyra e operimeve dhe shkalla e shfrytëzimit, aerodromet civile kategorizohen në aerodrome të certifikuara, aerodrome të aprovuara dhe aerodrome të regjistruara. Në kuadër të AAC-së, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për certifikim, aprovim dhe regjistrim të aerodromeve në dispozicion për shfrytëzim civil në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe fushat ajrore dhe heliportet. Gjithashtu, me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave që rregullojnë qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në Republikën e Kosovës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për vlerësimin e sigurisë së ofruesve të shërbimeve në tokë në aerodromet e

Republikës së Kosovës, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve në tokë për furnizim të aeroplanëve me karburant.

Për t'u siguruar se aftësimi profesional dhe trajnimi i punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të aerodromit të cilët vetë japin shërbime në tokë, bëhet sipas standardeve dhe kriterëve të përcaktuara me legjislacionin përkatës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për vlerësimin dhe dhënien e rekomandimit për certifikim të organizatave të aftësimit profesional për fushën e aerodromeve.

Me qëllim të mirëmbajtjes së sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Kosovës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për caktimin dhe monitorimin e zonave mbrojtëse të aerodromeve. Ky departament koordinon bashkëpunimin mes operatorëve të aerodromeve, departamentit përgjegjës në ASHNA, subjekteve juridike/personave fizik, të cilët kanë në pronësi apo planifikojnë të ndërtojnë një objekt brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve apo ndonjë objekt të lartë kudo në territorin e Republikës së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse për lëshimin e lejeve të ndërtimit sipas Ligjit për ndërtim. Departamenti i aerodromeve duhet të sigurojë që të gjitha palët e përfshira i respektojnë procedurat e përshkruara në rregulloren mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe rregulloren për shënjimin e pengesave.

Për të verifikuar dhe siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit të aplikueshëm vendor dhe ndërkombëtar, Departamenti i Aerodromeve bën mbikëqyrje të vazhdueshme të sigurisë së aerodromeve, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe organizatave të aftësimeve profesionale përmes auditimeve, inspektimeve dhe monitorimit të aktiviteteve të tyre.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" fillimisht është certifikuar më 1 dhjetor 2008 nga AAC-ja si aeroport ndërkombëtar në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil, Rregulloren e AAC-së nr. 1/2008 për aerodromet dhe standardet dhe praktikën e rekomanduar të ICAO-s. Në vitin 2011 aeroporti është dhënë në koncesion dhe menaxhimi i tij ka kaluar në duart e operatorit privat, konzorciumit turko-francez "Limak - Aéroports de Lyon" (Limak Kosovo International Airport sh.a.). Më 8 nëntor 2013, bazuar në kërkesat ligjore, me rastin e transferimit të operimeve në terminalin e ri, AAC-ja ka amandamentuar certifikatën e operatorit "Limak Kosovo International Airport" sh.a. (LKIA). Më tej, pas hyrjes në fuqi të Rregullores nr. 17/2017 të AAC-së që përcakton dispozitat dhe procedurat administrative lidhur me aerodromet, që e ka zbatuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 139/2014 me të njëjtin emër, më 8 nëntor 2018, AAC-ja ka certifikuar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe operatorin e aerodromit "Limak Kosovo International Airport" sipas standardeve më të larta të sigurisë së aerodromeve dhe në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian. Përfundimisht, me finalizimin e projektit infrastrukturor të zgjatjes së pistës nga 2.500 në 3.040 metra, së bashku me ngritjen e kategorisë së operimit me sistemin preciz të aterimit, me 21.12.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ka lëshuar certifikatën e operimit për kodin referent të aerodromit 4E, bazuar në karakteristikat dhe

performancën e aeroplanëve më të mëdhenj që janë planifikuar të operojnë në ANP “Adem Jashari”.

Në bazë të Rregullores nr. 4/2011 të AAC-së për qasje në tregun e shërbimeve në tokë, e cila është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 5/2019, më 1 janar 2012 AAC-ja ka lëshuar aprovimin për kompaninë “ExFis” Sh.P.K. si furnizues i shërbimeve në tokë për kategorinë e shërbimeve të furnizimit me derivate dhe vajra, kurse më 1 qershor 2012, është aprovuar operatori LKIA për ofrim të shërbimeve në tokë në disa kategori në ANP “Adem Jashari”. Me kalimin e pragut prej 2 milionë udhëtarëve të shërbyer në ANP “Adem Jashari” janë përmbushur kushtet për angazhim të më shumë kompanive të interesuara.

i. Mbikëqyrja e vazhdueshme e sigurisë së aerodromeve

Një nga funksionet themelore të Departamentit të Aerodromeve, për garantimin e sigurisë së aerodromeve në Republikën e Kosovës, është zbatimi i sistemit efektiv të mbikëqyrjes. Mbikëqyrja efektive e sigurisë bëhet përmes vlerësimit dhe aprovimit të manualeve, programeve dhe procedurave të ndryshme të operatorit, miratimeve të vlerësimeve të sigurisë, dhe veçanërisht përmes kryerjes së inspektimeve formale (me apo pa njoftim paraprak të operatorit), bazuar në planin vjetor të mbikëqyrjes, apo duke iu përgjigjur situatës që mund të paraqesë nevojën për vigjilencë shtesë në siguri.

Sipas planit të aktiviteteve për monitorimin e rregullt dhe verifikimin e zbatimit të standardeve të aplikueshme për operatorin e ANP “Adem Jashari” dhe ofruesve të shërbimeve në tokë, inspektorët e Departamentit të Aerodromeve gjatë vitit 2021 kanë përmbushur plotësisht planin e mbikëqyrjes së sigurisë për këtë vit, duke realizuar një (1) auditim certifikues, nëntë (9) inspektime të planifikuara prej të cilëve një (1) tek furnizuesi i aprovuar i aeroplanëve me karburant, kompanisë “ExFis”, katër (4) inspektime “*ad-hoc*” që nuk janë planifikuar paraprakisht në planin e mbikëqyrjes por janë realizuar si përgjigje ndaj çështjeve të ndryshme të sigurisë, si dhe katër (4) inspektime tjera së bashku me inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve, për të verifikuar zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19 sipas Planit të veprimt të operatorit.



Pamje nga inspektimet e mbikëqyrjes së vazhdueshme të sigurisë së aerodromeve

ii. Projekti për zgjatjen e pistës dhe ngritjen e kategorisë së pistës për aterrimin preciz në ILS CAT-IIIB në ANP “Adem Jashari”

Sic kërkohet me Rregulloren nr. 17/2017 për aerodrome dhe në përputhje me materialin udhëzues TP 27 - “Procedurat për ndryshime të aerodromit”, në shkurt të vitit 2019, operatori LKIA ka dorëzuar kërkesën zyrtare për ndryshimin e propozuar të infrastrukturës në ANP “Adem Jashari”, i cili do të ndikojë në bazat e certifikimit dhe kushtet e certifikatës. Ky ndryshim vjen si rrjedhojë e zbatimit të projektit për zgjatjen e pistës dhe ngritjen e kategorisë së pistës për aterrimin preciz në ILS CAT-IIIB. Pas rishikimit dhe analizimit të aplikacionit dhe pas konsultimeve të vazhdueshme me operatorin, më 28.02.2019 është aprovuar kërkesa për ndryshim.

Në bashkëpunim të ngushtë me inspektorët e shërbimeve të navigacionit ajror të AAC-së, në vazhdimësi janë bërë rishikimet dhe aprovimet e vlerësimeve të ndryshme të sigurisë, duke filluar nga ato për punimet sipërfaqësore në rrugën e taksimit për daljen e shpejt nga pista, mandej për fillimin e punëve të dheut për pjesën e pistës prej “lokalizuesit” në drejtim të pragut të pistës 35, për zhvendosjen e pragut të pistës 35, fillimisht duke e shkurtuar pistën nga 2500 m në 2200 m, dhe pastaj duke e kthyer gjatësinë paraprake prej 2500 m, për zgjerimin e sipërfaqes së sigurisë në fundin e pistës 17 (RESA17), është bërë analizimi dhe aprovimi i punëve për përgatitjen e kanaleve për shtrirjen e rrjetit të furnizimit me energji elektrike të pajisjeve të navigimit, si dhe janë trajtuar edhe shumë vlerësime tjera aeronautike që lidhen me këtë projekt. Në koordinim të plotë mes palëve, LKIA-ASHNA-AAC, është bërë kontrollimi dhe aprovimi i të dhënave për publikimin e informatave aeronautike, ku përfshihen të dhënat esenciale për publikim, hartat aeronautike dhe procedurat e fluturimit.

Edhe pse ka pasur ndërprerje të përkohshme të punimeve ndërtimore, inspektorët e aerodromeve kanë qenë në kontakt të përhershëm me përgjegjësit për implementimin e këtij projekti përmes takimeve konsultative dhe vizitave të vazhdueshme në teren. Janë mbajtur takime të shumta mes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ASHNA-s, operatorit LKIA dhe AAC-së, ku janë shqyrtuar mundësitë e rifillimit të punimeve dhe definimit të planit dinamik për përfundimin e projektit.

Me vazhdimin e ekzekutimit të punimeve, ka vazhduar edhe monitorimi i punëve që kanë qenë duke u kryer. Inspektorët e aerodromeve kanë përcjellë punimet në baza të rregullta përmes inspektimeve në ANP "Adem Jashari", takimeve të vazhdueshme me operatorin LKIA, rishikimeve dhe aprovimeve të vlerësimeve të rrezikut, të punuara nga LKIA, dhe vlerësimeve të manualeve operacionale dhe hartave aeronautike.

Më 23.09.2021 nga LKIA është pranuar aplikacioni zyrtar për Certifikim të Aerodromit, përkatësisht për ndryshimin e certifikatës e cila do të përfshijë infrastrukturën e re dhe pajisjet përcjellëse.

Më 29.10.2021, Departamenti i Aerodromeve ka pranuar një raport të vlerësimit të rrezikut nga operatori LKIA, të koordinuar dhe përpiluar në bashkëpunim me ASHNA-n, lidhur me kërkesën për aprovim të operimeve në pistën me gjatësi 3040 m ILS CAT-I në ANP "Adem Jashari". Ky raport ka ardhë si rezultat i takimit të përbashkët në mes të përfaqësuesve të AAC-së, LKIA-s, ASHNA-s dhe MMPHI-së më 26.10.2021 në zyrat e AAC-së, dhe takimeve e konsultave tjera pasuese, ku janë elaboruar arsyeshmëritë e kërkesës dhe masat e ndërmarra për operimet ajrore të sigurta në pistën 3040 m ILS CAT-I, deri në përfundimin e procesit të certifikimit për ndryshimin e certifikatës së aerodromit për ANP "Adem Jashari". Sipas kërkesës së bërë nga operatori i aerodromit LKIA dhe ASHNA, përmes këtij raporti dhe dokumentacionit mbështetës, është prezantuar analiza dhe vlerësimi i rrezikshmërisë për shfrytëzimin e përkohshëm të pistës me gjatësinë 3040 m ILS CAT-I, kundrejt pistës me gjatësi ekzistuese, e shkurtuar në 2200 m, deri në përfundimin e procesit të certifikimit nga AAC-ja. Bazuar në kërkesat rregullatore, inspektorët e aerodromeve kanë vlerësuar raportin së bashku me dokumentacionin mbështetës, dhe pas inspektimeve në ANP "Adem Jashari" dhe takimeve me operatorin LKIA, është konkluduar se masat e ndërmarra, të prezantuara nga operatori, janë të pranueshme.

Më 21.12.2021, pas përfundimit të procesit të certifikimit dhe pas auditimit gjithëpërfshirës, Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ka lëshuar certifikatën e operimit të aerodromit për aterrim preciz ILS CAT III B dhe kod referent të aerodromit 4E, bazuar në karakteristikat dhe performancën e aeroplanëve më të mëdhenj që janë planifikuar të operojnë në ANP "Adem Jashari".



Pamje e pistës së ANP-së me ndriçimin CAT-III

iii. Certifikimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës pas ndryshimeve infrastrukturore

Me procesin e finalizimit të projektit të zgjatjes së pistës nga 2.500 në 3.040 metra bashkë me infrastrukturën përcjellëse, operatori i aerodromit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” ka dorëzuar më 23.09.2021 aplikacionin zyrtar për Certifikim të Aerodromit, përkatësisht ndryshimin e certifikatës ekzistuese e cila do të përfshijë infrastrukturën e re dhe pajisjet përcjellëse. Pas vlerësimit preliminar, më 24.09.2021 listat e përditësuara kontrolluese për themelimin e bazës së certifikimit (CB) dhe bazës së operimit (OB) i janë dërguar operatorit, duke i bërë atij me dije se nga lëshimi fillestar i certifikatës, ka një numër kërkesash të reja/të ndryshuara (të theksuara brenda listave kontrolluese).

Pas pranimit dhe rishikimit të dokumentacionit të nevojshëm, Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës ka kryer një auditim gjithëpërfshirës si pjesë e procesit të certifikimit, për të verifikuar pajtueshmërinë me Rregulloren nr. 17/2017 që përcakton kërkesat dhe procedurat administrative lidhur me aerodromet.

Duke marrë parasysh që ndryshimet infrastrukturore ndikojnë në bazat e certifikimit dhe operimit, që rrjedhimisht ndikojnë edhe në kushtet e certifikatës, qëllimi i auditimit ka qenë finalizimi i bazave të certifikimit dhe operimeve, bazuar në specifikat e zbatueshme për certifikim. Auditimi 4 ditor është realizuar me sukses nga data 23 deri më 26 nëntor 2021. Pas përfundimit të auditimit dhe analizimit të dokumentacionit, Drejtori i Departamentit të Aerodromeve ka lëshuar rekomandimin tek Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së për lëshimin e certifikatës.

Më 21.12.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ka lëshuar certifikatën e operimit për kodin referent të aerodromit 4E, bazuar në karakteristikat dhe performancën e aeroplanëve më të mëdhej që janë planifikuar të operojnë në ANP “Adem Jashari”. Përveç zgjatjes së pistës nga 2.500 në 3.040 metra, ku janë përfshirë edhe dy rrugë të reja për dalje të shpejtë të aeroplanëve nga pista, ndryshimi i certifikatës përfshin poashtu edhe plotësimin e kriterëve për standardet dhe procedurat përkatëse të infrastrukturës në aeroport, për operim me sistemin preciz të aterrimit “ILS CAT III B” në pistën 17 (ana veriore), si dhe me sistemin preciz të aterrimit “ILS CAT I” në pistën 35 (ana jugore), në korrelacion me pajisjet përkatëse naviguese dhe plotësimin e standardeve që ndërlidhen me navigimin ajror.

Kjo certifikatë do të mbetet e vlefshme për një afat të pakufizuar, përveç nëse dorëzohet apo revokohet.



Shenjat për kategorinë e operimeve CAT II/III

iv. Certifikimi i LKIA-së si organizatë për aftësi profesionale në fushën e aerodromeve

Gjatë muajit dhjetor 2021, operatori i ANP “Adem Jashari” - LKIA ka aplikuar për certifikim të organizatës për aftësi profesionale, por poashtu ka parashtruar edhe një kërkesë në AAC për zgjatje të afatit për certifikim, meqenëse Rregullorja (AAC) nr. 07/2020 për aftësimin profesional për punonjësit të cilët kryejnë detyra që ndikojnë në sigurinë e operimeve në aerodrome dhe certifikimin e organizatave për aftësi profesionale, e publikuar në muajin janar 2021, ka hyrë në fuqi 6 muaj pas nënshkrimit (qershor 2021). Arsyeja e kërkesës për zgjatje ishte e bazuar në rrethanat dhe kufizimet e krijuara pas përhapjes së pandemisë COVID-19, të cilat rrethana kanë pasur ndikim në çështje logjistike të operimeve në LKIA në përgjithësi dhe rrjedhimisht edhe në organizimin dhe vonesën e aplikimit për certifikim si organizatë trajnuese.

Bazuar në këtë kërkesë dhe duke pasur parasysh se të gjitha programet e trajnimeve të cilat LKIA i ofron për punonjësit e vet janë aprovuar në vazhdimësi nga AAC-ja, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së më 22 dhjetor 2022 ka lëshuar Vendimin për zgjatjen e afatit për certifikim të LKIA-së si organizatë trajnuese deri më 31 mars 2022, sipas

Rregullores përkatëse për dispozitat e fleksibilitetit ku lejohen përjashtime për persona juridikë që i nënshtrohen akteve normative të miratuara në rast të rrethanave të paparashikueshme që mund të paraqiten.

Në anën tjetër, është rishikuar dhe aprovuar përditësimi i materialeve trajnuese të operatorit LKIA për trajnimin e aprovuar më parë “De/Anti-icing”.

v. Vlerësimi i ndikimit të turbinave të erës dhe ndërtimeve të larta në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës

Departamenti i Aerodromeve ka vazhduar të ushtrojë rolin koordinues për vlerësimin e ndikimit të ndërtimeve të larta në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës. Sipas Ligjit nr. 03 / L-051 për Aviacionin Civil, Rregullores (AAC) nr. 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe Rregullores (AAC) nr. 03/2019 për Shënjimin e pengesave, Autoriteti i Aviacionit Civil është përgjegjës për të siguruar se të gjitha objektet, të palëvizshme apo të lëvizshme, që gjenden brenda një hapësire me rreze prej 15 km prej një aerodromi, apo objekte të larta që mund të konsiderohen si pengesa për mjetet ajrore në fluturim jashtë kësaj hapësire, i janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit gjithëpërfshirës aeronautik nga ana e operatorit të ANP “Adem Jashari” (LKIA) dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA). Varësisht nga rezultatet e vlerësimeve, AAC-ja do të konstatojë se a paraqet pengesë një objekt apo jo, dhe mund të kërkojë nga aplikuesi që të zbatojë procedurat për shënjimin (me ngjyrosje dhe/apo ndriçim) e objekteve, me qëllim të ngritjes së sigurisë së fluturimeve, duke i bërë pengesat të dallueshme nga zonat përreth dhe të dukshme nga të gjitha drejtimet për mjetet ajrore. Duke i koordinuar veprimet nën përgjegjësinë e saj, AAC-ja duhet të sigurohet se ndërtimi, instalimi dhe operimi i turbinave të erës nuk do të ndikojë në sigurinë e operimeve të aeroportit dhe në trajektoret e fluturimeve të mjeteve ajrore në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2021 inspektorët e aerodromeve kanë vazhduar konsultimet dhe koordinimin edhe me operatorin e fermës së turbinave të erës në fshatin Kikë, Komuna e Kamenicës, lidhur me vendosjen e dritave sinjalizuese shtesë, bazuar në Rregulloren 03/2019. Investitori/operatori i fermës “GÛRİŞ” dhe prodhuesi i turbinave “General Electric” nga Gjermania, gjatë vitit të kaluar kanë përfunduar montimin e dritave shtesë në shtyllat e gjeneratorëve, kurse inspektorët e aerodromeve gjatë muajit maj kanë bërë verifikimin në terren për të konfirmuar funksionalitetin e tyre.

Lidhur me projektin për ndërtimin e fermës së gjeneratorëve të kompanisë “SOWI Kosovo LLC” në Selac, Komuna e Mitrovicës, AAC-ja ka vazhduar të ushtrojë rolin e saj koordinues dhe të monitorojë nga afër zhvillimet e punimeve deri në përfundimin e plotë të këtij projekti. Për këtë qëllim, me kërkesë të ASHNA-s, më 13.01.2021 është organizuar takimi trepalësh AAC/ASHNA/SOWI lidhur me prezantimin e procesit të punëve ndërtimore dhe planifikimit për përfundim të projektit. Në takim është dakorduar që përfaqësuesi i SOWI-it t’i dërgojë lokacionet/koordinatat e sakta të çdo turbine veç e veç, për ti bashkërenduar veprimet e mëtutjeshme me ASHNA-n. Gjithashtu, është kërkuar që të na njoftojë për planin e fundit dinamik për vendosjen e

tyre. Pas pranimit të dokumentacionit të kërkuar, AAC-ja ka realizuar një inspektim në teren dhe është njoftuar nga përfaqësues të SOWI-it për zhvillimet e fundit në përfundimin e këtij projekti. Komunikimi ka vazhduar përmes postës elektronike deri në njoftimin për përfundimin e projektit dhe vendosjen e shenjzimit të kërkuar.



Turbinat e erës "SOWI Kosovo LLC", në Selac

Më 09.03.2021 Departamenti i Aerodromeve ka pranuar shkresën nga investitori "Stubllaenergy" lidhur me kërkesën për interpretime ligjore që kanë të bëjnë me standardet për zonat mbrojtëse të aerodromit dhe kushtet për shënjimin e pengesave. Pas konsultimit me Departamentin e SHNA-së, më 17.03.2021 është dërguar përgjigja palës së interesuar, me të gjitha udhëzimet e nevojshme.

Në dhjetor të vitit 2021, AAC-ja ka pranuar dokumentacionin e kërkuar për vlerësim aeronautik të një shtylle të lartë me pajisje meteorologjike për matje të erës, e cila pritet të vendoset në lokacionin ku është paraparë të ndërtohet ferma e gjeneratorëve të erës, pas fazës së vlerësimit të fizibilitetit. Brenda kompetencave të veta, bazuar në Rregulloren 09/2018 për zonat mbrojtëse të aeroportit dhe procedurave të brendshme, AAC-ja ka kërkuar nga operatori i ANP "Adem Jashari" dhe ASHNA të bëjnë vlerësimet aeronautike sipas përgjegjësisë të tyre.

AAC-ja ka pranuar një konfirmim nga operatori i ANP "Adem Jashari" se objekti nuk do të jetë pengesë brenda përgjegjësisë të aeroportit, kurse ASHNA ka vlerësuar se vendosja e një shtylle me anemometër në lokacionin e paraparë interferon me trajektorët e fluturimit. Duke pasur parasysh këtë rezultat, pritet që ASHNA ta trajtojë këtë çështje në nivele me të larta të menaxhmentit të insitucionit.

vi. Implementimi i Rregullores 03/2019 për shënjimin e pengesave dhe Rregullores 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromeve

Verifikimi i implementimit të Rregullores 03/2019 për shënjimin e pengesave

Në kuadër të përgjegjësisë, inspektorët e aerodromeve kanë vazhduar inspektimet në terren, për të konfirmuar përmbushjen e kërkesave të Rregullores 03/2019 për shënjimin e pengesave dhe Rregullores 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromeve.

Për të bërë verifikimin e implementimit të Rregullores 03/2019 për shënjimin e pengesave, sipas planit të veprimit për vitin 2021, është vazhduar përcjellja e zbatimit të planit të kompanisë KOSTT për shënjimin vizual të linjave 400/220/100 kV, të cilat gjenden në kryqëzimin e autostradës “Ibrahim Rugova”, që përshkon aksin rrugor (R7) Arllat - Prizren, dhe autostradës “Arbër Xhaferi” në aksin rrugor (R6) Prishtinë - Hani Elezit.

Në fillim të vitit, AAC-ja ka pranuar njoftimin nga KOSTT-i se është përfunduar faza e prokurimit dhe se gjatë vitit 2021 do të fillojnë me fazën e parë të realizimit të shenjësimit të pengesave sipas standardeve të përshkruara. Gjatë muajit maj, është realizuar një takim me përfaqësuesit e KOSTT-it, ku janë prezantuar metodologjia dhe mënyra e ngjyrosjes së shtyllave. Po ashtu, është analizuar dokumentacioni i pranuar nga kontraktori. AAC-ja ka ripotencuar se duhet të zbatohen kërkesat e Rregullores 03/2019 për shënjimin e pengesave, sa i përket vendosjes së sferave, ngjyrosjes dhe ndriçimit të shtyllave. Gjatë çerekut të tretë të vitit 2021, kompania KOSTT ka filluar me zbatimin e projektit, përfshirë ngjyrosjen dhe ndriçimin e shtyllave, kurse inspektorët e aerodromeve kanë realizuar inspekte të shumta në terren, për të parë nga afër punët.

Më 22.11.2021 AAC-ja ka pranuar raportin për implementimi e fazës së parë të shenjësimit të pengesave në vitin 2021, përfshirë:

1. Vendosjen e sferave në kablllo,
2. Vendosjen e dritave sinjalizuese në shtylla, dhe
3. Ngjyrosjen e shtyllave (kuq dhe bardhë).

Në takimet e mbajtura me KOSTT-in është dakorduar që punimet të vazhdojnë në vitin 2022, në koordinim të përhershëm me AAC-në.

Gjatë muajit mars 2021, Autoriteti i Aviacionit Civil ka pranuar një kërkesë nga përfaqësuesit e Fabrikës së Çimentos “Sharrcem”, nga Hani i Elezit, për sqarimin e standardeve që aplikohen për shënjimin e objekteve të larta në territorin e Republikës së Kosovës, veçanërisht oxhaqeve. Për të verifikuar gjendjen në terren, më 19 mars inspektorët e AAC-së kanë vizituar fabrikën “Sharrcem”, ku kanë zhvilluar edhe një takim informues me përfaqësuesin e kompanisë. Në takim janë diskutuar sfidat e implementimit të plotë të Rregullores nr. 03/2019 dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren nga subjektet juridike. Në vazhdim, pas marrjes së të gjitha informatave rreth objektit në fjalë, inspektorët e aerodromeve kanë analizuar standardet dhe

kërkesat ligjore lidhur me shënjimin e oxhaqeve dhe kanë dërguar shkresën te operatori për t'i potencuar obligimet e tyre ligjore.

Gjatë muajit maj 2021 janë realizuar edhe dy takime me përfaqësuesit e fabrikës "Sharrcem" për t'i ofruar atyre sqarime shtesë lidhur me standardet që aplikohen për shënjimin oxhaqeve. Në këto takime është kërkuar nga operatori që ta prezantojë planin konkret me afate për implementimin e shenjzimit dhe ndriçimit. Gjatë muajit tetor 2021, Departamenti i Aerodromeve ka pranuar informacionin lidhur me fillimin e instalimit të dritave dhe ngjyrosjen e oxhakut.

Pas pranimit të planit zbatues për shenjzimin e oxhakut të fabrikës, gjatë vitit 2022 inspektorët do të monitorojnë dhe verifikojnë implementimin e tij për përputhshmëri me standardet përkatëse.

Ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të ANP "Adem Jashari"

Në kuadër të përgjegjësiave për rregullimin e zonave mbrojtëse të aerodromeve, inspektorët e aerodromeve kanë vazhduar me mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullores mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe Rregullores për shënjimin e pengesave.

Më 01.07.2021, AAC-ja ka pranuar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" LKIA vlerësimin e aplikacionit për projektin e ndërtimit të një depoje dhe ekspoziture me administratë në afërsi të aeroportit në fshatin Sllatinë e Madhe, komuna Fushë Kosovë, kurse më 02.07.2021 është pranuar një vlerësim tjetër nga LKIA për ndërtimin e një depoje të produkteve të qumështit gjithashtu në Sllatinë të Madhe. Po ashtu, më 10.09.2021, është pranuar edhe një vlerësim tjetër nga LKIA për projektin e ndërtimit të një sillosi për çimento dhe depoje për deponimin e materialeve në fshatin Harilaq, komuna Fushë Kosovë.

AAC-ja ka vlerësuar dhe rishikuar në hollësi dokumentacionin e pranuar dhe pasi është siguruar që ndërtimet nuk do të ndikojnë në sigurinë e operimeve të aviacionit civil ka miratuar vlerësimet, me kusht që zbatohen të gjitha rekomandimet e parashtruara. Për më shumë, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet palëve përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve relevante për ndërtim brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve, inspektorët e aerodromeve kanë zhvilluar takime me zyrtarë përgjegjës të komunës së Fushë Kosovë dhe të LKIA-së.

vii. Ushtrimi gjithëpërfshirës për reagim në emergjenca në ANP "Adem Jashari"

Gjatë muajit dhjetor, AAC-ja ka angazhuar ekipin e inspektorëve nga të gjitha departamentet operative të AAC-së për të marrë pjesë në ushtrimin gjithëpërfshirës për reagim në emergjenca në ANP "Adem Jashari", të organizuar nga LKIA, i cili rrjedhë nga kërkesa e Rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet, në bazë të së cilës është certifikuar operatori LKIA.

AAC-ja është përfaqësuar me zyrtarë ndërlidhës në qendrën operative për emergjencë (EOC) dhe me 8 inspektorë/vëzhgues në pikat e ndryshme, për të vëzhguar dhe vlerësuar implementimin e këtij ushtrimi sipas direktivës së ushtrimit dhe Planit Emergjent të aeroportit.

Pas ushtrimit, ekipi i inspektorëve të AAC-së ka përgatitur raportin e vlerësimit të implementimit të ushtrimit, i cili është dorëzuar edhe tek operatori i aeroportit, ku çdo gjetje apo vërejtje duhet të merret parasysh për të përmirësuar angazhimin e të gjithë akterëve përgjegjës për reagim në emergjencë të aviacionit.

viii. Organizimi i trajnimit rajonal në vendin e punës “Menaxhimi i botës shtazore në aeroporte”, të organizuar përmes projektit EASA IPA

Trajnimi në vend të punës, në fushën e aerodomeve, me titull “Menaxhimi i botës shtazore në aeroporte” është mbajtur nga 11-14 tetor 2021 në Prishtinë, në të cilin morën pjesë inspektorët e aerodomeve të AAC-ve të Kosovës dhe Malit të Zi, përfaqësuesja e ZÇLA-s së AAC-së si dhe personeli përgjegjës i operatorit të ANP “Adem Jashari”.

Për ligjërimin e këtij trajnimi në vend të punës, EASA e kishte kontraktuar AAC-në e Spanjës, përkatësisht departamentin e kësaj AAC-je për emergjencë dhe kontrollin e botës shtazore. Gjatë këtij trajnimi është analizuar baza ligjore, programi i menaxhimit të botës shtazore i ANP “Adem Jashari”, implementimi i procedurave dhe masave në terren, si dhe është bërë vizita në terren për të vlerësuar ndikimin e ligatinës së Hencit dhe lumenjve përreth aeroportit në aktivitetet e botës shtazore në raport me operimet e aeroportit.

d) Rregullimi ekonomik i aviacionit

Në bazë të nenit 15, pika e) e LAC-së, AAC-ja është përgjegjëse për rregullimin e ekonomisë së aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Rregullimi ekonomik i këtyre operatorëve nënkupton masat që merr një rregullator i aviacionit për t’u siguruar se tarifat të cilat i vendos aeroporti dhe ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror për kompanitë ajrore janë të vendosura në mënyrë të arsyeshme, transparente dhe jodiskriminuese. Për më tepër, rregullatori siguron që këto tarifa janë vendosur vetëm pasi që ofruesit dhe shfrytëzuesit e shërbimeve janë konsultuar mes veti duke i ofruar njëri-tjetrit të dhëna në mënyrë transparente. AAC-ja i rregullon dhe i miraton vetëm tarifat aeronautike të cilat kanë lidhje me shërbimet që aeroporti dhe ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror i ofrojnë ekskluzivisht, pa pasur kurrfarë konkurrence, siç janë tarifa e shërbimit të udhëtarëve, tarifa e aterimit apo ajo terminale të navigacionit. Poashtu, rregullatori mbikëqyr nëse qëndrueshmëria financiare e operatorëve është në nivel të duhur që të mos e dëmtojë sigurinë e operimeve. Këto përgjegjësi ushtrohen nga zyrtarët përgjegjës për rregullim ekonomik të aviacionit brenda Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik në AAC.

i. Mbikëqyrja e vazhdueshme ekonomike e aeroportit

Analiza e pasqyrave të audituara financiare të operatorit të ANP “Adem Jashari” për gjendjen financiare në fund të vitit 2020 ka vërtetuar që LKIA sh.a. kishte kaluar një vit të vështirë financiar për shkak të rënies drastike të trafikut ajror, të shkaktuar nga pandemia (53% më pak udhëtarë se në vitin 2019). Ka pasur rënie të të hyrave (50%) që ka ndikuar në mbylljen e vitit financiar me më shumë se 9 milion euro humbje neto. Për të tejkaluar këtë krizë financiare operatori LKIA kishte marr kredi shtesë prej 3.25 milion euro. Në raportin e mbikëqyrjes ekonomike është theksuar që duhet të vazhdohet monitorimi i afërt edhe gjatë vitit 2021 deri në normalizim të trafikut dhe gjendjes financiare. Për këtë qëllim, departamenti përgjegjës për rregullim ekonomik të aviacionit ka bërë mbikëqyrjen e jashtëzakonshme financiare të operatorit të aeroportit për t’u siguruar që po përmirësohet shëndeti financiar, si element shumë i rëndësishëm për mirëmbajtjen e standardave të sigurisë.

Raportet e mbikëqyrjes së jashtëzakonshme ekonomike, pas analizës së pozicioneve financiare në fund të çdo tremujori të vitit 2021, konfirmojnë përmirësimin e shëndetit financiar në tremujorin e tretë të vitit 2021, pasi që trafiku në tremujorin e dytë ishte përmirësuar dukshëm dhe ka vazhduar edhe në tremujorin e fundit të vitit 2021. ANP “Adem Jashari” është ndër të vetmit aeroporte që në fund të vitit 2021 ka arritur ta rikuperojë 92% të trafikut të vitit 2019, përderisa aeroportet në rajon ia kanë dalë të rikuperojnë vetëm rreth 50% të trafikut të vitit 2019. Zyrtarët e rregullimit ekonomik të aviacionit presin që ky përmirësim të vazhdojë edhe gjatë vitit 2022 me kusht që stabilizimi i mëtejshëm i situatës pandemike të vazhdojë, që do të garantonte numër të shtuar udhëtarësh dhe rrjedhimisht të hyra për operatorin LKIA.

Në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve, në muajin prill është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të LKIA-së për operimet në ANP. Polica për përgjegjësi në aviacion mbulon periudhën 4 prill 2021 - 3 prill 2022 dhe ka mbulesë prej 100,000,000 EUR për cilindo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet.

Miratimi i Programit Nxitës 2020-2022 të plotësuar dhe ndryshuar

Më 10 shtator 2021, Drejtori i përgjithshëm, pas rekomandimit të Departamentit për BNRREA, përmes Vendimit nr. 08/ZDP/VE/2021 ka aprovuar Programin Nxitës për ANP “Adem Jashari” të ndryshuar sipas propozimit të operatorit të aeroportit, të dt. 31 gusht 2021. Programi i ndryshuar është efektiv për periudhën 29 mars 2020 - 27 mars 2021 dhe 1 qershor 2021 - 26 mars 2022.

Nevoja për këtë ndryshim ka ardhë si rezultat i çrregullimeve në operime në muajt e parë të sezonit veror 2021 të IATA-s, për shkak të orareve të rishqyrtuara dhe ndryshuara shpesh të kompanive ajrore të përcjella me shumë anulime, situatë që është përmirësuar pas datës 1 qershor 2021. Ndryshimet e propozuara përfshijnë vetëm periudhën e aplikueshmërisë si rezultat i problemeve të shkaktuara nga pandemia në

rregullsinë e operimeve dhe si pasojë vështirësinë e përmbushjes së kriterëve nga kompanitë ajrore për të përfituar nxitje.

Përmes ofrimit të uljeve të tarifave të rregulluara nga AAC-ja, siç janë tarifa e aterimit dhe parkimit të aeroplanëve, kompanitë ajrore janë nxitur nga operatori i aeroportit që të hapin linja të reja ajrore, frekuenca të reja dhe të stacionojnë aeroplanët në ANP.

Inicimi i masës për shkelje administrative ndaj LKIA-së

Gjatë vitit 2021, AAC-ja ka monitoruar zbatimin e Vendimit 01/ZDP/VE/2021 dt. 19.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm. Ky Vendim obligon LKIA-në të publikoj listën e infrastrukturës së centralizuar të aprovuar nga AAC-ja; të mos aplikoj tarifa ndaj ofruesve të shërbimeve në tokë, të cilat nuk janë të përcaktuara sipas marrëveshjes së PPP-së dhe në të njëjtën kohë nuk janë të aprovuara nga AAC-ja; nëse vendosë të aplikoj tarifë ndaj ofruesve të shërbimeve në tokë, të aplikoj pranë AAC-së për aprovim të tarifës së tillë; dhe të trajtoj në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët për ofrimin e shërbimeve në tokë. Në përgjigje ndaj këtij vendimi LKIA ka deklaruar se e konsideron vendimin e AAC-së si të pabazuar dhe se ka tejkaluar kompetencat ligjore të AAC-së. Dhe kundër Vendimit në fjalë ka ngritur konflikt administrativ në gjykatë.

Pasi që operatori i aeroportit ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme që të zbatojë Vendimin nr. 01/2021 të Drejtorit të Përgjithshëm, më 5 maj 2021, inspektori i rregullimit ekonomik të aviacionit ka iniciuar në KSHSHGJA (Komisioni për Shqyrtimin e Shkeljeve dhe Gjobave Administrative në AAC) procedurën për shqyrtimin e shkeljes administrative ndaj LKIA-së për moszbatimin e Vendimit nr. 01/2021 të Drejtorit të Përgjithshëm. Inicimi është bërë në përputhje me Nenin 5 - Inicimi i procedurës për shqyrtimin e shkeljeve administrative të Rregullores (AAC) nr. 02/2019 për gjobat dhe masat administrative të shqiptuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës.

Komisioni ka vendosur të mos procedojë me shqiptimin e gjobës administrative ndaj LKIA-së duke vlerësuar se shuma e gjobës prej 3000 - 15000 EUR, që mund t'i shqiptohet LKIA-së në bazë të Shtojcës 1, Tabela II, pika 8, pragrafi 8.1 të Rregullores së AAC-së nr. 02/2019 për Gjobat dhe Masat Administrative të Shqiptuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, nuk është proporcionale me fitimin që LKIA është duke e realizuar nga tarifa që është duke e aplikuar ndaj operatorit Ex Fis (subjektit afarist "Ex Fis" sh.p.k.), pra është e papërfillshme për LKIA-në dhe si e tillë do të ishte joefektive dhe e padobishme.

ii. Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s

Në bazë të Rregullores nr. 3/2016 të AAC-së mbi skemën e përbashkët të tarifave të shërbimeve të navigacionit ajror, ASHNA çdo vit i propozon AAC-së për miratim një vlerë të tarifës terminale, njësi e cila do të jetë e aplikueshme në vitin pasues ndaj të gjitha kompanive ajrore që marrin shërbimin terminal të navigacionit nga ASHNA gjatë uljes apo ngritjes nga ANP "Adem Jashari". Me qëllim të vlerësimit të propozimit

të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2022, AAC ka pranuar dokumente të nevojshme shtesë nga ASHNA dhe i ka shqyrtuar ato. Pasi që zyrtarët e rregullimit ekonomik të aviacionit kanë përfunduar shqyrtimin rregullator të propozimit të ASHNA-s për koston e ofrimit të shërbimit gjatë vitit 2022, duke marrë parasysh edhe dëshmitë për konsultime me kompanitë ajrore si dhe parashikimin e trafikut për vitin 2022, kanë lëshuar një Rekomandim më datën 6 dhjetor 2021 përmes të cilit kanë bërë përcaktimin e secilës prej kostove të pranueshme, siç janë përcaktuar në Rregulloren nr. 3/2016 të AAC-së. Drejtori i përgjithshëm i AAC-së më 14 dhjetor 2021 ka nënshkruar Vendimin Ekzekutiv nr. 11/ZDP/VE/2021, përmes të cilit përcaktohet tarifa njësi terminale në Republikën e Kosovës në vlerë prej 418 EUR, duke filluar nga 1 janari 2022, e vlefshme për një vit. Kjo vlerë e përcaktuar nga AAC-ja është më e vogël se ajo e propozuar nga ASHNA (445 EUR) dhe më e madhe se tarifa njësi terminale e vitit 2021 (407 EUR). Nën supozimin se rritja e numrit të njësive terminale të shërbyera gjatë vitit 2022 do të jetë 5% në krahasim me vitin 2021, kjo tarifë pritet të sjellë të hyra afro 4.89 milion EUR për ASHNA-n.

Tarifa terminale e navigacionit u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që kjo i ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Shërbimet për aeroplanët që mbikalojnë Kosovën do të vazhdojë t'i ofrojë HungaroControl, prandaj edhe të hyrat për këtë shërbim i shkojnë ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë. Gjatë përcaktimit të tarifave aeronautike, AAC-ja kujdeset që të miratojë vetëm kostot e pranueshme dhe të nevojshme për të dhënë shërbimin në pajtim me rregulloren në fuqi, në mënyrë që të ruaj edhe interesin e udhëtarëve dhe konkurrueshmërinë e aeroportit.

Në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve, është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të ASHNA-së e datës 30 dhjetor 2020. Polica për përgjegjësi në aviacion mbulon periudhën 1 janar 2021 – 31 dhjetor 2021 dhe ka mbulesë prej 200,000,000 EUR për cilindo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet ndërsa 20,000,000 EUR për lëndim personal. Gjithashtu, më 5 tetor 2021 AAC-ja është njoftuar se kompanisë së sigurimeve “Kosova e Re” më dt. 24 shtator 2021, me Vendimin nr. 70/2021, i është revokuar licenca dhe nga ajo datë janë hapur procedurat e likuidimit dhe se të gjitha kontratat (policave) aktive ju vazhdohet afati i mbulueshmërisë së rrezikut edhe 30 ditë konform Ligjit për marrëdhënie detyrimore, që do të thotë se pas dt. 24 tetor 2021 të gjitha kontratat shuhen, duke përfshirë edhe kontratën me ASHNA-n. Më 19 tetor 2021, ASHNA ka dorëzuar “Cover Note” nga risiguruesi mbi mbulueshmërinë e sigurimit të operimit deri më dt. 31 dhjetor 2021. Gjithashtu, më 22 tetor 2021, ASHNA ka dorëzuar në AAC policën e sigurimit përmes të cilës është vërtetuar mbulesa nga 24 tetor 2021 deri më 31 dhjetor 2021 me kushtet e njëjta si të policës së kaluar.

iii. Mbikëqyrja e vazhdueshme ekonomike e shërbyesve në tokë

Në ANP operojnë dy ofrues të shërbimeve në tokë, të cilët janë aprovuar nga AAC-ja për këtë qëllim: operatori i ANP “Adem Jashari”, LKIA, si ofrues i një game të gjerë shërbimesh (shërbimet e udhëtarëve, të përpunimit të bagazhit dhe aeroplanëve në

tokë, etj.), si dhe kompania “Ex Fis” sh.p.k., e cila bën furnizimin e aeroplanëve me derivate. Gjatë vitit 2021, organit menaxhues të ANP “Adem Jashari” LKIA i është vazhduar aprovimi prej 30 mars 2021 deri më 31 mars 2022 dhe kompanisë “Ex Fis” i është vazhduar aprovimi prej 01 shkurt 2021 deri më 31 janar 2022. Të dy operatorët janë në mbikëqyrje të vazhdueshme nga AAC-ja për mirëmbajtjen e kritereve të sigurisë dhe atyre ekonomike.

Mbikëqyrja ekonomike e LKIA-së si ofrues i shërbimeve në tokë

Analiza e pasqyrave të audituara financiare 2020 e LKIA-së ka treguar se si pasojë e pandemisë dhe uljes drastike të trafikut edhe të ardhurat totale nga shërbimet në tokë janë ulur në krahasim me vitin paraprak për 48%. Gjatë vitit 2021, zyrtarët e rregullimit ekonomik të aviacionit kanë monitoruar në periudha të rregullta tremujore shëndetin financiar të LKIA-së si ofrues i shërbimeve në tokë, deri në stabilizimin e situatës. Stabilizimi i situatës është konfirmuar në tremujorin e tretë të vitit 2021, si pasojë e rritjes signifikante të trafikut në tremujorin e dytë, i cili ka vazhduar deri në fund të vitit. Është vërejtur trend pozitiv në shumicën e pozicioneve financiare në tremujorin e tretë, në krahasim me dy tremujorët paraprak. Përmes raporteve të audituara financiare 2020 për tarifat e rregulluara nga AAC-ja dhe për tarifat e shërbimeve në tokë, AAC-ja ka vërtetuar përmes deklaratës së auditorit që llogaritë financiare të LKIA-së sa i përket shërbimeve në tokë janë të ndara nga llogaritë e tjera të biznesit, ashtu siç kërkohet me Nenin 4 të Rregullores nr. 4/2011 të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 5/2019 të AAC-së mbi qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

Gjatë vitit 2021, organi menaxhues i aeroportit si ofrues i disa shërbimeve në tokë në ANP “Adem Jashari” ka mirëmbajtur kushtet ekonomike në bazë të të cilave është aprovuar, në pajtim me Nenin 11.4 të Rregullores nr. 4/2011 për shërbimet në tokë të ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019.

Mbikëqyrja vjetore ekonomike e “Ex Fis” si ofrues i shërbimeve në tokë

Analiza e pasqyrave të audituara financiare të operatorit “Ex Fis” sh.p.k. për gjendjen financiare në fund të vitit 2020 ka vërtetuar se kompania e aprovuar nga AAC-ja për furnizim të mjeteve ajrore me karburant, përkundër krizës, ka arritur të mbetet biznes rentabil. Përderisa shitja ishte ulur gjatë vitit 2020 si rezultat i pandemisë, veçanërisht në aeroport, proporcionalisht janë ulur edhe kostot, ndërsa biznesi karakterizohet me kosto kryesisht variable. Përkundër që në raportin e mbikëqyrjes vjetore ekonomike është konstatuar qëndrueshmëri financiare në fund të vitit 2020, inspektorët e rregullimit ekonomik të aviacionit kanë vazhduar ta monitorojnë për së afërmi operatorin, duke analizuar situatën financiare në fund të tremujorit të parë të vitit 2021. Raporti i mbikëqyrjes së jashtëzakonshme ekonomike në fund të tremujorit të parë të vitit 2021 vërteton përmirësimin e pozicioneve financiare, çka do të thotë se kompania “Ex Fis” sh.p.k. po i mirëmban kushtet financiare sipas të cilave është e aprovuar për të dhënë shërbime në tokë. Gjithashtu është konkluduar që nuk ka nevojë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme deri në përqekësimin eventual të trafikut në të ardhmen.

Përmes Deklaratës së auditorit, është vërtetuar që është përmbushur kërkesa nga Rregullorja (AAC) nr. 4/2011 e ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 për ndarje të llogarive të biznesit që zhvillohet në aeroport nga aktivitetet tjera biznesore që zhvillon kjo kompani.

Gjithashtu, është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të “Ex fis” sh.p.k. e cila ka mbulesë 500,000,000 USD për cilindo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet dhe mbulon periudhën 26 maj 2021 - 25 maj 2022. Ky është një element tjetër i rëndësishëm i mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve në fushën e aviacionit civil.

7.9 AKTIVITETI LEGJISLATIV

AAC-ja në bazë të kompetencave të dhëna në Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, është e autorizuar të nxjerrë akte nënligjore për zbatim të Ligjit për Aviacionin Civil, me të cilat bëhet përvetësimi i standardeve ndërkombëtare të aviacionit civil (të njohura si Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara “SPR” e anekseve të Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil - Konventa e Çikagos) dhe të atyre për zbatim të legjislacionit të BE-së në fushën e aviacionit civil, si ato në kuadër të Marrëveshjes HPEA, ashtu edhe të tjerat, të cilat vlejnë për vendet e BE-së, por që ende nuk janë bërë zyrtarisht pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

AAC-ja bën zbatimin e legjislacionit të BE-së në përputhje të plotë me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 3/2013 të Qeverisë së Kosovës për standardet e hartimit të akteve normative. Kjo ndër të tjera nënkupton që secila projekt-rregullore e hartuar nga AAC-ja, që zbaton një akt nënligjor të BE-së, kalon nëpër procedurën e miratimit nga ZKM, departamenti përgjegjës për Integritet Evropian para se të nënshkruhet nga Drejtori i përgjithshëm.

a) Aktet nënligjore

AAC-ja aplikon procedurë transparente gjatë nxjerrjes së akteve nënligjore në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2012 të AAC-së për procedurat e konsultimit publik. Të gjitha aktet nënligjore të AAC-së i nënshtrohen procesit të konsultimit publik të palëve të interesit. Ky konsultim ndjek procedurat dhe afatet kohore të dhëna, gjatë të cilit, çdo palë interesi, qoftë person fizik apo juridik, ka të drejtën e dhënies së komenteve, sugjerimeve apo të kërimit të informacioneve shtesë nga strukturat e AAC-së, të cilat e nxjerrin një projekt-akt në konsultim publik. Forma e marrjes së këtyre komenteve/sugjerimeve nga palët e interesit mund të jetë me organizim të tryezave të rrumbullakëta, varësisht nga numri i të interesuarve, apo nëpërmes korrespondencës elektronike. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, strukturat e AAC-së brenda 2 javëve janë të obliguara që të përgatisin një raport, në të cilin do t'i ofrojnë përgjigjet e tyre në komentet e pranuar, ndërsa duhet të shpjegojnë arsyet për pranimin apo mospranimin e sugjerimeve për ndryshim të dispozitave të projekt-aktit nënligjor që është objekt i konsultimit publik.

Publikimi i akteve nënligjore të AAC-së bëhet në platformën elektronike të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

Në vazhdim janë aktet nënligjore, të cilat janë nxjerrë gjatë vitit 2021:

- Rregullore (AAC) nr. 01/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (AAC) nr. 01/2017 për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (SAP).

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së AAC-së Nr.01/2017, në mënyrë që të ndryshohen dhe qartësohen disa nga rregullat dhe kushtet e operimit me sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (SAP). Rregullorja është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më 27 janar 2021.

- Rregullore (AAC) nr. 02/2021 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 01/2019 për kërkesat e operimeve ajrore për velorë dhe çantat elektronike të fluturimit.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2018/1975 të datës 14 dhjetor 2018 për ndryshimin e Rregullores (EU) nr. 965/2012 për kërkesat e operimeve ajrore për velorë dhe çantat elektronike të fluturimit, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Rregullorja është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më 25 mars 2021.

- Rregullore (AAC) nr. 03/2021 që ndryshon Rregulloren (AAC) nr. 15/2017 në lidhje me prezantimin e specifikimeve të reja shtesë të vlefshmërisë ajrore.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2019/133 të datës 28 janar 2019 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 2015/640 në lidhje me prezantimin e specifikimeve të reja shtesë të vlefshmërisë ajrore, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Rregullorja është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më 25 mars 2021.

- Rregullore (AAC) nr. 04/2021 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 12/2015 për sa i përket listës së transportuesve ajrorë të cilët janë të ndaluar të operojnë ose janë subjekt i kufizimeve operationale brenda Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më 20 maj 2021.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores implementueses të Komisionit (BE) 2020/1992 të datës 2 dhjetor 2020 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 12/2015, për sa i përket listës së transportuesve ajror që janë të ndaluar të operojnë ose janë subjekt i kufizimeve operationale, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës.

- Rregullore (AAC) nr. 05/2021 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më datë 16 korrik 2021.
- Rregullore (AAC) nr. 06/2021 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 17/2017 në lidhje me sigurinë e pistës dhe të dhënat aeronautike.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është transpozimi i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2020/2148 të 8 tetorit 2020 për ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 139/2014 në lidhje me sigurinë e pistës dhe të dhënat aeronautike. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më datë 23 korrik 2021.

- Rregullore (AAC) nr. 07/2021 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 01/2019 në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit dhe shtyrjen e datave të zbatimit të masave të caktuara në kontekstin e pandemisë COVID-19.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2020/2036 të datës 9 dhjetor 2020 për ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 965/2012, në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit dhe shtyrjen e datave të zbatimit të masave të caktuara në kontekstin e pandemisë COVID-19, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më datë 11 gusht 2021.

- Rregullore (AAC) nr. 08/2021 për ndryshimin e rregullores së AAC-së 07/2018 që përcakton kërkesat për identifikimin e avionëve për survejim për qiellin e vetëm evropian dhe rregullores së AAC-së 03/2018 duke vendosur kërkesat për performancën dhe ndërveprimin e survejimit për qiellin e vetëm evropian.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është zbatimi në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/587 të datës 29 prill 2020. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më datë 10 shtator 2021.

- Rregullore (AAC) nr. 09/2021 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 05/2015 në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit, dhe në lidhje me raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil. Kjo rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më datë 13 dhjetor 2021.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/2193 të 16 dhjetorit 2020 në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës.

- Rregullore (AAC) nr. 10/2021 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 17/2017 në lidhje me kushtet dhe procedurat për deklarimin nga organizatat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të platformës. Kjo rregullore është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më datë 29 dhjetor 2021.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është transpozimi i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) nr. 2020/1234 të datës 9 qershor 2020 që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 139/2014 në lidhje me kushtet dhe procedurat për deklarimin nga organizatat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të platformës.

Është hartuar edhe kjo projekt-rregullore:

- Projekt-rregullore (AAC) nr. XX/2022 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 01/2020, Rregullores (AAC) nr. 17/2017 dhe Rregullores (AAC) nr. 09/2020 në lidhje me kërkesat për menaxhimin e trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror, projektimin e strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësinë e të dhënave, sigurinë e pistës dhe shfuqizimin e Rregullores (AAC) nr. 08/2015.

Projekt-rregullorja në fjalë pritet të hyj në fuqi gjatë vitit 2022.

b) Urdhëresat administrative

- Udhëzim Administrativ (AAC) nr. 01/2021 për përcaktimin e certifikatës mjekësore të përshkruar në Rregulloren (AAC) nr. 06/2020 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të paraglajdëve dhe deltaplanëve. Ky Udhëzim Administrativ përcakton llojin e certifikimit mjekësor të anëtarëve të Federatës Aeronautike të Kosovës dhe aeroklubeve tjera të regjistruara në Republikën e Kosovës të cilët drejtojnë mjetet ajrore të përcaktuara me Rregulloren (AAC) nr. 06/2020. Përmes këtij Udhëzimi Administrativ vërtetimi i aftësisë psiko-fizike të drejtuesve të paraglajdit kalon nga fusha e përgjegjësisë së sektorit të Aero Mjekësisë të DSF-së në përgjegjësinë individuale të çdo anëtari të Federatës Aeronautike që merret me aktivitete sportive-rekreative me paraglajd. Ky Udhëzim Administrativ është nënshruar nga Drejtori i Përgjithshëm më datë 23 korrik 2021.
- Udhëzim administrativ (AAC) nr. 02/2021 për zbatimin e specifikimeve të certifikimit, mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialeve udhëzuese të AESA. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të vendosë parimet për të zbatuar specifikimet e certifikimit, mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialet e udhëzimeve të lëshuara nga EASA, në

rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës. Ky Udhëzim Administrativ është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm më datë 11 gusht 2021.

c) Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative

Në vijim janë listuar vendimet ekzekutive dhe ato administrative të lëshuara nga Drejtori i përgjithshëm i AAC-së gjatë vitit 2021:

Vendimet ekzekutive

- Vendimi 01/ZDP/VE/2021, dt. 19 janar 2021, për obligimin e organit menaxhues LKIA për publikim të listës së infrastrukturës së centralizuar;
- Vendimi 02/ZDP/VE/2021, dt. 27 janar 2021, për vazhdim të aprovimit për operatorin Ex Fis si ofrues i shërbimeve në tokë;
- Vendimi 03/ZDP/VE/2021, dt. 01 shkurt 2021, për lejimin e hapësirës ajrore të Kosovës për tipet e aeroplanëve Boeing 737-8 (Max) dhe 737-9 (Max);
- Vendimi 04/ZDP/VE/2021, i dt. 25 mars 2021 për autorizim të Qendrës së Mjekësisë së Punës në Gjakovë si QMA;
- Vendimi 05/ZDP/VE/2021, i dt. 30 mars 2021, për vazhdim të aprovimit për operatorin e ANP "Adem Jashari" - LKIA si ofrues i shërbimeve në tokë;
- Vendimi 06/ZDP/VE/2021, i dt. 17 maj 2021, për shfuqizim të urdhëresës administrative (AAC) nr. 02/2019 për përdorimin e gjuhëve në bord të aeroplanit;
- Vendimi 07/ZDP/VE/2021, i dt. 12 gusht 2021, për shfuqizim të TP 24 "Matjen dhe Vlerësimin e Karakteristikave të Fërkimit në Sipërfaqen e Pistës", versioni 2 (kjo TP është shfuqizuar pas hyrjes në fuqi të Rregullores (AAC) nr. 06/2021 për ndryshimin e rregullores (AAC) nr. 17/2017 në lidhje me sigurinë e pistës dhe të dhënat aeronautike);
- Vendimi 08/ZDP/VE/2021, i dt. 10 shtator 2021 për aprovimin e ndryshimit të programit nxitës 2020-2022 të ANP "Adem Jasharit";
- Vendimi 09/ZDP/VE/2021, dt. 07 tetor 2021 për autorizim të Qendrës së Mjekësisë së Punës në Gjakovë si QMA;
- Vendimi 10/ZDP/VE/2021, dt. 11 nëntor 2021 për aplikacionin e HIB Petrol si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në ANP;
- Vendimi 11/ZDP/VE/2021, dt. 14 dhjetor 2021 për caktimin e tarifës terminale për vitin 2022; dhe
- Vendimi 12/ZDP/VE/2021, dt. 22 dhjetor 2021 për miratimin e kërkesës së LKIA për zgjatjen e afatit për certifikim si organizatë trajnuese.

Vendimet administrative

- Vendimi 01/2021, dt. 12 janar 2021, për zbatimin e Vendimit të KPMSHC nr. 378/2020;
- Vendimi 02/2021, dt. 05 shkurt 2021, për caktim të anëtarëve të komisionit disiplinor;
- Vendimi 03/2021, dt. 05 shkurt 2021, për caktimin e grupit punues për rishikim të TP 16;
- Vendimi 04/2021, dt. 08 shkurt 2021, për caktimin e anëtarit të tretë të Komisionit për shqyrtim të shkeljeve administrative;
- Vendimi 05/2021, dt. 10 shkurt 2021, për ndryshim të Vendimit 04/2021;
- Vendimi 06/2021, dt. 10 shkurt 2021, për caktim të menaxherit të kontratës për bartje të inventarit të AAC-së në objekt të ri;
- Vendimi 07/2021, dt. 11 shkurt 2021 për caktimin e Komisionit për përzgjedhjen e modelit të përshtatshme të pajisjeve të TI;
- Vendimi 08/2021, dt. 23 shkurt 2021 për kthimin e inspektorit të vlefshmërisë ajrore në vijën raportuese në bazë të akt emërimit;
- Vendimi 09/2021, dt. 24 shkurt 2021, për caktimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të menaxherit të kontratës për aktivitetin “hartimi i akteve nënligjore për AAC”;
- Vendimi 10/2021, dt. 25 shkurt 2021, për zbatimin e Vendimin të KPMSHC-së nr. A. 420/2020;
- Vendimi 11/2021, dt. 26 mars 2021, për caktimin e Komisionit për tjetërsim të pasurisë jo financiare me vlerë zero;
- Vendimi 12/2021, dt. 26 mars 2021, për zbatimin e Vendimit të KPMSHC-së nr. A. 24/2021;
- Vendimi 13/2021, i dt. 01 prill 2021, për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Ankesave;
- Vendimi 14/2021, i dt. 19 prill 2021, për caktimin e Komisionit për caktimin e specifikacioneve teknike;
- Vendimi 15/2021, i dt. 24 prill 2021, për aprovim të kërkesës për ndihmë monetare për nëpunësin civil me rastin e vdekjes së anëtarit të afërt të familjes;
- Vendimi 16/2021, i dt. 11 maj 2021, për caktimin e Komisionit për caktimin e specifikacioneve teknike;
- Vendimi 17/2021, i dt. 17 maj 2021, për caktimin e anëtarit të tretë të Komisionit për shqyrtimin e shkeljeve administrative;
- Vendimi 18/2021, i dt. 21 maj 2021, për ndryshimin e Vendimit 18/2021, zëvendësimin e anëtarit të tretë të Komisionit për shqyrtimin e shkeljeve administrative për shkak të konfliktit të interesit;
- Vendimi 19/2021, i dt. 31 maj 2021, për autorizim të përfaqësimit të AAC-së në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;

- Vendimi 20/2021, i dt. 01 korrik 2021, për Vërejtje ndaj nëpunësit civil;
- Vendimi 21/2021, i dt. 07 korrik 2021, për caktimin e menaxherit të kontratës për pajisje të IT-së;
- Vendimi 22/2021, i dt. 07 korrik 2021, për caktimin e komisionit për pranimin e pajisjeve të IT-së;
- Vendimi 23/2021, i dt. 09 korrik 2021, për caktimin e menaxherit të kontratës për materiale higjienike;
- Vendimi 24/2021, i dt. 14 korrik 2021, për ndryshimin e Vendimit 22/2021;
- Vendimi 25/2021, i dt. 14 korrik 2021, për caktimin e menaxherit të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e Agjencive të Pavarura”;
- Vendimi 26/2021, i dt. 14 korrik 2021, për caktimin e menaxherit të kontratës për aktivitetin “Servisim i automjeteve për Agjencitë e Pavarura”;
- Vendimi 27/2021, i dt. 31 gusht 2021, për konpezim me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes së nëpunësit civil;
- Vendimi 28/2021, i dt. 17 shtator 2021, për komisionin për shqyrtimin e shkeljeve administrative;
- Vendimi 29/2021, i dt. 29 shtator 2021, për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të menaxherit të kontratës për sigurim fizik të objektit;
- Vendimi 30/2021, dt. 13 tetor 2021, për caktimin e komisionit për inventarizim të pasurisë jo financiare;
- Vendimi 31/2021, dt. 04 nëntor 2021, për caktimin e menaxherit të kontratës për servisim të automjeteve;
- Vendimi 32/2021, dt. 08 nëntor 2021, për zëvendësimin e anëtarit të KSHSH;
- Vendimi 33/2021, dt. 11 nëntor 2021, për caktimin e Menaxherit të Kontratës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar zyrtar - LOT 1”;
- Vendimi 34/2021, dt. 11 nëntor 2021, Komisioni për përpilimin e specifikacionit teknik për aktivitetet e prokurimit konsulent;
- Vendimi 35/2021, dt. 15 nëntor 2021, për ndryshimin e Vendimit 34/2021;
- Vendimi 36/2021, dt. 24 nëntor 2021, për caktim të menaxherit të kontratës për “shërbime të transportit ajror”;
- Vendimi 37/2021, dt. 12 dhjetor 2021, për caktimin e Komisioni për Pranimin e Pasurisë jo Financiare - Furnizim me Artikuj Ushqimor Kategoria 4 - LOT I - furnizim me material të zyrës;
- Vendimi 38/2021, dt. 12 dhjetor 2021 për caktimin e menaxherit të kontratës Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbime të dizajnit;
- Vendimi 39/2021, dt. 12 dhjetor 2021, për vazhdimin e afatit të Vendimit 30/2021;

- Vendimi 40/2021 dt. 14 dhjetor 2021, për caktimin e Komisionit për Pranimin e Pasurisë jo Financiare;
- Vendimi 41/2021, dt. 16 dhjetor 2021, për caktimin e Komisioni për vlerësim dhe zhvlerësim të pasurisë jo financiare;
- Vendimi 42/2021, dt. 22 dhjetor 2021, për ndryshimin e Vendimit 42/2021.

d) Ndëshkime/ankesa/konteste

Komisioni për Shqyrtimin e Shkeljeve dhe Gjobave Administrative

Gjatë vitit 2021, janë iniciuar tri procedurat e mëposhtme për shqyrtimin e shkeljeve administrative, të cilat Komisioni për Shqyrtimin e Shkeljeve dhe Gjobave Administrative i ka trajtuar dhe ka nxjerrë vendime përkatëse:

- Procedura e parë është iniciuar nga inspektorët e Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (SHNA) ndaj Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), në lidhje me moslejimin e hyrjes së inspektorëve të AAC-së në objektet e ASHNA-s për ta kryer inspektimin e tyre të paparalajmëruar (lidhur me verifikimin e kompetencës dhe kapacitetit teknik dhe operativ të ASHNA-s, trajnimit dhe kompetencës së personelit). Pas kryerjes së vlerësimeve dhe analizave, Komisioni ka nxjerrë vendim për shqiptimin e gjobës administrative në shumën prej 5,000.00 € ndaj ASHNA-s. ASHNA e ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës në Komisionin për Ankesa pranë AAC-së, i cili e ka obliguar Komisionin për Shqyrtimin e Shkeljeve dhe Gjobave Administrative që ta rishqyrtojë vendimin ndaj ASHNA-s. Pas përsëritjes së procedurës së shqyrtimit, Komisioni ka nxjerrë vendimin e dytë, duke e rikonfirmuar shqiptimin e gjobës administrative ndaj ASHNA-s në të njëjtën shumë si herën e parë.
- Procedura e dytë është iniciuar nga njëri prej zyrtarëve të Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit (BNRREA) ndaj operatorit LİMAK Kosovo International Airport sh.a. (LKIA), në lidhje me mosrespektimin e urdhrave dhe direktivave të AAC-së nga ana e LKIA-së. Pas zhvillimit të procedurës së shqyrtimit të shkeljes administrative, Komisioni ka marrë vendim për të mosproceduar me shqiptimin e ndonjë gjobe apo mase administrative ndaj LKIA-së. Për këtë vendim, iniciuesi i procedurës është ankuar në Komisionin për Ankesa pranë AAC-së, i cili e ka aprovuar ankesën e iniciuesit si pjesërisht të bazuar dhe e ka obliguar Komisionin për Shqyrtimin e Shkeljeve dhe Gjobave Administrative që ta shqyrtojë rastin dhe të nxjerrë një akt formal administrativ. Pas rishqyrtimit të rastit, Komisioni ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës së iniciuesit të procedurës për shqiptimin e gjobës administrative ndaj operatorit LKIA. Iniciuesi i procedurës përsëri është ankuar në Komisionin për Ankesa.
- Procedura e tretë është iniciuar nga njëri prej inspektorëve të Departamentit të Aerodromeve (AGA), ndaj operatorit LİMAK Kosovo International

Airport sh.a. (LKIA), në lidhje me mosdhënien zyrtarëve të AAC-së të dokumenteve dhe informacioneve të nevojshme. Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës së iniciuesit të procedurës, i cili, i pakënaqur me vendimin, është ankuar në Komisionin për Ankesa të AAC-së.

7.10 PUBLIKIMET TEKNIKE PËR INDUSTRINË

Për t'i përkrahur operatorët në zbatimin e legjislacionit në fuqi, AAC-ja në vazhdimësi nxjerr publikime teknike për industrinë e aviacionit civil. Gjatë 2021 janë mbajtur të përditësuara publikimet aktuale teknike dhe nuk ka pasur ndonjë publikim të ri, ndërsa është shfuqizuar Publikimi Teknik - TP 24 për "Matjen dhe Vlerësimin e Karakteristikave të Fërkimit në Sipërfaqen e Pistës", versioni 2, i muajit qershor 2018.


Versionet e reja të publikimeve teknike publikohen pas përfundimit të procedurave të brendshme të hartimit dhe amandamentimit, kontrollit të cilësisë dhe aprovimit.

a) Publikimi i pasqyrës për ndodhitë e raportuara

Në muajin prill të vitit 2021, AAC-ja ka publikuar raportin e radhës "Pasqyra e ndodhive të raportuara 2020", në të cilin janë përmbledhur të gjitha ndodhitë e raportuara dhe procesuara në AAC gjatë vitit 2020. Në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, "ndodhia" nënkupton çdo ngjarje që lidhet me sigurinë, që rrezikon ose që, nëse nuk korrigjohet ose adresohet, mund të rrezikojë mjetin ajror, personat në bordin e tij ose çdo person tjetër dhe në veçanti përfshin aksidentin ose incidentin e rëndë.

Gjatë vitit 2020 në AAC janë raportuar gjithsej 101 ndodhi, të cilat janë ndarë në kategori sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi, si dhe janë klasifikuar sipas ashpërsisë së ndikimit të tyre në operimet e sigurt të mjeteve ajrore dhe në personat në bordin e tyre. Këto raporte janë bërë nga personeli i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, KFOR-i, kompanitë ajrore dhe janë marrë nga mediat të cilat i referohen burimeve të Policisë së Kosovës. "Pasqyra e ndodhive të raportuara" përmban një shpjegim të shkurtër të klasave dhe kategorive të ndodhive, një analizë të statistikave të ndodhive të raportuara në vitin 2020, një përshkrim më të hollësishëm të kategorive të koduara të ndodhive, listimin e të gjitha ndodhive (me numrin, titullin dhe klasën e tyre) brenda secilës kategori, si dhe përshkrimin e hollësishëm të ndodhive më të rëndësishme.

Dokumenti "Pasqyra e ndodhive të raportuara 2020" mund të gjendet në faqen zyrtare të AAC-së në internet www.caa-ks.org.



Numri i ndodhive të raportuara sipas muajve gjatë vitit 2020

7.11 INFORMIMI I PUBLIKUT DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

a) Qasja në dokumente publike

Përmes Vendimit nr. 29/2020 të ndryshuar me Vendimin 32/2020 u.d. Drejtori i përgjithshëm ka emëruar zyrtarin për komunikim me publikun, në të njëjtën kohë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave të personave juridikë dhe fizikë për qasje në dokumentet publike të AAC-së, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

Gjatë vitit 2021 nuk është pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente publike.

b) Faqja zyrtare e AAC-së në internet

Faqja zyrtare e AAC-së në internet vazhdimisht freskohet për të reflektuar rregulloret dhe udhëzimet e reja të publikuara nga AAC-ja si dhe versionet e fundit të formularëve online që shërbejnë për aplikim ose për raportim vullnetar dhe të obligueshëm të ndodhive. Raportimi direkt online lehtëson procedurën e raportimit të ndodhive të aviacionit dhe e inkurajon atë.

7.12 PROKURIMI

Gjatë vitit 2021 janë realizuar 10 aktivitetet e poshtëshenuara të prokurimit për furnizim dhe shërbime për nevojat e AAC-së, për të cilat janë lidhur kontratat nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Aktivitetet janë realizuar nga Departamenti për Procedura të Centralizuara dhe Departamenti për Prokurime të AQP-së në emër të autoriteteve kontraktuese në bazë të nenit 21/A të LPP-së.

1. Zhvendosja (bartja) e inventarit të AAC-së në objektin e ri;
2. Konsulenca për mbështetje ligjore;
3. Sigurimi fizik i objektit;
4. Furnizimi me material higjienik (për mbrojtje nga COVID-19);
5. Furnizim me teknologji informative (TI);
6. Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve;
7. Furnizimi me inventar, tavolina pune dhe ormana;
8. Shërbimet e transportit ajror;
9. Furnizimi me materiale të shtypura dhe shërbime të dizajnit (me një furnizim); dhe
10. Furnizimi me ormana metalik.

7.13 RAPORTI FINANCIAR

a) Raporti i buxhetit me shpenzime

Buxheti i miratuar i AAC-së për vitin 2021 ishte 971,377 €, pas rishikimit të buxhetit për vitin fiskal 2021, AAC-ja ka paraqitur kursime buxhetore në kategoritë ekonomike të Mallrave dhe shërbimeve dhe Shpenzimeve komunale në vlerë prej 45,000 €. Buxheti final i AAC-së pas rishikimit ka qenë 926,377 €.

Po ashtu, gjatë tremujorit të fundit të vitit fiskal 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendime për shkurtime dhe ndarje buxhetore, si dhe për transfere dhe rialokime të mjeteve nëpër organizatat buxhetore për vitin 2021. Këto vendime janë: Vendimi nr. 02/48 i datës 15.12.2021, Vendimi nr. 21/50 i datës 23.12.2021, dhe Vendimi nr. 11/52 i datës 29.12.2021. Pas vendimeve të Qeverisë për kursime, ndarje dhe harmonizim, buxheti final i AAC-së ka qenë 888,592.66 €, si dhe donacioni nga Komisioni Evropian ka qenë 5,928.21 €.

Buxheti final i AAC-së në sistemin SIMFK ka qenë 894,520.87 €, duke përfshirë edhe mjetet e bartuara nga donacioni i Komisionit Evropian.

Gjatë vitit fiskal 2021, AAC-ja ka shpenzuar 876,303.44 €, që rezulton se përqindja e realizimit të buxhetit final të alokuar është 98%. Në Tabelën 1 më poshtë është paraqitur buxheti final pas rishikimit dhe shkurtimeve, si dhe vlera e shpenzimeve për secilën kategori dhe përqindja e realizimit të tyre.

Tabela 1 - Buxheti dhe shpenzimet e shprehura në përqindje (%)

Përshkrimi	Buxheti final në SIMFK	Shpenzimet	Realizimi në %
Paga dhe mëditje	768,116.97	768,116.97	100%
Mallra dhe shërbime*	123,579.22	106,378.29	86%
Shpenzime komunale	2,824.68	1,808.18	64%
Gjithsej	894,520.87	876,303.44	98%

* Në buxhetin final janë paraqitur edhe mjetet e bartuara nga donacioni i Komisionit Evropian

b) Të hyrat

Të hyrat e AAC-së depozitohen në llogarinë zyrtare bankare të krijuar nga Thesari në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Të hyrat nga tarifa e sigurisë së udhëtarëve për muajt nëntor dhe dhjetor 2021 regjistrohen në fillim të vitit 2022, në përputhje me memorandumun e nënshkruar në mes të AAC-së dhe operatorit të ANP-së “Adem Jashari”. Këto të hyra transferohen 45 ditë pas përfundimit të çdo muaji.

Të hyrat e AAC-së nga tarifa e sigurisë së udhëtarëve, tarifat e licencimit dhe certifikimit, tarifa e regjistrimit të dronëve, të vjelura në përputhje me Rregulloren nr. 2/2015 për tarifat e ngarkuara nga AAC-ja, si dhe nga gjobat e ndryshme, të ngarkuara në përputhje me Rregulloren nr. 2/2019, janë paraqitur në Tabelën 2 në vazhdim.

Tabela 2 - Të hyrat vetanake të AAC-së

Përshkrimi	2021 € '000	2020 € '000	2019 € '000	% e totalit 2021	% e ndryshimit nga 2020
Të hyrat nga taksat 1				%	%
Të hyrat nga taksat 2				%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1	3	8	1	0%	1%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2				%	%
Të hyrat nga certifikimi/licencat 1	43	31	6	2%	2%
Të hyrat nga licencat 2	0	0	1	0%	0%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve				0%	%
Të hyrat nga/tarifa e pasagjerve	2,009	1,215	2,332	98%	97%
Të hyrat nga interesi bankar				%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit				%	%
Tarifa për akreditim				%	%
Të hyrat nga pasuria				%	%
Pranimet tjera				%	%
Gjithsej	2,055	1,254	2,340	100%	100%

b) Grantet e përcaktuara të donatorëve

Gjatë vitit 2021, AAC-ja nuk ka pranuar mjete nga donacioni i Komisionit Evropian për projektin “Dizajnimi dhe procedurat e fluturimit përmes sinjaleve satelitore” dhe AAC-ja nuk ka pasur shpenzime nga ky projekt. Pjesa e mbetur në vlerë prej 5,928.21 € nga vitit 2020 është bartur në vitin 2021. Vlera në SIMFK e donacionit është 5,928.21 €. AAC-ja është në pritje të një përgjigjeje nga donatori se a mundet AAC-ja t’i shfrytëzojë këto mjete apo ato duhet t’i kthehen donatorit.

Tabela 3 - Grantet e bartura, të pranuar, të shpenzuara dhe të pashpenzuara

Përshkrimi	2021	2020	2019
Grantet e përcaktuara të donatorëve të bartura nga viti i kaluar	5,928	5,928	5,664
Grantet e përcaktuara të donatorëve të pranuar në këtë vit	-	-	264
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	5,928	5,928	5,928
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	-	-	-
Shuma e mbetur për bartje në vitin 2022	5,928	5,928	5,928

c) Shpenzimet buxhetore

Financimi i të gjitha aktiviteteve të AAC-së për vitin 2021 sipas klasifikimeve ekonomike është paraqitur në tabelat e mëposhtme. Janë shpenzuar 876,303.44 €. Nëpunësve të AAC-së u paguhet paga bazë (përfshirë përvojën e punës) dhe nuk marrin shtesa të tjera.

Shpenzimet buxhetore në bazë të kategorive janë pasqyruar në Tabelën 4, pagat në Tabelën 5, ndërsa në Tabelat 6 dhe 7 janë pasqyruar shpenzimet buxhetore në bazë të aktiviteteve (mallra e shërbime dhe shpenzime komunale).

Tabela 4 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Autoritetin e Aviacionit Civil

Shënime	2021	2020	2019
	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
	BKK '000	BKK '000	BKK '000
BURIMET E FONDEVE - PRANIMET			
Granti qeveritar	876	855	922
Të hyrat vetanake			
Të hyrat e dedikuara			
Të hyrat nga AKP			
Grantet e përcaktuara të donatorëve			
Financimet nga huamarrja			
Klauzola e investimeve			
Fondi zhvillimor në mirëbesim			
Pranimet tjera			
Gjithsej	876	855	922
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT			
Operacionet			
Paga dhe shtesa2	768	731	726
Mallra dhe shërbime3	106	118	190
Shpenzime komunale4	2	6	6
	876	855	922
Transferet			
Transfere dhe subvencione5			
Shpenzime kapitale			
Prona, ndërtesa dhe pajisje6			
Pagesa tjera7			
Gjithsej	876	855	922

Tabela 5 - Pagat

	Gjithsej Pagesat	2021							Buxheti Final	Krahasim	2020	2019
		FH	KI	FZHM	GQ	THV	THD	GPD				
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listave të pagave	635				635				635		604	599
Pagesa për sindikatë	-				-				-		-	-
Anëtarësim - oda e infermierëve të Kosovës	-				-				-		-	-
Anëtarësim - oda e mjekëve të Kosovës	-				-				-		-	-
Pagesa neto - punë jashtë orarit	-				-				-		-	-
Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagës)	-				-				-		-	-
Tatimi ndalur në të ardhurat personale	60				60				60		58	57
Kontributi pensional - punëtori	37				37				37		35	35
Kontributi pensional - punëdhënës	37				37				37		35	35
Pagesa për vendime gjyqësorë	-				-				-		-	-
Paga dhe shtesa	768	-	-	-	768	-	-	-	768	100%	731	726

Tabela 6 - Mallrat dhe shërbimet

	Gjithsej Pagesat	2021								Buxheti Final	Krahasim	2020	2019
		FH	KI	FZHM	GQ	THV	THD	GPD					
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000	
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	0				0				0	84%	0	0	
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	6				6				7	95%	0	12	
Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	11				11				12	93%	3	15	
Akomodimet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	10				10				11	100%	3	15	
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtre jashtë vendit	4				4				5	96%	1	3	
Shpenzimet e telefonisë mobile	8				8				8	99%	8	10	
Shpenzimet postare	0				0				0	36%	0	0	
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	18				18				18	97%	7	24	
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe	-				0				2	0%	0	6	

PUNA GJATË VITIT

këshilldhënëse						
Shërbime shtypje - jo marketing	1	1	1	90%	0	2
Shërbime kontraktuese tjera	13	13	14	97%	7	7
Shërbime teknike	2	2	2	100%	2	1
Shërbimet e varrimit	2	2	2	100%	0	0
Mobilje (më pak se 1000 euro)	1	1	1	88%	3	2
Telefona (më pak se 1000 euro)	-	0	-	0%	0	0
Kompjuterë më pak se 1000 euro	3	3	3	100%	2	4
Paisje tjera	0	0	1	25%	1	0
Funizim për zyre	2	2	3	52%	4	5
Funrnizim me ushqime dhe pije (jo dreka zyrtare)	1	1	1	64%	1	1
Furnizim pastrimi	-	0	1	0%	2	3
Furnizim veshmbathje	-	0	-	0%	-	1
Akomodim	-	0	-	0%	-	0
Naftë për ngrohje	2	2	3	76%	15	15
Derivate për gjenerator	-	0	-	0%	-	0
Karburante për vetura	2	2	2	90%	1	2
Regjistrim i automjeteve	0	0	1	85%	0	0
Sigurim i automjeteve	1	1	1	92%	1	1
Taksa komunal	0	0	0	100%	0	0
Sigurim i ndërtesës, tjera	8	8	9	85%	9	11
Mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve	2	2	3	70%	2	3
Mirëmbajtje e ndërtesës	-	0	-	0%	-	-
Mirëmbajtje e teknologjisë informative	0	0	0	40%	0	0
Mirëmbajtje e mobiljeve dhe paisjeve	0	0	0	100%	0	0
Qiraja për ndertësë	7	7	7	100%	42	42
Shpenzime marketingu/informimi publik, reklama, konkurse	-	0	-	0%	1	0
Dreka zyrtare	2	2	3	89%	1	2
Dreka zyrtare jashtë vendit	0	0	0	77%	0	0
Donacioni nga Komisioni Evropian	-		6	0%	-	-
Mallra dhe shërbime	106	106	124	1	118	190

Tabela 7 - Shërbimet komunale

	Gjithsej Pagesat	2021							Buxheti Final	Krahasim	2020	2019
		FH	KI	FZHM	GQ	THV	THD	GPD				
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Rryma	1				1				1	100%	4	5
Uji	0				0				1	16%	0	0
Mbeturinat	0				0				0	14%	0	0
Ngrohja qendrore	-				-					0%		
Shpenzimet telefonike	1				1				1	68%	1	1
Pagesa-vendimet gjyqësore	-									0%		
Shpenzime komunale	2	-	-	-	2	-	-	-	3	64%	6	6

d) Planifikimi / Realizimi i buxhetit

Në Tabelën 8 janë paraqitur të hyrat e mbledhura, buxheti i aprovuar si dhe realizimi i tij. Siç është shpjeguar në Tabelën 1 më lart, AAC-ja ka realizuar 98% të buxhetit përfundimtar të alokuar.

Tabela 8 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit për Autoritetin e Aviacionit Civil

		2021				2020	2019
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Varianca	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	F
	Shënime	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
HYRJA E PARASË SË GATSHME							
	Të hyrat tatimore	8			-		
	Të hyrat jo tatimore	9	2,055		(2,055)	1,254	2,340
	Të hyrat e dedikuara	10			-		
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	11			-		
	Tjera	12			-		
Gjithsej pranimet		2,055	-	-	(2,055)	,254	2,340

PUNA GJATË VITIT

DALJA E PARASË SË GATSHME

Paga dhe shtesa	2	768	68	771	-	731	726
Mallra dhe shërbime	3	106	124	187	17	118	190
Shpenzime komunale		4	3	14	1	6	6
Transfere dhe subvencione	5				-		
Shpenzime kapitale	6				-		
Rezerva					-		
Tjerat	7				-		
Gjithsej pagesat		876	895	971	18	855	922

e) Investimet kapitale

AAC-ja në vitin 2021 nuk ka pasur shpenzime kapitale.

f) Tabelë krahasuese e buxhetit për tre vitet e fundit**Tabela 9 - Krahasimi i buxhetit për tre vitet e fundit**

Përshkrimi	Buxheti final			Realizimi		
	2021	2020	2019	2021	2020	2019
Paga dhe medijtje	768,116.97	731,088.11	725,911	768,116.97	731,088.11	725,911
Mallra dhe shërbime*	123,579.22	146,250.22	228,980	106,378.29	118,174.16	189,955
Shpenzime komunale	2,824.68	6,985.89	13,738	1,808.18	5,607.80	5,908
TOTALI	894,520.87	884,324.22	968,629	876,303.44	854,870.07	921,774

* Në buxhetin final është paraqitur edhe mjetet e bartuara nga donacioni i Komisioni Evropian

g) Buxheti i AAC-së për vitin 2021

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës ka bërë kërkesën buxhetore për vitin 2021 në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore të Republikës së Kosovës.

Për funksionimin dhe ushtrimin e aktiviteteve sipas planifikimit, AAC-ja ka kërkuar një buxhet prej 1,732,046.19 €. Kërkesa buxhetore e AAC-së nuk është aprovuar si e tillë.

7.14 AUDITIMET NDAJ AAC-së**a) Auditimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës**

Zyra e Kombëtare e Auditimit (ZKA)/ETIKA ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare të AAC-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020. Ky auditim është fokusuar në pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit) dhe sistemin e auditimit të brendshëm. Në raportin e ZKA-së, të pranuar në qershor të vitit 2021, në konkluzionin e përgjithshëm thuhet se AAC-ja ka të dizajnuar sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Edhe këtë vit, si viteve tjera, ZKA-ja ka dhënë “Opinion të Pamodifikuar” dhe ka konfirmuar se “pasqyrat financiare të AAC-së për vitin 2020 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale”. Sipas këtij raporti, menaxhimi i buxhetit është bërë në harmoni të plotë me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit është dhënë një rekomandim, të cilin AAC-ja e ka implemtuar menjëherë.

b) Auditimi i Brendshëm nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Gjatë vitit 2021, AAC-ja ka pasur auditim nga Zyra e Auditorit të Brendshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor

2020. AAC-ja i ka implementuar menjëherë rekomandimet e dhëna nga Zyra e Auditorit të Brendshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

8. STATISTIKAT E TRAFIKUT AJROR

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” ka shërbyer gjithsej 2,180,809 udhëtarë në vitin 2021, sipas statistikave që ka mbledhur operatori LKIA. Ky numër udhëtarësh është 97% më i lartë se numri i udhëtarëve që janë shërbyer në këtë aeroport në vitin 2020 (1,104,435) dhe 8% më i ulët se numri i udhëtarëve të shërbyer gjatë vitit 2019. Kjo për shkak të përmirësimit të trafikut ajror në krahasim me vitin e kaluar, i cili ishte goditur rëndë nga pandemia e cila u përhap në mars të vitit 2020 në Kosovë dhe shkaktoi restriksione të mëdha në transportin ajror.

Muaji gusht ka pasur numrin më të lartë të udhëtarëve me gjithsej 383,776 (një muaj rekord në ANP), që pasohet nga muaji korrik me 340,446 udhëtarë, ndërsa trafiku më i ulët ka qenë gjatë muajit prill me 79,278 udhëtarë, pasuar nga muaji shkurt me 96,442 udhëtarë.

Gjatë vitit 2021 janë realizuar 8,921 nisje fluturimesh, apo 92% më shumë se vitin paraprak. U dalluan me më së shumti fluturime muajt gusht dhe korrik, me 1,517 dhe 1,367 nisje fluturimesh. Në anën tjetër, muaji prill kishte më së paku nisje fluturimesh, 370.

Prej destinacioneve, me më së shumti udhëtarë dallohen Bazeli (BSL/MLH), Cyrihu dhe Dyseldorfi. Prej shteteve, sa i përket trafikut të përgjithshëm nga Prishtina, Zvicra është e para e pasuar nga Gjermania, Turqia, Austria, Suedia, e kështu me radhë. Prej kompanive ajrore, prin EasyJet me numrin më të madh të udhëtarëve të shërbyer nga Prishtina, e pasuar nga Eurowings, Wizzair, GP Aviation, Trade Air, Pegasus Airlines, e kështu me radhë.

Sa i përket destinacioneve të mëtejme prej Prishtinës, prin Nju Jorku (JFK), pasuar nga Nju Xhersi (Newark International), Çikago (O’Hare), Frankfurti, Washingtoni dhe Antalia.

Statistikat e plota gjenden në Shtojcën 3 të këtij raporti dhe në faqen e AAC-së në internet: <http://caa-ks.org>.

SHTOJCA 1 - LISTA E TRAJNIMEVE

- **Trajnimet e ndjekura nga inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve (DSF):**

- Nga 18-22 janar 2021, trajnimi on-line “Part 21 Training”, në kuadër të projektit EASA IPA 5, të organizuar nga EASA.
- Nga 19-22 prill 2021, trajnimi on-line “Trajnim për përditësimet e legjislacionit për vlefshmërinë ajrore të vazhdueshme” (Continuing Airworthiness Regulation Updates Training) i projektit EASA IPA 5, i organizuar nga EASA dhe mbajtur nga një inspektor i AAC-së së Kroacisë.
- Më datë 30 prill 2021, trajnimi: Programi i komunikimit dhe zhvillimit “Fit for Future”, i organizuar në Tiranë, për grupin e dytë të personelit profesional të AAC-së.
- Nga 10-13 maj 2021, trajnimi on-line “Punëtorja 2 për implementimin e praktikave dhe mjeteve më të mira në sistemin e menaxhimit të NAA-it” (NAA management system implementation best practices and tools Workshop 2) i projektit EASA IPA 5, i organizuar nga EASA dhe mbajtur nga një inspektor i AAC-së së Spanjës.
- Nga 08-11 qershor 2021, trajnimi on-line “Punëtori për funksionimin e sigurt të rregullimit të dronëve dhe zhvillimin e planit të zbatimit të NAA” në kuadër të projektit EASA IPA 5, i organizuar nga EASA.
- Nga 05-08 korrik 2021, trajnimi on-line i organizuar nga EASA, në kuadër të programit EASA IPA 5 në lidhje me zbatimin e praktikave më të mira të kërkesave rregullatore të certifikimit aero-mjekësor nën drejtimin e AESA-s spanjolle (Agjencia Shtetërore e Sigurisë së Aviacionit).
- Nga 15-16 gusht 2021, Demonstrimi i Integritetit të Portalit AMC (Sistemit për menaxhimin e hapësirës ajrore dhe trafikun e mjeteve ajrore pa pilot të Croatia Control-it) dhe EnforceAir (Sistemit për mbrojtjen e hapësirës ajrore të ndjeshme nga dronët mashtrues të D-Fend Solutions), i organizuar nga Croatia Control, në Split, Kroaci.
- Nga 30 gusht - 03 shtator 2021, trajnimi: Rregullat për Mallrat e Rrezikshme - Fillestar - Kategoria 6 (Dangerous Goods Regulations (DGR) - Initial - Category 6), i organizuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Kompanive Ajrore - IATA (International Air Transport Association) dhe mbajtur, në Gjenevë, Zvicër.
- Më datë 20-23 shtator 2021 trajnimi “EU Ramp Inspection Programme (SAFA) - Initial Theoretical & Practical”, në organizatën trajnuese JAA-TO, në Schiphol-Rijk, Holandë.
- Më datë 05-07 tetor 2021, trajnimi on-line : “PBN Training”, i organizuar nga EASA në kuadër të projektit EASA IPA-5.
- Nga 11-22 tetor 2021, trajnimi on-line : Teknikat e Auditimit (Auditing Techniques), i organizuar nga Universiteti Kombëtar Francez i Aviacionit Civil (ENAC).
- Më datë 22 nëntor 2021, punëtorja e organizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kroacisë (CCAA) në lidhje me “Dangerous Goods Competency Based Training and Assessment (CBTA)”.
- Nga 29 nëntor - 02 dhjetor 2021, trajnimi: “EU Ramp Inspection Programme (SAFA) - Initial Theoretical & Practical”, në Schiphol-Rijk, Holandë.

- **Trajnimet e ndjekura nga inspektorët e Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (DSHNA):**

- Më 25 janar 2021 u mbajt Webinari “The Vulnerability Management”, oraganizuar nga Eurocontrol, IANS.
- Më 10 mars 2021, Webinar i organizuar nga EASA “Global Reporting Format (GRF)”.

- Më 22.06.2021, trajnimi online i titulluar “ATM Digitalization”, i organizuar nga ENAC.
- Më 12.05.2021, Webinari “GEN-FUT - Artificial Intelligence in Aviation”, i organizuar nga EUROCONTROL.
- Më 12.05.2021, Webinari “Overview of Part-PERS of Regulation 2017/373”, i organizuar nga EUROCONTROL.
- Më 12.05.2021, Webinari “GEN-FUT Remote Tower”, i organizuar nga EUROCONTROL.
- Në janar 2021, trajnimi online “Përdorimi fleksibil i hapësirës ajrore”, i ofruar për vendet e rajonit, në kuadër të projektit EASA IPA 5.
- Në shkurt 2021, trajnimi online “Punëtorja AFIS”, i ofruar për vendet e rajonit, në kuadër të projektit EASA IPA 5.
- Në nëntor 2021, trajnimi “Dizajnimi i Procedurave të Fluturimit”, i organizuar në kuadër të projektit EASA IPA 5, në Podgoricë, Mali i Zi.
- Nga nëntori-dhjetori 2021, punëtorja “Trajnim në vend të punës në lidhje me ndryshimet funksionale në ATM/ANS”, i mbajtur në kuadër të projektit EASA IPA 5, në Romë, Itali.
- **Trajnimet e ndjekura nga inspektorët e Departamentit të Aerodromeve (AGA):**
 - Trajnim virtual që ka të bëjë me Rregulloren (AAC) nr. 06/2021 (Global Reporting Format) GRF të organizuar nga EASA.
 - NAA management system implementation best practices and tools Workshop 1 dhe 2 organizuar përmes projektit të IPA 5 implementuar nga EASA.
 - Trajnim rajonal në vendin e punës “Menaxhimi i botës shtazore në aeroporte”, organizuar përmes projektit të IPA 5 implementuar nga EASA.
 - Vlerësimet e sigurisë në aerodrome - Trajnim i avancuar “Safety Assessments at Aerodromes - Advanced Training” në Berlin, Gjermani.
 - Vlerësimet e sigurisë në aerodrome - Trajnim i avancuar “Safety Assessments at Aerodromes - Advanced Training” në Berlin, Gjermani.
 - “IFQP - The Airfield Inspector Training” lidhur me procedurat dhe kërkesat për furnizimin e aeroplanëve me karburant, në Bruksel, Belgjikë.
- **Trajnimi i ndjekur nga zyrtarët e Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit (BNRREA):**
 - Trajnim me temën “Komunikimi i menaxhimit të krizës”, i mbajtur në tetor 2021.
- **Trajnimet e ndjekura nga Departamenti për Siguri dhe Cilësi (DSC):**
 - Më 25 mars 2021 Drejtori i Departamentit për siguri dhe cilësi ka përcjellur trajnim në IKAP me temën: “Planifikimi strategjik, treguesit e performancës, udhëzimet administrative në fushën e planifikimit buxhetor dhe ndryshimet buxhetore”.
 - Nga 12-16 prill 2021 Drejtori i Departamentit për Siguri dhe Cilësi ka përcjellur ueb-punëtorinë e mbështetur nga projekti EASA IPA 5 c dhe realizuar nga Autoriteti Spanjoll i Aviacionit Civil-AESA me temën: “Praktikat më të mira për zbatimin e Sistemit të menaxhimit në Autoritetet Kombëtare të Aviacionit” (NAA management system implementation best practices and tools 1 Workshop).
- **Trajnimet e ndjekura nga Zyra për Çështje Ligjore të Aviacionit (ZÇLA):**
 - Nga 8-9 dhjetor 2021, Procesi dhe teknikat për informimin e publikut mbi detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga MSA, të organizuar nga IKAP.
 - Nga 11-14 tetor 2021, Trajnim në punë për menaxhimin e botës shtazore, të organizuar nga EASA-IPA 5.

- Nga 26-27 maj 2021, Punëtorja e 9-të e vendeve Pan Europiane, të organizuar nga EASA - online.
- Nga 19-21 maj 2021, Trajnimi "Transporti i qëndrueshëm ajror", të organizuar nga ENAC (Shkolla Nacionale e Aviacionit Civil të Francës).
- Nga 11-14 qershor 2021, Legjislacioni për zyrtarët publikë/risitë dhe ndryshimet ligjore, të organizuar nga IDA - Instituti për Drejtësi Administrative.
- Nga 12-16 prill 2021, Punëtorja I rreth Praktikave më të mira dhe mjetet për Implementimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë për autoritetet kombëtare të aviacionit, të organizuar nga EASA-IPA 5.
- **Trajnimet e ndjekura nga zyrtarët e Departamentit të Administratës dhe Njësive të Financave, Prokurimit dhe Burimeve Njerëzore:**
 - Prezantimi online për Zyrtarin Kryesor Financiar, Zyrtarin Zotues dhe Zyrtarin e Pranimit të Mallit rreth disa zhvillimeve dhe avancimeve të funksioneve të kontrollit të menaxhimit financiar, përmes SIMFK-së, i organizuar nga Thesari i Kosovës.
 - Më datë 22.01.2021, trajnimi me temën "Pamje dhe raportim të organizuar", i organizuar nga Thesari i Kosovës.
 - Më datë 23.02.2021, trajnimi online me temën "Standardet e menxhimit dhe Raportimit të rrezikut".
 - Më datë 25.03.2021, Njësia e BNJ dhe DSC-ja kanë ndjekur trajnimin në IKAP, me temën "Planifikimi strategjik, treguesit e performances, udhëzimet administrative në fushën e planifikimit buxhetor dhe ndryshimeve buxhetore".
 - Nga 24-27.05.2021, trajnimi me temën "Organizatata buxhetore", të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike/Ministria e Punëve të Brendshme dhe Departamenti i Buxhetit në Ministrinë Financave, Punës dhe Transfereve.
 - Më 27.04.2021, trajnimi online "Përgatitja, menaxhimi dhe monitorimi i projekteve", i organizuar nga IKAP.
 - Nga 11-14.06.2021, trajnimi për ndryshimet e Ligjit për Zyrtarët Publikë është ndjekur nga zyrtarët e ZÇLA-së, Prokurimit, Burimet Njerëzore dhe të Logjistikës.
 - Nga 04-07.10.2021, trajnimi Identifikimi dhe menaxhimi i rrezikut në procesin e tenderimit, fokusi në prokurim të qëndrueshëm në ekzekutimin e buxhetit, menaxhimi i kontratave dhe roli i burimeve njerëzore në këtë proces.
 - Nga 05-08.11.201, trajnimi me temën: Menaxhimi i kontratës përmes E-Prokurimit.
 - Nga 15-16.11.2021, trajnimi me temën: Llogaridhënia Menaxheriale, i organizuar nga IKAP.

SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-SË PËR VITIN 2021 DHE REALIZIMI I TIJ

1. NORMALIZIMI I HAPËSIRES AJRORE										
1	VEPRIMET (e planifikuara)	Njësia përgjegjëse	AFATI KOHOR				STATUSI Raport i shkurtër	Në Progres		
								Kompletuar		
								Pa Përfunduar		
								Jashtë AAC-së ose të varura nga jashtë		
	1.1 Normalizimi i plotë i hapësirës së ulët ajrore për aviacion të përgjithshëm									
	1.1.1	Koordinimi me ASHNA dhe Agjencinë Kadastrale për hartat VFR	SHNA/DSF/AGA	X	X	X	X			
	Përgatitja e hartave VFR- ASHNA									
1.1.2	Aprovimi i hartave (pas pranimit nga ASHNA)	SHNA/DSF/AGA	X	X	X	X				
Delegimi i hapësirës së ulët ajrore te autoritetet e Kosovës- COMKFOR										
2. ANËTARËSIMI NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE										
2	2.1 Anëtarësimi në ICAO									
	VEPRIMET (e planifikuara)	Njësia përgjegjëse	AFATI KOHOR				STATUSI Raport i shkurtër	Në Progres		
								Kompletuar		
								Pa Përfunduar		
								Jashtë AAC-së ose të varura nga jashtë		
	2.1.1	Përkrahje teknike MPJ-së në procesin e aplikimit për anëtarësim në ICAO	ZDP/BNRREA	X	X	X	X			
	Anëtarësimi në ICAO-MPJ									
2.2 Anëtarësimi në ECAC										

	2.2.1	Përkrahje teknike MPJ-së në procesin e aplikimit për anëtarësim. Hapat e radhës drejt anëtarësimit mund të fillojnë vetëm pas anëtarësimit në ICAO (pika 1.2.4)	ZDP/BNRREA	X	X	X	X		
	2.3 Anëtarësimi në EUROCONTROL								
	2.3.1	Përkrahje teknike MPJ-së në procesin e aplikimit për anëtarësim. Hapat e radhës drejt anëtarësimit mund të fillojnë vetëm pas anëtarësimit në ICAO (pika 1.2.4)	ZDP/BNRREA	X	X	X	X		
3. LIDHJA E MARRËVESHJEVE TEKNIKE NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE									
3	3.1 Lidhja e aranzhimeve të punës me EASA-n								
	VEPRIMET (e planifikuara)		Departamenti përgjegjës	AFATI KOHOR		STATUSI Raport i shkurtër		Në Progres	
								Kompletuar	
				K 1	K 2		K 3	K 4	Pa Përfunduar
									Jashtë AAC- së ose të varura nga jashtë
	3.1.1 Nënshkrimi i aranzhimeve të punës midis AAC-së dhe EASA-s për standardizim								
	3.1.2 Nënshkrimi i aranzhimeve të punës midis AAC-së dhe EASA-s për SAFA								
	3.1.3 Nënshkrimi i aranzhimeve të punës midis AAC-së dhe EASA-s për ECCAIRS								
3.1.4	Lidhja e marrëveshjeve për bashkëpunim me autoritetet e aviacionit civil ne Evrope dhe më gjerë	BNRREA	X	X	X	X			
4. ZBATIMI I PLOTË I PËRGJEGJËSIVE RREGULLATORE									
4	4.1 Plotësimi i legjislacionit sekondar								
	VEPRIMET (e planifikuara)		Departamenti përgjegjës	AFATI KOHOR		STATUSI Raport i shkurtër		Në Progres	
								Kompletuar	
								Pa Përfunduar	
								Jashtë AAC- së ose të varura nga	
				K 1	K 2	K 3	K 4		

SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-së PËR VITIN 2021 DHE REALIZIMI I TIJ

							jashtë
4.1.1. Plotësimi dhe ndryshimi i Manualit të AMK-së	SHNA				X		
4.1.2. Ndryshimi i TP-05	DSF/DSC				X		
4.1.3. RREGULLORE (AAC) NR. 01/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 01/2017 PËR SISTEMET E MJETVE AJRORE PA PILOT (SAP)	DSF	X					
4.1.4. RREGULLORE (AAC) NR. 02/2021 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES (AAC) NR. 01/2019 PËR KËRKESAT E OPERIMEVE AJRORE PËR VELORE DHE ÇANTAT ELEKTRONIKE TË FLUTURIMIT			X				
4.1.5. RREGULLORE (AAC) NR. 04/2021 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES (AAC) NR. 12/2015 PËR SA I PËRKET LISTËS SË TRANSPORTUESVE AJRORE TË CILËT JANË TË NDALUAR TË OPEROJNË OSE JANË SUBJEKT I KUFIZIMEVE OPERACIONALE BRENDË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	DSF		X				
4.1.6. RREGULLORE (AAC) NR. 07/2021 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES (AAC) NR. 01/2019 NË LIDHJE ME KËRKESAT PËR KOMPETENCËN E EKIPIZHIT TË FLUTURIMIT DHE METODAT E TRAJNIMIT DHE SHTYRJEN E DATAVE TË ZBATIMIT TË MASAVE TË CAKTUARA NË KONTEKSTIN E PANDEMISË COVID-19	DSF			X			
4.1.7. RREGULLORE (AAC) NR. 09/2021 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES (AAC) NR. 05/2015 NË LIDHJE ME KËRKESAT PËR KOMPETENCËN E EKIPIZHIT TË FLUTURIMIT DHE METODAT E TRAJNIMIT, DHE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN, ANALIZEN DHE PERCJELLJEN E NDODHIVE NË AVIACIONIN CIVIL	DSF				X		
4.1.8. Plotësim/Ndryshimi i Manualeve aktiv të DSF-se	DSF	X	X	X			
4.1.9. Hartimi i Manualit për trajnime profesionale të AAC-së	BNJ/AGA/DSF/SHNA/DSC			X	X		
4.1.10. Plotësimi dhe ndryshimi i Manualit të departamentit të departamentit të aerodromeve	AGA	X					
4.1.11. Procesi për fuqizimin (enforcement) e publikimeve të reja nga EASA lidhur me AMC dhe/ose urdhëresave.	AGA	X					
4.1.12. Projekt rregullore për transpozimin e Annexit të ri 15 të ICAO-s që është iniciuar vitin e kaluar dhe është dërguar tek Zyra ligjore	SHNA	X		X			

SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-së PËR VITIN 2021 DHE REALIZIMI I TIJ

me 26 tetor 202						
4.1.13. Rregullorja 01/2020 per harmonizimin e anexeve te transpozuara te ICAO-s (SERA) eshte iniciuar vitin e kaluar dhe eshte dërguar tek Zyra ligjore me 5 nentor 2020.	SHNA	X		X		
4.1.14. Projekt rregullore për transpozimin e Rregullores KE nr. 2020/587 që ndryshon Rregulloren e AAC-së nr. 07/2018 dhe Rregulloren e AAC-së nr. 03/2018 duke vendosur kërkesat për performancën dhe ndërveprimin e survejimit për qiellin e vetëm Evropian	SHNA			X		
4.1.15. Projekt rregullore për transpozimin e Rregullores KE nr. 2020/469 e cila amendon Rregulloren e AAC-së nr. 01/2020, Rregulloren nr. 17/2017 dhe Rregulloren nr. 09/2020 si ndërlidhje me kërkesat për menaxhim të trafikut ajror/shërbime të navigacionit ajror, dizajnim të strukturës së hapësirës ajrore dhe kualitet të të dhënave, siguri të pistës dhe zëvendësim të rregullores së AAC nr. 08/2015.	SHNA				X	
4.1.16. Ndryshimi i TP 16	AGA/BNRREA			X		
4.1.17. Projekt rregullorja për ndryshimin e Rregullores Nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me Aerodromet, në lidhje me kushtet dhe procedurat për deklarimin nga organizatat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të platformës, e cila transponon Rregulloren (EU) Nr. 2020/1234, me të njëjtin titull	AGA				X	
4.2 Zbatimi i planit korrektues për adresimin e gjetjeve të EASAs						
4.2.1 Zbatimi i planit korrektues të AAC-së	SHNA	X	X	X	X	
4.2.2 Monitorimi i zbatimit të planit korrektues të ASHNAs	SHNA	X	X	X	X	
4.3 Lëshimi dhe ri-validimi i licencave të personelit të operatorëve dhe lëshimi i lejeve						
4.3.1 Lëshimi dhe validimi i licencave aeronautike	DSF	X	X	X	X	
4.3.2 Lëshimi dhe validimi i certifikatave mjekësore	DSF	X	X	X	X	
4.3.3 Licencimi i Kontrollorëve (proces i vazhdueshëm)	SHNA	X	X	X	X	
4.3.4 Lëshim i lejeve për DGR (sipas kërkesave)	DSF	X	X	X	X	

SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-së PËR VITIN 2021 DHE REALIZIMI I TIJ

4.3.5	Regjistrimi i operatoreve te SAP	DSF	X	X	X	X	
4.4 Mbikëqyrja e vazhdueshme e operatorëve dhe e brendshme							
4.4.1	Plani i detajuar i aktiviteteve mbikëqyrëse është pjesë e planit për 2021, AACK/DSC-PLN 03	AGA/SHNA/DSF/BNR REA/DSC					
4.5 Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s, ANP "Adem Jashari" LKIA dhe shërbyesve në tokë							
4.5.1	Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s (polica e sigurimit 2021)	BNRREA	X				
4.5.2	Mbikëqyrja ekonomike e ANP "Adem Jashari" LKIA sh.p.k. (polica e sigurimit 2021, performanca financiare në 2020, raportet e audituara financiare 2020, performanca e jashtëzakonshme financiare tremujore)	BNRREA	X	X	X	X	
4.5.3	Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA (vlerësimi i performancës financiare në 2020, pasqyrat e audituara financiare 2020)	BNRREA		X			
4.5.4	Inspektim në ASHNA në lidhje me projektet e aprovuara	BNRREA			X		
4.5.5	Mbikëqyrja ekonomike e "ExFis" sh.p.k për shërbimet e furnizimit me kerozinë në aeroport (polica e sigurimit 2021 ndaj rrezikut për shërbimet e ofruara n tokë dhe validiteti i certifikatave të dorëzuara, ndarja e llogarive financiare, vlerësimi i performancës financiare në 2020, pasqyrat e audituara financiare 2020, performanca e jashtëzakonshme financiare tremujore)	BNRREA	X	X	X	X	
4.6 Raportimi i brendshëm dhe ndërinstitucional							
4.6.1	Konsolidimi i raportit vjetor të AAC-së	ZDP	X				
4.6.2	Dorëzimi i raportit vjetor në Kuvendin e Kosovës	ZDP	X				
4.6.3	Konsolidimi i raporteve tremujore të AAC-së	ZDP	X	X	X	X	
4.6.4	Dorëzimi i raportit tremujor te Bordi Mbikëqyrës	ZDP	X	X	X	X	
4.6.5	Raportimi lidhur me proceset e integritetit evropian (Raporti i	BNRREA	X	X	X	X	

	Vendit, raportimet periodike ECAA, Nënkomiteti i MSA-së për transport)						
4.6.6	Raportimi për PKZMSA	BNRREA	X	X	X	X	
4.6.7	Dërgimi i pasqyrave financiare ne MF dhe ZAP	ZKF/ZDP	X				
4.6.8	Dërgimi i raportit financiar në Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa	ZKF/ZDP	X				
4.6.9	Dorëzimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve 2021-2023	ZKF/ZDP		X			
4.6.10	Planifikimi i buxhetit vjetor	ZKF/ZDP		X	X		
4.6.11	Realizimi i të hyrave të planifikuara nga tarifa e sigurisë së udhëtarëve	ZKF/ZDP/BNRREA	X	X	X	X	
4.6.12	Raporti financiar i barazimit me MF mujor dhe tremujor	ZKF	X	X	X	X	
4.6.13	Realizimi i të hyrave të planifikuara nga: Tarifa për certifikim dhe licensim, Tarifa për drona, Tarifa për gjoba	ZKF/DSF/AGA/SHNA/ BNRREA	X	X	X	X	
4.6.14	Raporti mujor financiar për ZDP	ZKF/ZDP	X	X	X	X	
4.6.15	Raportim NJQH për raportin e brendshëm dhe të jashtëm të auditimit	ZDP/ADM BNJ/ ZKF		X			
4.6.16	Përgatitja e LVV dhe dorëzimi në NJQH-MF	ZDP/ADM/ ZKF	X				
4.7 Implementimi i Marrëveshjes ECAA							
4.7.1	Përditësimi i matricës dhe njoftimi i personelit për transponim të legjislacionit të mbetur nga Aneksi 1 ECAA	BNRREA	X	X	X	X	
4.8 Miratimi i tarifave të rregulluara aeronautike							
4.8.1	Vlerësimi i kërkesës fillestare të ASHNA-s mbi tarifën njësi terminale	BNRREA	X				
4.8.2	Vlerësimi i kërkesës së dytë të ASHNA-s mbi tarifën njësi terminale	BNRREA			X	X	
4.8.3	Lëshimi i Vendimit Administrativ mbi vlerën e tarifës njësi terminale në RKS për vitin 2022	ZDP				X	
4.8.4	Vlerësimi i Programeve potenciale Nxitëse nga LKIA	BNRREA	X	X			
4.8.5	Përmbledhja e realizimit të Programit Nxitës 2018-2020	BNRREA			X		
4.9 Hartimi i strategjisë kombëtare për zhvillimin e Aviacionit Civil							
4.9.1	Mbështetje në hartimin e strategjisë së aviacionit civil në kuadër	BNRREA/DSC	X	X	X	X	

	të Strategjisë për transportin multimodal						
	4.10 Aranzhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritet shtetërore për mbrojtjen e mjedisit						
	4.10.1 MOU me palët e interesit	ZDP/AGA/SHNA			X		
	4.11 Implementimi i Rregullores për shenjëzimin e pengesave, veçanërisht inspektimi dhe identifikimi i largpërçuesve që kalojnë mbi autoudhët						
	4.11.1 Inspektimet në teren lidhur me kantieret e gjeneratorëve të erës	AGA	X	X	X	X	
	4.11.2 Inspektimet në teren për verifikimin e shenjëzimit të largpërçuesve që kalojnë mbi autoudhët	AGA	X	X	X	X	
	4.12 Aprovimi i ndryshimit në ANP, zgjatja e pistës dhe ngritja e kategorisë së ILS-it						
	4.12.1 Vlerësimi dhe aprovimi i aplikacionit nga LKIA për ndryshime në aeroport	AGA	X				
	4.12.2 Vlerësimi dhe aprovimi i projektit	AGA	X	X	X	X	
	4.12.3 Vlerësimi dhe aprovimi i vlerësimeve të sigurisë	AGA	X	X	X	X	
	4.12.4 Mbikëqyrja e punimeve	AGA	X	X	X	X	
	4.13 Procesi i ndryshimit të Certifikatës së Aerodromit ANP "Adem Jashari"						
	4.13.1 Vlerësimi i aplikacionit dhe dokumentacionit përcjellës	AGA				X	
	4.13.2 Auditimi gjithëpërfshirës	AGA				X	
	4.13.3 Përgatitja e rekomandimit për amendimin e certifikatës	AGA				X	
	4.14 Certifikimi i organizatave për aftësimin profesional						
	4.14.1 Vlerësimi i aplikacionit nga LKIA për certifikim si organizatë për aftësimin profesional (varësisht nga aplikimi)	AGA			X	X	
	4.14.2 Auditimi gjithëpërfshirës i organizatës, pajisjeve dhe pajimeve	AGA			X	X	
	4.14.3 Përgatitja e rekomandimit për lëshimin e certifikatës	AGA			X	X	
	4.14.4 Inspektimet e rregullta të trajnimeve për verifikimin e përputhshmërisë	AGA			X	X	
	4.15 Ripërtëritja e Certifikatës së ASHNA-s si ofrues i shërbimeve SHNA						

SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-së PËR VITIN 2021 DHE REALIZIMI I TIJ

4.15.1	Vlerësimi i aplikacionit dhe dokumentacionit përcjellës	SHNA/BNRREA		X			
4.15.2	Auditimi gjithëpërfshirës	SHNA			X		
4.15.3	Përgatitja e rekomandimit për ripërtëritjen e certifikatës	SHNA/BNRREA			X		
4.16 Zbatimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i SMC-së							
4.16.1	Ri-shikimi i sistemit të menaxhimit në AAC dhe plotësim/ndryshimi i nevojshëm deri në certifikim	DSC dhe të gjitha departamentet	X	X	X	X	
4.16.2	Auditimi i brendshëm i SMC-së	DSC/të gjitha departamentet			X	X	
4.16.3	Përcjellja e mbylljes së gjetjeve nga Auditimi i brendshëm	DSC/të gjitha dep.	X	X	X	X	
4.16.4	Rishikimi i Rregulloreve që transpozojnë Anekset e ICAO's për nenin që obligon publikimin në AIP të "Dallimeve" nga SARPs	AGA/SHNA/DSF				X	
4.17 Realizimi i shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit të rrjedhës së parasë (në %)							
4.17.1	Totali i realizimit (shpenzimet e buxhetit të alokuar)	ZKF	X	X	X	X	
4.17.2	Paga dhe mëditje	ZKF	X	X	X	X	
4.17.3	Mallra dhe shërbime	ZKF	X	X	X	X	
4.17.4	Shpenzime komunale	ZKF	X	X	X	X	
4.18 Realizimi i planeve sipas aprovimit nga ana e menaxhmentit të AAC-së							
4.18.1	Rishikimi i Planifikimit të personelit pas aprovimit të buxhetit për AAC-së AACK /BNJ-PLN 04 (Rreg.02/2020 për Planifikimin e personelit).	BNJ	X		X		
4.18.2	Plani i pranimit, transferimit, avancimeve (sipas akteve në fuqi) pas plotësim ndryshimit të Rregullores së Brendshme përmes procedurës së ristrukturimit.	BNJ	X	X	X	X	
4.18.3	Vendimet, plotësim Akt emërimi, Përshkrimi i Detyrave të punës.	BNJ		X	X	X	
4.18.4	Realizimi i planit të trajnimeve për nëpunësit e AAC-së (AACK/BNJ-PLN 03)	BNJ	X	X	X	X	

SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-së PËR VITIN 2021 DHE REALIZIMI I TIJ

4.18.5	Rishikimi i Dosjeve të personelit sipas akteve në fuqi (RReg.nr.01/2020 për përmbajtjen, administrimin dhe përdorimin e dosjes së personelit dhe sistemit informativ të menaxhimit të burimeve njerëzore).	BNJ			X	X	
4.18.6	Monitorimi dhe Raportimi i Vijueshmërisë në punë	BNJ	X	X	X	X	
4.19 Realizimi i planit të prokurimit							
4.19.1	Zhvendosje (bartje) e inventarit AAC në Objekt të ri	PRO	X				
4.19.2	Konsulenc për mbështetje ligjore	PRO	X				
4.19.3	Furnizim me veshëmbathje sigurie për inspektor në AAC	PRO			X	X	
4.19.4	Furnizim me Software	PRO			X	X	
4.19.5	Servisim dhe mirëmbajtja e automjeteve	PRO			X	X	
4.19.6	Servisim dhe mirëmbajtje e TI	PRO					
4.19.7	Konsulent për ZDP	PRO			X	X	
4.19.8	Konsulent për TI	PRO			X		
4.19.9	Marrje me qira e dy veturave	PRO			X		
4.19.10	Rilokim mbrenda AAC-së	PRO					
4.19.11	Shërbimet e transportit ajror	PRO				X	
4.19.12	Sigurimi fizik i objektit	PRO		X			
4.19.13	Furnizim me TI-ve	PRO		X			
4.19.14	Furnizim me material higjienik (për mbrojtje nga Covid	PRO		X			
4.19.15	Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbime të dizajnit (me një furnizim)	PRO				X	
4.19.16	Furnizim me orman metalik	PRO				X	
4.20 Trajtimi i Ndryshimeve në ASHNA							
4.20.1	Rishikimi i ndryshimeve në ASHNA	SHNA	X	X	X	X	
4.20.2	Pranimi i ndryshimeve në ASHNA	SHNA	X	X	X	X	
4.20.3	Aprovimi i UTP dhe UCS për BKPR APP dhe BKPR TËR	SHNA				X	
5 HARTIMI DHE ZBATIMI I PROGRAMIT SHTETËROR TË SIGURISË- PShS							
5	5.1 Zbatimi i kërkesave të PShS-së të ndërlidhura vetëm me AAC-në						

SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-së PËR VITIN 2021 DHE REALIZIMI I TIJ

	VEPRIMET (e planifikuara)	Njësia përgjegjëse	AFATI KOHOR				STATUSI Raport i shkurtër	Në Progres
								Kompletuar
								Pa Përfunduar
			K 1	K 2	K 3	K 4		Jashtë AAC- së ose të varura nga jashtë
5.1.1	Organizimi i takimit të Komitetit të PShS-së	DSC/ZDP		X	X			
5.1.2	Takimet e Këshillit të sigurisë në AAC	Këshilli i sigurisë	X	X	X	X		
5.1.3	Analizimi i OR-ve dhe hartimi i raportit	Grupi punues	X	X				
5.1.4	Përgatitja e listave përmbledhëse të ndodhive të raportuara (menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhive)	DSC	X	X	X	X		
5.1.5	Menaxhimi i Rreziqeve në aviacionin civil (Krijimi i regjistrat pas matjes së rrezikut nga COVID 19 sipas ICAO Doc. 10144) NËSE ËSHTË E NEVOJSHME	DSC, Këshilli i sigurisë dhe Vlerësuesi i autorizuar mjekësor	X	X	X	X		
5.1.6	Përditësimi i GAP analizës	DSC			X	X		
5.1.7	Plani i zbatimit të PShS	DSC			X	X		
5.1.8	Hartimi i Planit Shtetëror të Sigurisë	DSC-Këshilli			X	X		
5.1.9	Përditësimi i manualit për detyrim në zbatim “Enforcement Manual” për të reflektuar Rregulloren për Gjoberi në Aviacionin Civil	DSC	X	X				
5.1.10	Hartimi i manualit për “Sistemin e Menaxhimit” për AAC-në	DSC		X	X	X		

SHTOJCA 3 - STATISTIKAT E TRANSPORTIT AJROR 2021

